Gjokë Vata

GJUHA E THIMCIT

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D R

821.18-1-7

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

Gjokë Vata

Gjuha e thimcit

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R




Gjokë Vata
Gjuha e thimcit

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

Gjokë Vata

Gjuha e thimcit

poezi satirike



BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR

"Camaj - Pipa"
Shkodër, 2007

Gjokë Vata
Gjuha e thimcit

Redaktor:
Arben Prendi

Kopertina:
Meritan Spahija

Faqosja:
Martin Ndoja

Offsetist:
Zef Ndoja

ISBN 978-99943-34-98-8

©Copyright: Autori

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Sponsor:
Freskita Vata

NJI SATIRË PER DY KOHË

Letersia asht shpesh e lidhun me aktualitetin e shoqnisë njerzore, megjithse nuk asht qellimi i saj me iu pergjegjë flakë per flakë rrealitetit konkret, kur kjo ndodhë ka arsyet e veta qe nuk presin me u shpjegue. Libri me poezi satirike "GJUHA E THIMCIT" i Gjokë Vates, i shkon per shtat ksajë marrdhanje të krijuesit me rrealitetin në të cilin jeton. Ai i shkon per masë kohes së tranzicionit të gjatë shqiptar. Prandej edhe frymzon satirë. Kur nji shoqni humbë orjentimin e vet social, politik, kulturor e atdhetar pa mbrritë me gjetë koordinatat e duhuna per me ecë perpara, vetem satira mundet me ia ba pasqyren e shemtimit e të degradimit me karikaturen qe aq të nevojshme e ka, karikatur qe mund të na bajë me qesh e me qa nji kohësisht. E poeti na këshillon: Ma mirë me qesh se me qa, mbasi e qeshuna asht ma e mirë se lotimi. E qeshuna na ndimon me kritikue, me shikue perpara, mos me u marrë mendesh e me ngulë në nji vend. Kjo satirë e Gjokë Vates permes nji mprehtësije të nji humorit të spikatun, ven në thumb të thimcit dukunit fort shqetesuese të shoqnisë shqiptare të tashme e të kalueme, me poezi të tilla si:

"Mirsevini karnivale", "Biografia e Enverit dhe e Enverizmit", "Tregimi i nji prillit", "Flet diploma me diplomë", "Intervistë me Enver Hoxhen", "Ngadhnjimi i genjeshtres", "Kushtrimi i demokracisë", "Mirse të gjej Shkoder loce", "Intervistë me At Gjergj Fishten" e tjera.

Autori satirizon sjellje e dukuni qe i perkasin sa kohes së diktatures komuniste në Shqipni, aq edhe kohes së tashme. Pra ky libër satirizon dy kohë. Nji satirë per të kaluemen e hidhun e per të tashmen mjaft problematike. Autori synon suksesshem portretizimin e ketyne dy kohve me nji analizë bindse me aq sa ia lejon natyra e poezisë satirike, tue i pershkrue keto dy kohë pa kursye

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BERATLIU" SHKODËR

as kend në fshikullimin ironik të penes qe në ketë rast poeti e shendrron në kamxhik satirik, i cili vringllon me të njejtin rritem e forcë nga satira në satirë... Në poezinë "Mirsevini karnivale" per mes monologut poetik të karnivalit, shprehet qartë qellimi me keto vargje:

Me u pritë me kangë e valle,
Si e kemë pasë zakon gjithmonë
E me folë per disa halle
Të ktij tranzicionit tonë.
Tranzicion si e dimë te tanë
Në gjuhë shqipe me e perkthy
Don me thanë me nderë me thanë,
Me shkue punet bythë e kry.

Në vijim me rradhë merren në shqyrtim dukunitë e shemtueme qe e pengojnë serjozisht shoqninë tonë me perparue, tue e zhytë per ditë keq e ma keq në degradim të rrezikshem per të ardhmen e vendit, siç janë mungesa e nji demokracije të vertetë, korrupsioni qe pushton fushat e ndryshme të jetes, bjerrja e vlerave morale dhe e parimeve ma të randsishme pa të cilat as nji shoqni demokratike nuk mund të ketë zhvillim. Në poemen "Biografia e Enverit dhe e enverizmit", arritje qe e nderon satiren shqiptare bahet analiza e diktatures dhe e diktatorit qe aq shum të zeza u sollen shqiptarve prandej autori i ban kete pershkrim satirik:

Ky qe djali i njanit djall,
"Qe punonte në Bisht Pallë",
Si poeti thotë
Nji djallushë aty shtatnzanë
E pat pjellë dhe e pat lanë,
Si nji gja të kotë.

Kurse në poezinë "Tregimi i nji prillit", na terheqë vemendjen se politikanet tonë po e bajnë nji prillin pronarin e shum ditve tjera shqiptare, e zotnues të premtimeve te tyne. Në poezinë "I dashtun mik", nuk ngurron me ba krahasime në mes dy kohve të diktatures komu-

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MUSIN BARLETI"

niste e të kohes se demokracisë së brishtë qe në vendin tonë po çapitë kaq vështirë. E proteston kunder mohimit të kesaj çapitje. Ndersa në satiren tjeter, "Shum i dashtun karnival" theksohet në menyrë të veçantë rreziku i humbjes së vlerave morale të shoqnisë shqiptare perball rritmit frenetik të zhvillimit, por edhe të keqkuptimit të shum trajtave të lirisë qe disa shqiptar i pandehin të njillojta me ato të shfrenimit të dalun jashtë kontrollit. Per poetin vlerat udhëheqse të njerzimit në shum raste nuk po çmohen si e meritojnë. E trajtimi i ketyne vlerave kaq gabueshem sjell fundin e kuptimit e të qellimit të jetes njerzore. Ja si i satirizon poeti perhapsat e dukunive amorale:

E po thonë do "dijetar"
N'mos ia hyshi mbrapshtë e mbarë,
S'ke si bahesh qytetar.
Me dashtë nji a dy a tre,
Jo si njerzit qe qenë dje,
Injorant qe ç'ke me te,
Me dashtë kater pes a gjashtë,
Nuk mund t'thuesh se kam dashtë
E ma në thellsi të kesajë poezije thotë:
Se kjo koha jonë e re,
Nuk ka ma nevojë per fe,
Nuk ka ma nevojë per Zot,
Nuk na tremë ma kleri dot
Ai kujton se jemi ende,
Injoranta si qemë dje,
Per hirë t'burrit, grues e fmive
Me u vu kufi knaqsive
Epshit e të gjith lakmive, e tjera....

Në nji pjesë të konsiderueshme të ketij liber poeti përdorë tetrrokshin, që për mes nji gjuhe të pasun me frazeologji të zgjedhun perpiqet me e ba sa ma të kuptueshme satiren e tij si nga intelektuali i mirfilltë, ashtu nga lexuesi i thjeshtë, tue dishrue komunikimin ma

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

të pa kufizuem. Keto poezi fiksohen rreth fabulave të thjeshta e kjo thjeshtësi na kujton shprehjen e famshme të Bielinskit: "Thjeshtësia asht bukuria e së vertetes". Në satirën e Gjokë Vates ndjejmë aromen e humorit të hollë shkodran.

Arben Prendi
Kritik letrar

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

HYMJE

Të dashtuna mikesha e ju miq,
Satira na i qet veset lakuriq,
Që ne tua shohim të pa lamet n'shesh
E t'qeshemi me to me qesh e ngjesh
Tue pa si me at thimc veset i matë
E me helm t'thimcit veset i qukatë,
Për me i mbytë mikrobet e çdo vesit
E qoftë satira ime e ktij suksesit.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

DREJTSIJA

O drejtsi që ngece
Pesdhetë vjet memece
Tash që ndryshoi loja
A të erdhi goja?
Shêja dha me duer
Që kanë ktë kuptim:
Nuk jam aq e smurë
Sa kam qenë n'fillim
Kur mu vu kjo kurë
Nga demokracia.
Po do qinda e mija
Që kanë shum nevojë
Me qenë un' pa gojë
Dëshirojnë me m'lanë
Sa ma gjatë të smurë.
M'kurojnë sa me thanë,
Ose bajnë sikurë
Kush t'i denoncojë
Kur ende s'kam gojë?!
Oh, si po pelsas
Sa herë due të flas.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

NJERIU E KOHA

Kjo që po të tregoj lexuesi im
Vertetë asht prrallë, por prrallë me shum kuptim.
Prandej në don me msue prej kësajë prrallë,
Mesimi i saj të duhet sa t'jeshë gjallë.
Thonë se Krijuesi i gjith ktij Univers
Njisoj dha vjet, per qen e kuaj e njerz,
Të tre të rronin nga katerdhet vjet.
Nji ditë kali e qeni si n'mërzi
I thanë: - O i lavdishem Perëndi
Nse lutjen ma pranon i tha ai kal,
Njizet vjet jetë njeriut due me ia falë.
Edhe un tha qeni due me ba si ky
Nga njizet vjet ne kemi boll të dy.
Pa nji pa dy i lumi Zot ia ktheu:
A jeni ju dakort, kjo punë tash kreu.
Njeriut iu shtuen katërdhet vite jetë,
T'kalit nga katerdhetë deri gjashtdhetë
Prandej siç e shikoni vajzë a djalë,
Njeriu ban si ai qe vitet ia ka falë.
E vitet nga gjashtdhetë deri tetdhetë
Nga se i ka t' atij që e din vetë,
Kshillave t'tija rradhë e kush u bindet,
Se shumica qe besa i qet pas shpindet.
Kjo mos bindje që nuk po shihet rradhë
U ba shkaku i frymzimit të ksajë prrallë.
E kur i riu ose e reja nxen
Të katërdhetat, gishtin n'tamth e ven
E në at tamth ku gishtin mirë e ngjet
I duhet me e mbajtë katërdhet vjet.
N'mos mson nga i vjetri asht gabim, o faj
Se ai ka qenë sa ti, ti s'je sa ai.
Do t'rij e t'reja t'vjetërve u thonë:
Nuk e kuptoni dot ktë kohën tonë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODER

Të kuptuemit nuk asht nji çështje kohet
E mira nga e keqja prorë dallohet.
Koha ndërhyn: Pse fajet mue m'i veni,
Përse të gjitha fajet mue m'i leni?!
Përse të gjitha fajet mue m'i varin
Kur un kam punë vetëm me kalendarin?!
Qyshë se u krijova un kam qenë njisoj
E pra ndryshoni ju, un nuk ndryshoj.
Mendja u asht dhurue me përzgjedhë,
Që djalli të mos të mundet me u a hedhë.
Nëse mendjen ia lshoni djallit n'duer
Ai futet mbrenda jush kryq e tërthurë.
Bani e hyni s'e ke ma të letë
Me e heqë qafe këndej as në at jetë.
Prandej ndrysho në mos qofsh ba aq vonë
Sa s'tka ba djalli t'vetin përgjithmonë.
Dashtë Zoti e rash në dorën e pendimit
Që ka në dorë ma t' vlefshmin e ndryshimit.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

ÇKA PO THONË E ÇKA S' PO THONË

Çka po thonë e çka s' po thonë,
Por ne nuk na bahet vonë
Ka pas thanë nji plakë shkodrane
Mos e nguc grethin me krande
Se e ngucë per t'zezen tande,
Asajë plakë ia ndjesha t'miren
Se at fjalë s'ka top qe e luen
Cilin do satira gjuen
Ai veç tallet me satiren.
Po t'perpiqesh me e vu n'rrotë
Ai prej gojet ta heqë krollen
Të matë brrylin e të thotë
Ec, hip ktu, "Shihe Stambollen."
Mos u merr me shkarravina,
Vargjet e asaj satirë
Mue me bahen veç shkallina,
Per me u ngjitë ku t'jemë ma mirë.
Meqenë nji a dy a tre
Mund t'na prishte punë satira
Por ne jemi qindra e mijra,
Shum ma shum se ishim dje
E i kemi rrajtë atje
E ty mendja t'rrenë
Se nuk asht ende
Ashtu si ka qenë.
Koka jote asht nji enë,
Qe nuk ka gja mbrendë.
Per mos me ta zgjatë
Un jam hallkë e atij zingjir
Qe nuk mundet kush me e matë
E ti ban satirë!
Paj qe besa me ktë punë,
Vetem qet pare në Bunë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Bunë i thonë xhepit t' atij,
Qe kto vargje t'i boton
E qe flejnë në librari
Ku as kush nuk ia trazon
Gjumin letargjik.
Tash e more vesht o mik
Se ti gja tjeter nuk ban
"Veç se rrah uj n'havan"
Ti ksaj punë mund t'ia çmosh vleren
N' bazë të asajë thanjes s'vjeter
Qe kur s'ke çka me ba tjeter
Sa me ndejë krejt kot luen deren.
Lueje pra t'ngjatë Zoti jeten
Me ktë lojë ti e, knaqë vehten,
Knaqesh letë si foshnja e djepit,
Ndaj kjo lojë t'asht ba nevojë,
Nderesa ne luejmë tjeter lojë
Lojen e mbushjes së xhepit.
Prandej themi ne gjithmonë:
Çka po thonë e çka s'po thonë
Por ne nuk na bahet vonë.
I lamë kot me rrahë kumonen
Ata t'veten e ne tonen.
N'folshin kot e n'folshin plot
Ne karriket kush s'na i lot
Ata thonë: hiqni at Lonin
Hiqni shpejt edhe Simonin
Se ata thellojnë korrupsionin.
Korrupsioni asht si plehi
Dje e fshimë, sot ma shum njehi.
Pleh qe shtohet orë per orë
A mund t' rrimë me fshisë në dorë?!
Sa ke fshi pyet der tani
E dimë ne nuk e din ti
Ti me pyet mue çka kam ba
Per ketë liri

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

A i ke sytë, nuk mi ke pa
Të dy gishtat në hava
E tue thirrë sa kam pasë za:
Liiiiriii demokraciiiiii?!
E na thonë pse s'bani hap
Në forcim të rendit
He, më thuej çka me i ba Prendit
I them mos e ai ban prap.
Un nuk di se si t'i quej,
Kur s'i vret ndergjegjja e vet
E i denojmë nji javë, nji muej
Edhe nuk u ban efekt
Me u çuditë me mbetë pa mend
Si s' u nxen kurr bytha vend
Ne e kapim e e pyesim:
A e ke ba ti ktë gja?
Kur thotë jo ne s'mund ta zhysim
Në nji faj qe s'e ka ba
Jo ma thonë disa, disa:
Kapni dhetë lshoni dymdhetë
E çka kam un me u ba,
Ba me qenë fajtor thonë vetë.
Rrenë kur thotë nana Safete
Se lirohen me rushfete
Ajo s'din çka thotë Shefqeti
"Bakshishin e han vetë mbreti."
Mirë ka thanë nji plak ne Vlorë,
Dhe e tha me nji kangë labe:
Mbaje mirë zogun në dorë
Neser ikë e hajde e kape.
A me endje a pa endje
Ne e respektojm ketë thanje.
Se asht thanje folë nga pleq
Qe kurr nuk na msojnë per keq.
Kur thonë nuk zbatoni ligjin,
Si zbatohet me Luigjin,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Me Jovanin e Kapllanin,
Qe s'i ke ma kavaljera
Kahë bjen shiu e kahë frynë era.
Thonë ka pleh neper qytet
Qe asht hellë tjeter parvjet
Ç'faj ka pushteti lokal
Se na bahen plehnat mal?!
Tash nji tjeter kohë ia behi,
Me vetura s'hiqet plehi
Per ketë un jam me Palin
Qe ka at xhaketen bezhë
Kesajë thanje s'mund t'ia dalin
Ja pra çka thotë shoku Palë:
Ne per fjalë kemi dy veshë
N'nji me hy, n'tjetrin me dalë.
Deri, deri per patenta
Na venë faj, sa inteligjenta?
E çka mundemi me u thanë
E din ai qe ua ka dhanë
Ka ba kursin nji mujor
E ka marrë veturen n'dorë,
Nuk tha i moçmi kot së koti
"Cilitdo të jetë i zoti,
Mos i qoftë kurr i zi moti"
Per të nuk asht nji muej pak
Mesimit me i vu kapak.
Jo ma thonë nji muej asht pak
Edhe t'msosh me ngranë japrak
Dihet ka inteligjenta,
Që na qesin ne fishek,
Që i ka hy në xhep patenta,
Me at praktikë e teori,
Që kanë mujtë me msue n'shtëpi
Si me msue notin n'dyshek
Jo ma shtini doren n'xhep
Paren fati kot s'ta jep

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Jo po thonë vetura e tijë
Letrat n'shtyll i ven seri
Nuk thonë tjetren janë artista,
Që i kanë shndrrue rrugat ne pista
Rrugat tona pista garet
N'rrugë kanë shndrrue edhe trotuaret
Me ba t'lumtun kalimtaret,
Që pa i lanë me u ba ma t'vjeter
I kalon në Boten tjeter
Mbasi do t' shkojnë se do t'shkojne
Asht ma miirë thotë mos t'vonojnë
Kur i nxamë në kundra vajtje
Ne vetures i bajmë mbajtje
Kundravajtsi n'qoftë daji
Sa do i madh qoftë faji i tijë
Ta kputë shpirtin deri n'themer
E t'ban doren me e vu n'zemer
Nji fjalë thohet në kto ana"
"Qingji i mirë mund thithë dy nana."
A mund të jetë njeri me mend
Kush e quen thanje pa vend.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R
BIBLIOTE
NR. INV 3640

INTERVISTË ME HATRIN

T'lutem hatër pergjegjen sa ma t'plotë
Ku e ndjen vehten ma mirë në Rrotulli?
Un' rrajë e trung i kam në Shqipni,
Ndërsa degët përhapun nëpër Botë.
N'Shqipni jam mbret me ma t'plotat sundime.
Ti mbret ketu?! Un po çuditem fare
Ne jemi republikë parlamentare.
Quejeni si t'doni, asht fron i mbretnisë time.
E për sa kohë do ta keshë fronin ktu?!
Për sa kohë the?! Atë e dini ju.
Për si e pashë vehten dje e si e shoh sot
Them do ta kem sa të jetë Zoti Zot,
Se kundra meje janë veç pjesa e gjorë,
Pro meje janë ata që kanë gja n'dorë.
Un s'rroj pa ta, ata pa mue nuk rrojnë
Ndaj un i mbroj e ata mue më mbrojnë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

SHËRBIMI ZYRTAR

Trokita mu në derën e nji zyrës
Heshtja ma ktheu: S'ke kend në krye t' detyrës.
Zyrtari i ksajë zyre âsht në kafe,
Orari i zyrës âsht orar për llafe,
Janë llafe që me to e kalon kohën,
Herë nga të cilat interesat ngrohën.
Nuk âsht i marrë me e lanë xhepin aq shogë
Sa t'mund të hy në të vetëm nji rrogë
Se rroga nuk i del nji hundë burrnot
Me bâ at qef që po kërkohet sot.
Në qoftë se nuk e zhdukim fjalën pak,
Qefi nuk ka si bâhet rrumbullak.
Sot etja mâ shkrumbuese e lakmisë
Âsht veç etja e shtimit t'pasunisë.
Lene frymzim at muhabet pashë ty
Sot due me gjetë zyrtarin, o zyrtaren
Që ktë punë timen ka në dorë me e kry.
Gjeje pra n'mundsh shqiptarin, o shqiptaren
Që n'zyre ta kryen punën me nji hop,
Kur qe a s'qe aty rroga i rrin top.
Në mnyrë që kuadri t'quhet sa mâ kuader
Çdo pjestar kuadri ka rezervë nji skuader
Se ashtu puna kryhet hollë e hollë
E as nji zyrtari s'i takon me u lollë
Njani lexon çka ka e klientit letër,
Tjetri ven firmen, vulen ven nji tjetër.
E pse po tallesh gjâ me qeshë nuk ka,
E ke zakon me folë me ironi
Në kurr farë mnyre s'ka si me i bâ,
Kto punë kaq të vështira nji njeri.
Sa thue ashtu ai e kështu ky
Fol për ata që i kanë vu aty.
Mandej as për ata s'din çka me thanë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

He më thue ti ku kanë me i çue të tanë
Që diplomojnë n'Vermosh e deri n'Dropull
Veç si e si t'jenë mâ shum zyrtarë se popull.
Ti thue e ka zgjidhë Bota ktë problem
Cilës do punë me i përkue njeriu.
Ne shqiptarët nga Vjosa deri n'Cem
Ose i lamë punët me u krye vetiu,
Ose ia falim dreqit me na i krye,
Se din veç ai që din veç me lidhë nye.
Sa ecë kjo rrokopujë në ktë farë feje?!
Shqiptarët do ta kenë këtë mishmash
Deri ta heqin vesin që kanë tash
Me kapë gjithçka prej bishti, jo prej kreje.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

DHANJA E TITUJVE NË SHQIPNI

Nuk di se kush nji ditë pyeti Kolë Shqopen,
Përse na doli kjo parullë e re
E duem Shqipeninë si t'gjith Evropen?!
Kola u përgjegj: Kjo na ulë pahin ne
Përse Europa as nji herë nuk tha
E duem t'gjith Evropen si Shqipninë?!
E kush ka ma shum tituj ne a ata?!
Ata kurr ngritjen tonë nuk e arrinë.
Ata nji artist popullit s'e kanë,
As nuk e kanë nji artist të merituem
Si mund të jetë artist i talentuem,
Ai që as nji titull nga këta s'e mban?!
Si mundet fama me u ba jehonë,
Kur këta tituj i kanë lidhë kaq ny?!
Ata duhet me msue metoden tonë
Sot ma jep mue e nesër ta jap ty.
Kush u ka faj sot europianve t'gjorë,
Që tharbtojnë trutë me shti diploma n'xhep?!
Le t' vinë në Shqipeni me pare n'dorë
Se gjejnë diplomë edhe për foshnje n'djep.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

DY MASKA PËR DY KOHË

Babën kur ma patën vra
Un u thashë mirë keni ba,
Sepse nuk i duhej gja
Mbrojtja ime n'at dyrnja.
Mu më duhej me vazhdue jeten
M'duhej si e si me mbrojtë vehten.
Si e mendova bukur hollë
Mos me m'mbetë prej babës hije
E me m'shkue krejtë jeta fjollë
Shkova e hyna fillë hafije.
Ata m'futen n'kambë e n'dorë
Se si mue donin puntor
E kërkesat nuk ankohen
Paga ishte e mirë për kohen
E çka ishte ma daha
Privilegjet marrshalla.
Për me ecë m'thanë puna mbarë
Mos me i ra në sy kurrkuj
Do t'trajtojmë si rreaksionar,
Rrogen e ke muej për muej.
Ti mundesh t'fitosh besimin
E atyne që s'na donë
Sa ma t'madh t'na bash shërbimin,
Aq ma t'madh ke kompensimin
Privilegje ke gjithmonë.
Zhbirilo e provoko,
Ktu dëgjo, atje trillo
E t'u bana zanatli
Çdo spiju me m'pasë lakmi.
Puna m'eci vaj e dhjam
Fika njeriun e pa farë
E kur don me t'u prijë mbarë,
Nuk të hyn nji ferrë në kambë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Kur ja erdh e ndrroi hesapi
Thashë prej dore m'iku krapi
N'mes të ujit më la trapi
A don ti pa të veshtirë
Nji qind herë me m'dalë ma mirë!
Ty thanë baben ta kanë vra
Po, u thashë e nisa me qa,
Duke ia njehë si vajtuese,
Atë jetë aq turturuese.
Megjithktë thashë due me i falë,
T'gjith sa m'fyen me vepra e fjalë.
Baben kur ta pushkatuen
A e mban mend çka u sekuestruen?
Me e ba hallin sa Korabin,
Un u thashë kam hall për babin
E si mund t'ua tregoj mallin:
E t'ia nisa more vlla
Çka as n'anderr s'i kam pa
Un veç fol e ai veç shkruej
Me të marrë gazi nji muej
N' saje t'babës more mik
Të m'u banë xhepat putik
E i thashë vehtes me knaqsi
Me e ba masken me mjeshtri
Kalon jeten mrekulli
Si as kund në Shqipeni.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

KËSHILLAT E KUMBARËS

Si e spjegon more kumbarë
Ai që dje me shuejti kangën
E në duer më vuni prangën
N'biografi më ngjeshi dangën
Prap me i ecë puna ma mbarë?!
Ç'asht kjo pyetje kaq e marrë,
Thue se ti nuk je shqiptar
Ai që prore thotë si urdhnon
Rahatinë e ban timon,
Që ma mirë s'ke si e kërkon.
Atij që e ka gjetë Alasken
Dhe e shfrytzon per mrekulli
Ti synon me ia çierr masken
Që e ka ba me shum mjeshtri;
A s'e din se kshtu mihë n'uj?!
N' mos të dhimsen goja e boja
Sa të mundesh fol e shkruej,
Fol e shkruej e vehten gjuej.
Eh more të raftë e mira
Ti s'e njihke as pak jeten
M'degjo mue ma të vjetrin
Sot ka maska disa mijra
E të gjith mbrojnë njani-tjetrin,
Se kështu e mbrojnë vetvehten.
Tash a u binde me marrë vesh
Se nuk duhet me u ra ndesh?!
Sa u thue e keni gabim,
Pse s'u thue aferim?!
Mendja jote kurr s'po regjet,
Hiqju asajë dreq ndërgjegjjet,
Që kaq hakut asht tue t'ardhë,
Thuej e zeza asht e bardhë,
Thuej e bardha asht e zezë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Kështu ty kanë me ta ndezë
At që e quejnë Drita jeshile.
Ka pasë thanë nana Xhemile,
Që pau der në n'Çinemaçin
Kudo n'Botë duhet pak hile,
N'Shqipni duhet qind për qind.
Hiqju pra atij dreq dufit,
Që t'thotë s'drejtës me i dalë zot
Se këshillat e Tartufit
S'i ka shkrue At Fishta kot.
Prandej venja gishtin kresë
Edhe bane fillë at kthesë
Që të duhet domosdo
E kshtu kangës ia fillo:
Ti dembel nuk je as pak
E ban punën për marak,
Budallejt s'të japin hak.
E ti je i drejtë si qiri
E ban dritë ktu si ma i miri
Ti punon me shum dëshirë
Pat Shqipnia fat të mirë
Me linde ti e me i shërby,
Si lum vendi që t'ka ty.
Ti je kulmi i aftsisë,
Ti je shtylla e drejtsisë.
Veç kështu dilet në breg,
Ndryshe në qofsh Skënder Beg
Nuk mund hapësh as nji shteg.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

BISEDË ME KARNIVALET

_____ Mirsevini karnivale
N' Shkoder tonë e në Shqipni
Jemi ba të gjith nji fjale
Me ju pritë me brohori.
Me ju pritë me kangë e valle
Si e kemë pasë zakon gjithmonë
E me folë per disa halle
Të ktijë tranzicionit tonë.
Tranzicion si e dimë të tanë
Në gjuhë shqipe me e perkthy
Don me thanë me nderë me thanë
Me shkue punet bythë e kry.
Pasha mue e pasha ty
Per me dashtë me qenë i drejtë
Nuk mund t'thuesh bythë e kry,
Por do t' thuesh po shkojnë byth krejtë.
Ba me pasë ti nge me m'ndi
E me ditë un me t' kallxue
Si shkojnë punet në Shqipni,
S'dijë a kishe me m'besue.
Prandej s'pari po t' baj be,
As nji rrenë nga un s'e ke.
Per ketë kam deshmitar
Cilindo qe asht shqiptar.
Tash hap veshet me degjo:
Me degjo e me gjyko,
Jo si kta gjykatsat tonë
Si pas pareve qe ke,
Por si ke gjykue gjithmonë,
Kur ke ardhë me na pa ne.
Po ia nisi me tregtar
Qe e kanë mendjen me ba qar
Duke shitë me moton rjep,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Ndaj s'na lanë pare në xhep.
Hallall kaq moj faqja e bardhë
Blejnë artikuj ushqimor
Me do çmime simbolike,
Qe u skadojnë rruges tue ardhë.
E ketu shqiptart e gjorë
Blejë me çmime astronomike
E ai ushqim të çon tek mjeku
Qe po them në pergjithsi
Mjeku muer mbiemen t'rij
Ai sot quhet Doktor Leku.
Kur disa nga kta moj zemer
I merziti ky mbiemer
Se me lek i mujti qari
E shendrruen pa u matë e shmatë
N' Doktor Euro a Dollari.
Se janë pare me jetë t'gjatë.
Kur e panë disa finokë
Se si smundja e lakmisë pareve
Po ua grryen shpirtin shqiptarve
Thanë: "Shqiptaret janë pinokë,
Qe kujtojnë se paret mbjedhen
Edhe mbinë e me kosh mbledhen.
Shpejt firmat piramidale,
Qe ua bajnë mendjen havale
E u leshuen pas ksajë dredhi
Kush me pare marrë prej droget
E do tjerë me pare rroget
Disa shiten tokë e shpijë
E kur firmat mirë u ngopen
Kreditorve u hapen gropen
E ithtaret e gjurulldise
At marrzi të qeverise
E shfrytzuen per mrekulli,
Si kurrkund në Rrokulli.
Me ia vu zjarrin Shqipnisë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Krisi pushka per gjith vend
Shqipenia u ba Xhehnem,
"Ka i fjalë turke ban lazem"
Per dikend tmerri u ba shend
Hiqej koka si per hoka
Në çdo fshat e në qytet
Vrasesi u shdrrue ne shtet,
Në nji shtet pas qefit t'vet.
Se çka ndodhë tha karnivali
Kur kshtu vendit i shkon halli,
Mund të merret letë me mend.
Tash me fol per tjera halle,
Qe n'Shqipni sot kercejnë valle
Këtu ka gjoja nji shtet,
Parlament me deputet,
Nja nji qind e katerdhetë.
Karnivali fillë u holl
Prej çudije e më tha:
E çka duhen te gjith keta?!
Gjysma e tyne dalin boll.
Karnival ti çka po flet,
Me pasë shtatdhet deputet
Ne sot kemi në Shqipni
Ma shum se tetdhet parti.
A kam si me t'besue ty?
Amerika ka veç dy
E ti thue në Shqipeni
Ka tetdhet e sa parti.
Si mund t'jenë në ketë fe,
Kur nuk ka tetdhet ide?!
Karnival në kohen tonë
Nuk i bahet kujtë ma vonë
Per ide, Atdhe e fe;
Tash kerkohet ndonji çyl
Ku t'hynë dora deri n'brryl.
N'qoftë i thellë sa oqean,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Don me i hy deri n'taban.
Mue me mbet mendja atje
Qe the i popullit kuvend
E si e quejne tash parlament,
Due me dite ma shum per te.
Karnival me zune ngusht,
Un' at punë deshta me e lanë
Se m'erdh marre me të thanë
Parlamenti asht vend per grusht
Njani thumbit i bjen fort,
Tjetri fort i bjen patkonit
E sa herë nuk bijen dakort,
Ia fillojnë simbas zakonit:
Fyeju, shtyeju e peshtyeju
Shaju, rrahu, ndaju, çaju
Mikrofona e kompiutra
I bajn t'fluturojnë si flutura,
Deri sa t'ua presë pa dashtë
At udhtim t'shkurtë ndonji rrashtë.
Me i a ndrrue kajden muzikes
Qe kendojnë kta "Toreador",
Nderhynë Garda e Republikes
E ua ven qetsinë me zor.
Lene Gjokë, tash po flas vetë
Mbasi kshtu i paska gjetë
Me shkrue ligjet me dajak
Paskam thanë teper shtatdhetë
Deputet, duhen ma pak
Pak ma pak deri n'as pak.
E çka duhen ata krenë,
Qe e shndrrojnë at' sallë n'arenë,
Ku tjerret torta e konopi
E n'vend t'fjales ngadhnjen shkopi.
Deri kur mendon ti Gjokë
Kanë me u kapë fyt e per tokë?!
Optimizmi asht i mirë,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Ky parashikim i vshtirë.
Se ktu s'ka të majtë e t'djathtë,
Ketu ka të ngathtë e t'shkathtë.
Fjala i shkathtë nuk e ka ma
At kuptim qe pat dikur
Me lujtë kambe e me lujtë durë,
Tash i shkathti asht tjeter gja,
Ka ndrrue puna e ka ndrrue loja,
Tash luejnë rrol maska e boja.
Me merzite me kto gjera,
Tash me thuej disa të tjera.
Per t'kqija n'mos paç kurreshtje
Mue mu dashka me u krellë n'heshtje
Mbasi s'paskam tjeter zgjedhje,
Po t'degjoj sa per mirsjellje.
Karnival un' pasha ty,
T'them se kam nevojë me shfry.
Ke të drejtë them kjo satirë
Ka me u ba disave mirë.
More mirë s'u ban as pak
Kta satirs i venë kapak,
N'mos u raftë ndonji dajak.
Por un flas si t'thashë me shfry.
Se nuk mundem me e mbajtë ndry
Se në shpirt me lidhet ny
E prandej po t'i them ty.
E pra i dashtun karnival
Në krah tjeter tash po dal
Bashkë po shohim poshtë e lart
Ku kanë mbrritë kulturë e art.
Se ka thanë nji plak n'Merturë
Populli qe s'ka kulture,
Nuk ban hajr nsa mini n'mur,
Vuen si gjarpni per nen gur.
Mësohen aq mirë me shtypje,
Sa s'iu ban shtypja pershtypje,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Nsa i ban iriqit ferra.
A me the po flas per tjera?
Te thashë flasim per kulturë
Shihi vetë kryq e terthurë
Emertimet qe kanë lanë
Si të donin me na thanë
E kaluemja na rrin pranë
E do t'rrijë per breza tanë.
E kaluemja jonë nuk mplaket
Trashigim qe s'mundë të flaket,
Deri kush e di se kur.
Brezat tjerë se sa per ne,
Sa per ne e pe ku e le.
Gjithnji kemi nostalgji
Per at kohë kur na pat prijë
Enver Hoxha me parti.
E tash more tungjatjeta,
Shihi emertimet tjera,
Qe pronaret e Shqipnisë
I kanë vu n'lokale t'veta,
Kur menduen se erdhi Era
Gjoja e demokracisë
Me qytete evropiane,
Austrialiane, amerikane
Se kshtu thonë lokali jonë
Ka prestixh e ban jehonë.
E per njerzit mos e nga,
I kanë emnat ma daha
Sidomos kjo klasa e naltë
Koken n're e mendjen n'baltë.
Prite Zot thonë bâhna hor
Mos me ngjitë "Emna sonor"
Tue i pasë emnat sipo i don
N'Romë, Paris e Vashington
Po ia ngjes un emnin Gjon;
Kur s'më thue me ia ngjitë Gjokë,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Mos me mujtë me dalë nder shokë.
Vajzes ia kam ngjitë Iris
Se mund t'shkojë neser n'Paris,
S'due me m'ba me te hajgare
Me mi thanë kush je shqiptare.
Klasa jonë asht tjeter dorë
S'kemi t'bajmë ne me malsor.
Tash degjo tjeter hata:
Ne qytete janë disa
Që prej malit dje kanë ra
E ksajë klase duen me i ngja,
Me emna në mos me tjeter.
Nana Dilë e baba Pjeter,
Djemt Rozario e Romario
E ky s'asht shembull i rrallë,
Kesish gjenë në çdo mahallë.
Hej shqiptar he kuku gjallë
Kudo ne botë i ngjesin emnat
Si per mashkujt e per femnat
Me tingllue n'kombsi të vet.
Vetem ne u kemë ra lanet
Emnave tradicional.
Ndije vetë tash karnival
Sa të drejtë ka ajo krushkë,
Qe po thrret me at za si pushkë:
Ul Shqipni prej asajë mushkë,
Ul Shqipni e shmange gafen,
Se kjo mushkë po ta then qafen.
Edhe un them si ajo.
Karnival kanget shkodrane
A t'i kande?
M'duket pak me të thanë po,
Me thanë t'drejten vdes per to.
E pra i dashtun karniva!
N'dasmat tona tash kendojnë
Disa kangë qe s'meritojnë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Me i ndije as kur je n'bakal.
Edhe fmijtë ato kangë msojnë
Nga qe n'dasma i kendojnë,
Ku gazeli çon hava
Vajza, djem e burra e gra.
Hidhen dridhen e perdridhen
Drejtë orkestres paret hidhen,
E orkestra duke pa
Se me u çue në zyl hava
E rritë qarin mâ e mâ,
Klarineta vrret gazelat
E n'kitarrë çka heqin telat
E tastiera bahet uk
Bateria tarabuk,
Me i mbyllë veshet me kakruk.
A por per ma mirë me i pikë
Ndryshe ngelesh krejt pa ta;
Ato kangë aq marshalla,
Sa me e ndye emnin muzikë
Ato kangë që të bajnë zbor,
Ato kangë nji kaq per hor,
I ndinë në televizor
E per çka, me bâ biznes
Pa per tjeter s'kanë kujdes,
E kanë shti traditen n'thes.
Per hirë t'pareve e hellin
Ku e ka Drini ma t' fortë rrjedhen.
Shteti i len leverda
Të kultures nuk thonë gja,
Kanget tona me i shkrrâa.
Ata kanë nji zell të tepërt
Per me marrë ndo i titull t'epërt
E ktu tituj nuk ka pak
Se ktu jepen me vandak.
Veç hap gojen si e pelqen,
Titulli në dorë të vjen.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

N'don docent, o asistent,
E lektor a por rrektor,
A por profesor doktor.
Aq sa n' don me i numrue,
Shpesh te duhet me pushue,
Me t'thanë mendja as nji vend,
S'na afrohet ne me mend.
Kemi ende tituj nderit
Trashigue prej kohs Enverit.
E me u ba ma shumve nderë,
Shpiken edhe tituj tjerë.
Hallall kta nji natë a i ditë
Na janë çue edhe bashkitë
E kanë shpikë titujt e vet
Me i shpernda n'fshat e qytet.
Sa ma shum tituj vlersimit,
Si t'ishin letra njoftimit.
Bâ me pyet kush pse ma dhe
I thonë: merre qar e ke
N'mos tu dashtë per tjeter send
S'paku t'duhet me shitë mend.
Borxhin shpejt ke me ma shly
Ma jep mue si ta dhashë ty.
Karnivali m'tha keshtu:
Po qet si ma e mira tytë
Prandej tash due me të pyet
Gazetaret ktu tek ju
A shkruejnë për këto çeshtje?
Po, po shkruejnë nuk rrinë në heshtje,
Biles kush shoqit t'ia dalë
Gazetar kemi dy palë
Në dy pjesë pra janë të ndarë,
Në të saktë e genjeshtar.
T'parët çmimin e kanë n'shkrime,
Pala tjeter në mashtrime
Të dytve ka thanë Mhidhi

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Me u dhanë çmimin Nji Prilli.
E ka thanë nji fjalë Gzim Kruja
Pala e dytë rrenë me fjalë t'hueja.
Ç farë do t' thotë more Rexhep
Plani është implementuar
E nuk është abandonuar
Por do t' zgjidhet step baj step"?!
More keta gazetar,
Shkruejnë per t'huj a per shqiptar?!
Besa besë kta more xhaje,
Shkruejnë si dreqi i dhashtë maje.
Ata shkruejnë besa moj Dushë
Si e si faqet me i mbushë
Do si do hallakatrum,
Se janë ba gazeta shum,
Si tha ai shum e per lum.
E me dashtë me tu pre mbarë,
Duhet ditë or tungjatjeta,
Ç ka mund t'bajnë dhet gazetar
Per pesdhet e sa gazeta?!
Me shkrimtar si jeni kendej?
Aaaa per shkrime kemi dej
S'ka randsi shkruen mbrapshtë a mbarë
A ke lek?, bahesh shkrimtar
Po kritikë a ka ky vend?
S'ia din emnin kush ktij send
E ka thanë nji fjalë Kasemi
Besa ktu o zemra ime
Bani e t'kapi kalemi,
Shkarravinat t'i quejnë shkrime.
Nji fjale tjeter ka thanë Ina
Qe punoi dikur në kapca
Bani e nuk t'kapi lapca,
Shkrimet ti quejnë shkarravina.
Me t'kapë lapca don me thanë,
Me qenë sa ma shum dordhanë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Ndryshe bash zheni në qofsh,
Shkrimet tua i hellin n'kosh.
Ani kush thonë ky kokë bosh
Don me u matë me Tarobosh.
A ke mâ gjâ më me thanë
Ma the?! Me i thanë gjatë e gjanë,
Nji mijë vllime nuk i nxanë,
Por me kaq un' due me e lanë.
Dëgjo tash këtu lum djali,
Foli karnivali.
Ti qenke" Nakdomonici"
Qe nuk din si ecë cicmici.
Un' kam ardhë me qeshë n'kupë t'kresë,
Ti m'bane me qa me dnesë.
Per me e mbyllë tash kte kuvend,
"Kush s'ka mend s'ka pse t'ketë dhen"
E po t'them: Sa per keshtu
Vitet tjera s'vi tek ju,
U kaloj kendej per brijë,
Pa m'shkue n'mend me kthye n'Shqipni,
Ju m'ngarkoni me aq halle,
Sa me e pasë shpinden e madhe,
Sa nji mal nuk mund ti bajë.
Nuk vi ma ktu me ndie vaj.
Kur të keni me m'folë mirë
Atherë keni me më thirrë
E do t'vi me shum deshirë.
Tash e dashtuna Shqipni
Un ti lashë do porosi
Me t'gjetë tjeter sot nji vjetë,
Ndryshe fajin e ke vetë.
N'mos i marsh kto serjozisht,
Mue me ven krypen në bisht.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODER

AUTOBUZI PËR SHQIPTAR

Si e kam ndij prej Januzit
Që ky asht nji farë shoferit
Ka sha shpiksin e autobuzit
Qe s'e bani me ecë per s'gjerit
Mbasi cilido shqiptar
Don me ndejë në vend të parë
E me ba me e vu të dytin
Ai mundohet me t' nxjerrë fytin.
Nese don mirë me e pa
Çka po them a asht e vertetë
Urdhno tash e shihe vetë
Nder parti qe sot i ka
Shqipenia tetdhet' e sa,
Po them sot se neser dihet
Shpejt e shpejt qindi arrihet
E pa hy me ta thanë hollë
Psehin kjo tek ne po ndodhë
Pra, kjo ndodhë se çdo shqiptar
Don me qenë vetem i parë
Se me ba me e vu të dytë
Perpiqet me t'i nxjerrë sytë
Në hyftë n'nji parti antarë
Hyn me shpresë me u ba kryetar
Tash ma thuej të verteten
Per veç se në Shqipeni
A mund ketë ndo nji mbretni
Ku të gjith të jenë veç mbreten
Prandej t'drejtë i jap Jonuzit
Me sha shpiksin e autobuzit
Qe per ne nuk mendoi mbarë
Me e ba s'gjanit per shqiptar
Qe të gjith meqenë n'vend t'parë.
Paj pasha Bajram e Pashkë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Si ç'po shihet në Shqipni
Ne do t'bajmë ma shum parti
Se ka t'gjith Evropa bashkë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

FLET DIPLOMA ME DIPLOMË

Flet diploma me diplomë,
Njana plakë e tjetra e njomë,
Ajo plaka lindë n'Europë,
Mbartsi i saj pat qenë ba copë
Tue studjue qyshë kur qe n'djep,
Veç si t'mund ta shtij në xhep.
Ndërsa kjo diploma e njomë,
Kjo sfidon Paris e Romë
Sepse kjo asht marrë me pare,
Laur e bame me pazare
E si ndodhi kjo e vertetë
Le ta thonë diplomat vetë.
Thotë diploma marrë jasht shtetit,
O n'Shqipni me shum mundim
Ne mendojmë se rrealiteti
S'ka nevojë per ilustrim.
Asht ashtu, a s'asht ashtu
Tha diploma ble me pare
Sa të jetë kjo tokë shqiptare
E të bajnë dy e dy katër
Ble me pare, a marrë me hatër
Do t'kem vlerë ma shum' se ju.
S'jemi ktu n'Paris a Romë
Ku aftsi do t'thotë diplomë
Ketu jemi në Shqipni,
Ku diplomë do t'thotë aftsi.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

KSHILLA E DIJETARIT

Thuhet se nji burrë n'Serreq
Me të shoqen sillej keq,
Tue gjetë "Halen n'përpeq."
Grueja me i gjetë derman
Atij burr aq llafazan
Shkoi nji ditë te nji dijetar
Për me e pyet si ta kthej mbarë,
At burrë qe aq grindje bante,
Sa as fqijet me fjetë s'i lente.
Dijetari atherë e pyeti:
Më thuej grue paç uratën
Burri a e ban shamatën
Vetëm, a por vetë i dyti?
Zotni t'drejtën ta rrefej:
Ai e nisë e un' ia kthej.
Mirë, po t'jap dy kile uj,
Por veç mos i trego kujë
Nga ky uj e dashtun zojë
Sa herë grindjen ta fillojë
Fshehtas shtin nji gllënkë në gojë;
Mos e qit as' e gëlltit,
Deri grindjen ta pushojë,
Mos e qit as kalo n'fyt
Kur t'mbarosh ktë uj kam bindjen,
Nga yt shoq s'e ke ma grindjen.
Kshtu dermani u pat gjetë
Se shamata don dy vetë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

TRETJA E DEMBELIT

Nji dembel si shum të tjerë
Që e kishte punën tmerr
Ha e pi gjithmonë çylxhi
Iu mërzit njerzve të tij.
Tjetër hall s'munden me i gjetë
Veç vendosen larg me e tretë.
E që tretja t'kish sukses
Sytë ia mbyllën e e shtinë n'thes.
Kur po e tresnin n'at sabah
Ai që kishte thesin n'krah
Ndeshi nji fshatar tek ara.
Ai e pyeti: Ç'ke n'at thes?
Nji dembel që due ta tres,
Ma fal mue se e mbajë me arra
Kur dëgjoi kto fjalë t'urueme
Tha dembeli plot gezim:
Të lumtë shpetimtari im,
Por arrat a janë t'qirueme?

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

PROJEKTIM GENJESHTRASH

Gzohu Tiranë projektit ma t'përshtatshem
N' Europë si ty qytete pak do t' ketë
Tash që projektin e ke krejt të gatshëm,
Xene se u bane bash si don ti vetë.
Po thonë se paska thanë ai Baze Mero
Ky projekt han rreth tridhet miliard euro
Ata qe i dinë kto punë thonë janë shum pak
Kaq pare atij projekt me i vu kapak.
Ku i marrim s'dimë, as kush s'premtoi me i dhanë,
Por projekti le t'jetë nuk lypë me ngranë.
Nëse e pushtojmë edhe e shesim hanën,
Me ato pare gja pa bâ nuk lamë,
Atherë projekti e kalon detin kambë
E si e hartuen n'andërr e sheh Tiranën.
E nxamë se u ba Tirana mrekulli
U ba si as nji tjetër kryeqytet,
Atherë Tirana ka me u quejtë Shqipni
Si çdo qytet i quejtun edhe shtet.
Po, ashtu bahet foli nana Gjelë,
Se Tirana po thonë paska shum miq
Tirana ka me u dukë kokë me kapelë
E trupi i sajë Shqipnia lakuriq.
Moj nana Gjelë ky projekt s'asht kurrgja
Në krahasim me tjetrin mrekulli
Me at tunel neper të cilin kambë
Nëpër nëndet do t' shkojmë në Itali.
E per makina aty nji rrugë fring t're
E hekurudhën marshalla me i thanë
Do ta pershkojmë me trenin Vlon -Tiran.
Heu! Me plasë gazit pasha qiell e dhé
Sa i gjatë tuneli deri n'Itali?
Pes fishi i tunelit Francë-Angli
E megjithktë shpejt kanë me e goditë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MIRENBARLETI" SHKODER

A ban Shqipnia aq pare ba me e shitë ?!
Heu, sa i lumtun rodi i shqiptarit,
Që do të rrojë në fund t'pesmijë vjeçarit.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

PSEUDO POETI

Jam poet pa pikë dyshimit
Arrijë kulmet e krijimit
N'sajë të këtij frymzimit,
Që më zgjon edhe nga gjumi,
Që nuk flenë nësa flenë lumi
Mi sjellë vargjet me aq bollek,
Aq i vrullshëm asht vërshimi
Sa s'ka penë as makinë shkrimi,
Që e përfshinë at ortek.
Atyne që do t'më thonin
Si ia ban po u them veta
Shpejt e shpejt manjetofonin
Afër tij nji varg kaseta
E ç'farë vargjesh fantastike
E me ajkë filozofike
Me mbështjellje hermetike
Që s'i shpon as thikë as plumb
Prandej s'din kush me u dhanë dum
E suksesi bum e bum.
Kur më pyesin do njerz kota:
Çfarë ke dashtë me thanë me ktë
Them: Nuk shkruej un per idjota
Poezia nuk ka pse.
Vargjet quhen poetike
Veç kur janë enigmatike
Vargjet mund të jenë "Eterne"
Veç kur shkruhen n'mnyrë : moderne.
Jo si shkruen vjerrshtartë atherë:
Binte shi e fryne erë
Tani ka ndryshue njeriu
Binte erë e frynte shiu
Kur un them se frynte shiu
Ti e kupton se kishte erë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Ky asht varg për nderë,
Nse ti s'e kupton s'ke vlerë.
Vargjet janë si ekuacionet,
Që i zgjidhin emocionet,
Un ta them gjanë picigjat
Me e kuptue ti rrumbullak
Kur ta them un rrumbullak
Ti e kupton se asht japrak
Nëse shijes s'ti përkohem,
Shkruej për lexuesa t' mij
Ata thonë: ah ç'mrekulli
Veç atherë kur nuk kuptohem.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

INTERVISTË ME ENVER HOXHEN

Shoku Enver, dhet' vjet ma parë
Jemi ndarë
Nga ai vend që e bane ferr,
Prandej erdhe në sketerrë.
Un kam ardhë të më tregoni
Si e kaloni.
S'ke si pyet si e kalon
At që ktu për jetë banon,
Në ktë vend kaq të sketerrshëm
Që gjithsisë s'i gjindet kund
Ktu nuk ka nji fund të tmershëm,
Ktu asht tmerri i pa fund.
E për Shqipni ç' mendoni?
Afersisht si e dua un.
E un' nuk flas ma fjalë e rrenë
Si në Botën ku kam qenë
Edhe po të due;
Ketu jam duke i pague,
Çka kam folë e çka kam shkrue.
Për nji rrenë që thashë tek ju
Dhetë kamxhik më japin ktu
E hallall kësaj menxyrë,
Un' paguej edhe t'atyre,
Rrena të çdo ngjyre
Që përhapa n'jetën time,
Kur me gojë e kur me shkrime
Në dyzet e sa vedhime.
Pse notoni në kte knetë?!
Ketu do t'notoj per jetë
Se asht sa gjaku që shkaktova,
Kur sundova.
Kur më heqin nga ky llum
Më mundojnë edhe ma shum,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

M'ngarkojnë thesin plot për plot
Me parat që u grabita,
Kur Shqipnisë me thoj ia ngjita.
E at' thes nuk e ngrejë dot,
Me at thes sa herë zvarrisem,
Baj të ngrihem e gremisem.
Për cilin nga bashkpuntoret
Që ke gjallë
Ndjen ma shum mall?
Natyrisht për ma mizoret.
Ata tash janë turmë e madhe
E kanë nisë nji tjetër valle
E për sy e faqe,
Kanë vu maska paqe.
Sot ata kudo i ke,
N'politikë , sport, shkencë e art,
Që edhe kur janë fjetë,
Mbajnë dy gishtat lart.
Po të isha në at jetë
Të dy gishtat aq perpjetë,
Do t'i ngrija edhe vetë,
Se në kohë t'asaj parti,
Un kam rrojtë si në qeli,
Kur nji i vetëm, kur grupazh,
Herë pas herë m'banë shantazh.
Ndaj ato që m'njehen krime
I kam ba nga friga ime.
Un dhashë urdhun vetëm kaq.
Kush nga urdhni im u knaq
Shum ma shum se un që e dhashë
Dhe e zbatoj përtej se i thashë
Thuej të drejten more çun,
A asht ma Enver se un?!
Sa nga ata që plumbat ftohen
Kurr prej meje nuk u njohën
Kush ban zi sa ka mundsi

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Do të bante pa kufi.
Prandej cilido ka vra
Aq sa vrau se nuk pat ma,
T'njajtin faj me mue e ka.
Pse t' mos them asht ma fajtor,
Se un' nuk kam vra me dorë.
Jo ma ti më the, më thua.
Ky nuk asht justifikim
Me të thanë mbytu per mua,
E zbaton dot urdhtin tim?
Nëse nuk do të pëlqenin
Me zbatue urdhnat e mijë
Mue nuk do të më shërbenin;
S'ka tiran pa tirani,
Tiraninë pra e përbëjnë,
T'gjith ata që i sherbejnë
Edhe t'mira bëra plot
I lashë njerzit n'sajë t'racionit,
Që t'mos preken prej tensjonit,
Si po preken sot.
I kalita që të regjen
Çdo e re e i rij
E për hirë t'Nanës parti,
T'flakin sa ma largë ndergjegjen.
N'vend të saj të kenë partin,
Që i mson t'durojnë urinë
E me bark të zbrazur
Ta qujn veten t'pasur.
I kam shtij të gjith në punë,
Kur e ku kam dashur unë
U kam dhenë sa s'kanë dashtë ma
Ndaj kanë brohorit UUUURRAAAA
Unë kam bërë njerun e ri
Që kurr sharra n'gozhdë s'i ngecë,
Shqipërinë do ta udhheqë
Sa ta ketë emrin Shqipëri.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Në mos doni me ma ditë
Tjetër gjë, kjo është meritë.
Që ta kisha sa ma t'letë
Me sundue si t'doja vetë
Shqipërinë pllambë e për pllambë
Pa më hy nji ferrë në kambë
I thashë Titos more vlla
Për Kosovë un nuk baj zâ.
Për ktë nderë që u kam bâ
Edhe sot ca kosovarë
Sidomos kur kanë gëzime,
Që tu shkojë banketi mbarë,
Pamvarsisht se jam në kneta
Të ktijë ferri plot mundime
E fillojnë me kangën time
"Enver Hoxha tungjatëjeta".
E aq më nderojnë
Sa me emrin tim
Duen të emërtojnë
Rruga, sheshe e tjerë
Nga se u bëra atë nderë.
Si u ndreqa me Kosoven
Nisa të kaloja proven
Ma t'vështirë të tiranisë
Me verjoret e shqiprisë.
Mbasi koka e rrezistencës
Që parsia e inteligjencës
Për me e lanë at trup pa kokë
Se pa kokë trupi bjen n'tokë
T'ngritunit ia sakatosa,
Shum prej tyre i varrosa
E at fushatë kurr nuk e sosa
Deri sa i çfarosa.
Si i varrosa intelektin,
Nisa tu luftoj djelektin
Mbasi ashtu thesari i tij,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Shëndrrohet nga zjarr në hi
Në menyrë që Shqipëria
T'ishte e tekeve të mija,
Jo veç n'kohën që e udhhiqja,
Por edhe pasi të vdisja,
E ndërtova at robot,
Që kurr mundin s'ma çon kot.
Un e dijë djalektin gegë
Trungu i shqipes e ka degë
Trupi i shqipes e ka kry
Megjithktë të pyes un ty:
Sa verjor i dalin zot?!
Ja ta them me gojën plot
N'don me t'quejtë "shum qesharak"
Mbro gegnishten sa do pak
E djalekti që thashë un
Ka me u folë në kohë pa fund
Për gegnisht që e lashë veç gjallë,
Sa do të ketë vlerë
Ka me u thanë për të si n'prrallë,
"Na ishte nji herë."
E çka t'pretendoj ma tepër,
Kur arrita ktë kryevepër,
Që të gjith ma përshëndesin,
Ndaj ma jep për jetë suksesin.
Çka mendoni për ktë shtet?
Vetë përjulla për te flet
Kur n'dorë time qe Shqipria,
Nuk i pat disa të kqija
Që i paska kjo liri,
Sinonim me anarshi.
Kush guxoi në at pushtet
Me krijue nji minishtet
Që sot ka me qindra e mija
Ndaj të cilve qeveria
Detyrohet me ndejë n'qosh

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Pa e pyet kush nsa nji kokosh,
As për osh, as për balosh.
Sot të djeshmit frikaman
Nga se kush nuk u ban za
U ngjanë vehtja si luan
E bajnë çka të duen me ba
E u ban shteti temena.
Temena kush drogen shet,
Temena njeriut që e blenë
E në pastë me e pague prenë
Temena atijë që vret.
Femrave un ua kam pre
Rrobat n'moden e armikut,
Por tash dalin si kanë le
Veç mbi objektiv t'ashikut,
Kanë nji rrobë sa nji gjeth fikut.
Ja ku po ta them un ty
Edhe mbaje mend ktë fjalë:
N'qytetnim shkohet me kry
E jo veç me bark e shalë.
Fjala e s'djeshmes qe HATA
Kjo e sotmja dy fjalë ka:
LEVERDA E TEMENA.
Cilin nga ato sherbime
E vlersoni ju ma lart?
At shërbim qe i bânë me shkrime
Propagandës time,
Me e shëndrrue në art.
Tani mohit u kanë ra.
S'do mend tash që nuk jam ma
Si kam qenë atherë,
Kur s'kanë lanë lëvdatë pa m'bërë.
Gjuha asht tulit, flet si t'dojë
I shkrimtarve, shkrimi asht gojë.
Gjuha ka mjaltë e ka vrerë,
Shkrimi flet vetëm nji herë,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Gjuha mund t'përdorë shum takte,
Ndërsa shkrimet janë veç fakte.
Un mohoj të shkuemen time
Shum ma letë se ata ato shkrime.
Ata për të cilët thoni
Sot kështu ju u mohojnë,
Po të ktheheshit tek froni,
Si pas jush si mund t'veprojnë?
Ata kurr nuk nxehen ngusht,
Mbledhin gishtat e i bajnë grusht.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

KUSHTRIMI I DEMOKRACIS

O medje të smura
Ende nga çensura
Që u la diktatura,
Aq u infektuet,
Sa kaq vjet kaluet
E nuk u shëruet.
Deri kur o t'gjora
Do t'u drejtojë dora
Që me folë s'u len,
Çka nuk i pelqen?!
Qanë demokracia,
Ah kuku moj nanë,
Sa ekstreme janë,
Mendjet e drejtsia,
Ma parë u bjen pika
Se pranojnë kritika
E me ba replika.
Këta bahen mburojë
Me shkrim e me gojë
Për t'gjith ata shkruesa,
Që i quejnë përfaqsuesa
T'asajë rrymë "letrare"
Qeëprehet ndër varre
Edhe s'u vjen marre.
Hajde mendje hajde,
Prap' ju asaj gajde?!
Çka u shkrue n'at rrymë
U shkrue si me pshtymë
Ajo pshtymë asht tha
E s'ka ngelë kurrgja.
Ato mund t'i ngjallë
Vetëm ajo prrallë,
Që kujtojnë me mall

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Disa xhentelmen,
Se ajo kohë prap' kthen,
Por ajo kohë s'vjen.
Ata dinë me shkrue
Vetëm si i ka msue
Ajo rrymë që vdiq.
Prandej shokë e miq,
Që sot kanë ata
Numri marshalla,
Por Allah, allah.
Injoro sa t'duesh
S'e han kush ma prrallën:"
Ma jep mue shkallën
E mbaju për brushë."
Rrenat sot u ecin,
Por ka me u mbajt thatë
Nuk e han kush specin
Ma për çokolatë.
Duhen fakte t'gjalla,
T'forta si kala,
Se me t'shkuemet prralla
Populli asht fâ
E nuk i han mâ.
Tha nji farë Vatë Ndreut
Kush s' mbron t'vertetën
E turpnon vetvehten,
Bahet gazi i dheut.
Fjala ma me vend:
Ktheni sa ma parë
Në t'vertetës shina,
Ndryshe do u mbajnë mend
Jo si gazetar,
Por si Nastradina.
Dëgjo ktë passhkrim
Gazetari im:
N'thue s'asht per botim,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Do t'bash shum gabim,
Prandej redaksi
Ktë që po lexon
Nse nuk e boton
S'ke demokraci.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

INTERVISTË ME AT GJERGJ FISHTEN

Nga nji herë andrrat e gjumit
T'çojnë përtej imagjinates.
Në nji andërr n'pikë të nates
Un mbi flatrat e nji pllumbit,
Pa ditë ku pa ditë përse
Fluturova drejt Atje,
Ku mue kurr ma pas kësajë natet
Nuk më lanë me shkue mëkatet,
Se Atje me shkue kan fat
Vetëm njerzit pa mëkat.
Kur arrita tek lulishta
Para meje u shfaq Fishta
Ti mbi ketë pllumb të bardhë
Pse ke ardhë
Në ktë lulishtë?!
Nuk e dij i thashë si kam ardhë,
Por mbasi arrita ktu
Mund ta marr nji intervistë?
Mirë tha e ia nisa kshtu:
- Per ktë gjendje që asht sot
Në Shqipninë tonë, ç'mendim ke?
N' vend të fjalve i rrodhën lot
Si i thonë fjalës lot pale- palë
Që formonin nji rrëke
E çdo lot ishte nji fjalë.
Në Shqipni sot folën lotët:
Shqiptaret janë të zotët
Me mbajtë gjallë at komunizëm
Pa i ndrrue gja për veç ndoi izëm
Që u duket se e zbutë
E n'fakt rrajtë ma thellë i futë
E pa u zhdukë krejt ato rrajë,
S'hiqet dot ajo murtajë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

M'fal se fjalët i them troç
Gjith sa ka jeta mikrobe
As nji qenje s'e mban robe,
Sa mikrobi i "morrit t'kuq:"
Morri i kuq asht ai njeri
Që i tha dje partia e tij
Ti je" njeriu ynë i rij"
Do të ishte tepër nji
Jo ma janë sa s'dij me thanë,
Prandej merre me mend ti
Sa do t'vuej Shqipnia nanë.
Kta që dinë veç me ba gafa
Se edhe kryet u din sa qafa
Dje i banë Shqipnisë torturën,
Sot i turturojnë kulturën.
E çka asht zi karabojë
Gjith sa herë me shkrim e gojë
Letersisë n'gegnisht i turren
Me at turrje geget mburren,
Thue se ne n'shqipen që shkrueme
Gjuhen shqipe e turpnueme.
Kush do t'drejtën nuk e mbron
Kot asht gjallë se nuk jeton.
Kush nuk i del zot t'vërtetes
N'qoftë se randë s'i bahet vehtes,
Tepër randë i bahet jetës.
Ai jeton shum fish ma kot
Se nji i vdekun që i del zot.
Cilido të bahet pre
I asaj "drejtsi"
Që kshillon "njeriu i ri",
I asaj parti,
Qe e pat shëndrrue n'shkërbe,
Asht ma mirë të mos kish le.
Ata duen vargje fundrrinë
Qe e shvleftësojnë Shqipninë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

INTERVISTË ME AT GJERGJ FISHTEN

Nga nji herë andrrat e gjumit
T'çojnë përtej imagjinates.
Në nji andërr n'pikë të nates
Un mbi flatrat e nji pllumbit,
Pa ditë ku pa ditë përse
Fluturova drejt Atje,
Ku mue kurr ma pas kësajë natet
Nuk më lanë me shkue mëkatet,
Se Atje me shkue kan fat
Vetëm njerzit pa mëkat.
Kur arrita tek lulishta
Para meje u shfaq Fishta
Ti mbi ketë pllumb të bardhë
Pse ke ardhë
Në ktë lulishtë?!
Nuk e dij i thashë si kam ardhë,
Por mbasi arrita ktu
Mund ta marr nji intervistë?
Mirë tha e ia nisa kshtu:
- Per ktë gjendje që asht sot
Në Shqipninë tonë, ç'mendim ke?
N' vend të fjalve i rrodhën lot
Si i thonë fjalës lot pale- palë
Që formonin nji rrëke
E çdo lot ishte nji fjalë.
Në Shqipni sot folën lotët:
Shqiptaret janë të zotët
Me mbajtë gjallë at komunizëm
Pa i ndrrue gja për veç ndoi izëm
Që u duket se e zbutë
E n'fakt rrajtë ma thellë i futë
E pa u zhdukë krejt ato rrajë,
S'hiqet dot ajo murtajë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

M'fal se fjalët i them troç
Gjith sa ka jeta mikrobe
As nji qenje s'e mban robe,
Sa mikrobi i "morrit t'kuq:"
Morri i kuq asht ai njeri
Që i tha dje partia e tij
Ti je" njeriu ynë i rij"
Do të ishte tepër nji
Jo ma janë sa s'dij me thanë,
Prandej merre me mend ti
Sa do t'vuej Shqipnia nanë.
Kta që dinë veç me ba gafa
Se edhe kryet u din sa qafa
Dje i banë Shqipnisë torturën,
Sot i turturojnë kulturën.
E çka asht zi karabojë
Gjith sa herë me shkrim e gojë
Letersisë n'gegnisht i turren
Me at turrje geget mburren,
Thue se ne n'shqipen që shkrueme
Gjuhen shqipe e turpnueme.
Kush do t'drejtën nuk e mbron
Kot asht gjallë se nuk jeton.
Kush nuk i del zot t'vërtetes
N'qoftë se randë s'i bahet vehtes,
Tepër randë i bahet jetës.
Ai jeton shum fish ma kot
Se nji i vdekun që i del zot.
Cilido të bahet pre
I asaj "drejtsi"
Që kshillon "njeriu i ri",
I asaj parti,
Qe e pat shëndrrue n'shkërbe,
Asht ma mirë të mos kish le.
Ata duen vargje fundrrinë
Qe e shvleftësojnë Shqipninë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Hej, medet a ka ma zi
Hallit zemra me të plasë
Sa gomart i paska pasë
Babatasi në Shqipni.
Kta lapera e hajduta
Që shum kush zotni i thrret,
Me t'kallxue çka asht Lahuta,
Me t'tregue kush asht poet.
Qyshe se n'pemë u krijue dega
S'pat n'Shqipni kaq Jaho Bega.
Qyshe se u krijue harlluca
S' pat n'Shqipni kaq Palok Cuca.
E në vend me u paksue
Boll kam frigë se vinë tue u shtue
Se s'ia ndrruen padrejtsisë ftyren
I ndryshuen vetëm ngjyrën,
Për me ia mbulue at pa
E me na zhgunjye at shpresë,
Që e mendoi ktë kohë si kthesë
E drejtsinë pa parashtesë.
Dje kemë qa,
Sot qajmë me dnesë
E kjo dnesë asht e dështimit
Që shndroi udhën e ngadhnjimit
Në sketerren e zhgënjimit.
Me ktë popull kta veç luejnë,
Komunizmin bajnë se e gjuejnë
Me do plumba që nuk vrasin,
Veç kërrsasin.
Budallej thonë me ktë krizëm
Janë tue vra at komunizëm.
Ja sa bukur i bajnë bisht
Mos me kritikue çka s'duen.
Shaj rrealizmin socialist
Thonë, jo ata që e përfaqsuen.
Se ato qëndrojnë ende,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Figura siç ishin dje:
- Pader Gjergj në Shkodrën tonë
A e ke pa ate diçka
Që e kanë ba për ty, po thonë?!
E kanë ba për mue?! Kush tha?!
Me sy Shkodren rri tue e la
Tash e parë e s'e kam pa,
As në tok as në hava,
Veç nën dhe në paçin ba.
Si e ka emnin ajo gja?
- Pader Gjergj s'di si me ia ngjitë,
Se as kush s'mundet me e ditë
Çka për ty aty kanë ngritë.
Ajo thonë asht nji skulpturë
Ball për ball me prefekturë
Rrasa vu kryq e tërthurë
E të ndryshme me përmasa
Librat janë që ke krijue.
- Kur nuk jam un në at' gjasend
Si dihet kush i ka shkrue?!
Duhet thonë, me e marrë me mend.
- Me nji fjalë u qenka tekë
Me m'ba mue si bibliotekë
Me vu ato rrasa aty
E me thanë Atë Fishta asht ky!
A e ka ba kush n'mende t'vet?!
- Jo more i nderuem poet,
Me vendim e me dekret.
Kush e din sa herë e herë
Komisioni të jetë mbledhë
Per me mujtë e me e zgjedh
Ne të tanë boceetat tjerë
At model aty me e hellë.
- Ku e kanë pa at shembulltyrë
Që m'kanë zgjedhë mue për at mnyrë?!
- Poet, të punuem kso dore,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

S'ka as nji figurë njerzore,
Por veç e vërteta thotë,
Ne bajmë çka nuk ban kush n'Botë.
Prandej Bota ne na njeh,
Bash ashtu si po na sheh.
- Ç'thanë klerikt kur e kanë pa
At gjasend që ma kanë ba?
Thanë: "Atë Fishta mirë e ka
E ka pak, don edhe ma"
- Me ato rrasa me kanë fye
Edhe do ma zi
Se ata që m'i kanë thye
Eshtnat e hellën'dri.
Tash s'due ma me ditë kurrgja
Më ke fâ e m'ke sterfâ.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

KANGË PER ÇIFTELI

N'kohë t'Enverit me parti
Nji rrapsod emnin s'ia dij
Ka pasë qitë nji gjoja kangë,
Kangë e dej për me u quejt zhangë,
Për Enverin qoftë i zi,
Me i thurë sa ma shum lavdi.
Kahë ia kam at kangë zili
Po marr titullin e tij"
"Me nji kangë me çifteli,
Nuk përshkruhet vepra e tij".
Mana jo mori Shqipni
Me nji kangë me çifteli
Nuk pershkruhet vepra e tijë.
Me zgjatë kanga dyzet vjet
Nuk ka kangë që n'pah i qet
Çka i ka bâ ai vendit t'vet.
Gjithçka pat kjo Shqipni
E pat marrë nana parti
Se jam nanë tha e m'përket mu
Sa me ngranë u jap un' ju.
Burri i saj pra njerku jonë,
Nji Enver i pa Tenzonë,
Lindë për ma të zezën tonë,
Turr e vrap e mprehi shpatën,
Që ta ndreqte situatën
E jo të mprehun e gja,
Por at mprehje duke e pa
Me t'shtijë mallë me ndrrue dyrnja.
Dashamirët e lirisë
Që e treguen me gojë e letër
Ia hoq qafet qeverisë
E i çoi n'at Boten tjetër.
Disa liridashsa tjerë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

I la n'burgje aq të zi,
Sa edhe atyne që shkojnë n'ferr
Me u a pasë gjithmonë lakmi.
Ndërtoi kampe perqendrimit,
Shpalli gara masakrimit,
Nji fushatë për luftë të klasave,
Nji për edukim të masave
E fushata që fillojnë,
Jo fushata që mbarojnë,
Biles as kur t' ngordhë partia,
Se do t' lente në Shqipni
At njeriun e saj të ri,
Që e brumosi tirania
Që po erdh demokracia,
Me i ba sa ma anarshi.
Mos me e lanë me ba kurr hajr
Nësa ban peshku në ajr.
Me mbrritë shpejt çka deshti djalli,
Të jasht ligjshme fetë i shpalli.
Kush guxoi me thanë besoj,
N' pastë qenë n'Shkodër e çoi n' Shtoj,
Jo në Shtoj ku banon Toma,
Por i çoi në Shtoj kufoma,
I çoi për me i ba pendimet,
N'varrezën për t'tre besimet.
Po të vdisnin n'burg punë tjetër
I varroste disa metër
Larg prej ati burg të zi
T'burgosunve me u shti lakmi.
Pse i mbushnin burgjet e varret,
Sepse ankonin shqiptaret
Se nji fjalë nuk mund të thuhej
Për ktë popull që po shuhej
Nën trysninat ma barbare,
Nën mungesa elementare.
Nji familje sa do t'jenë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Tha Enveri do të kenë
Për me hangër në tryezë
Në nji javë dhet kokrra vez.
E çdo javë t'marrë me talon
Gjysëm kile mish racion
Që t' mos bante barku bam
Nga mirqenja që u rrit
Do të merrnin nji qind gram
Burrofresko n'pesmdhet ditë.
Nëse ngrihesh në mesnatë
E vrapon shpejt nëpër terr
Ne mos qoftë rradha e gjatë
Nji shishe qumesht e merr.
Se çfarë qumshti nuk ka gja,
Sepse emnin qumshtë e ka,
Shishen nuk t'mundon me e la.
Vetëm ai që s'jetoi dje
Mund t'më thotë ke folë çka s'qe,
Ose ai që don me fye
Të drejtën duke gënjye,
Shty nga halli që s'e ka
Teseren e partisë ma,
Se ajo teser iu pat dukë
Si ta bante kont a dukë.
Cave u dukej vehtja mbretën
Se sundonin tjertë nën vehten
E tash mbetën në nji qosh
E ua la shkopi duert bosh.
S'i pyet kush ma more Nosh,
" As për osh as për balosh"
Se ka thanë nji jugosllav
E thonë asht prej Dubrovnikut
Do që kanë mahni sundimit
E u takon me ra prej fikut,
Bahen viktima zhgënjimit,
Ngjajnë si mbreti shndrrue në skllav.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Po le t'kthehemi atje
Ku qe e mallkuemja dje
E të flasim prap për te.
Me i mbushë kryet asaj rinije
Sa ma me shum byk partije,
Bani çmos me i mbajtë larg shtpije.
Tash n'aksjone vullnetare,
Kur mujore e kur vjeçare,
E ngarkoj detyrë barbare
Çdo të mirë me e qitë fare.
Me edukue rininë malsore
Per me dalë sa ma shpejt dore.
N'vend me dashtë prindët e Zotin,
Me dashtë veç Enver Despotin
E partin që bani ai,
Me i shëndrrue njerzit në djaj.
Me ia ndrrue sa ma shum ftyrën
Ia sulmoi Shqipnisë natyrën.
Pyjet fushave u shkulen
E t'maleve n'fusha i ulen
E i shitën ndër "anmiq"
Tue lanë vendin lakuriq,
Sepse donte "Shporta fiq".
Shqiptaret mbetë veç gjallë
Thonin: Ah të ishim mall
Asi mallit që jashtë çojnë
Ku njerzit kanë pse jetojnë.
Kush tentoi me u ba eksport
E pagoi shtrejt e shtrejt fort,
Në kufij gjet burg, o mort.
E ata që nuk i gjetën
Fiken t'vetët, shpëtuen vehten.
Ne që na mbajtën me zor,
Si thonë fjalës "na ban zbor"
Me t'dhanë nji televizor
Bardh ezi s'ka ma për hor,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Duhej t'kishe ndoj detyrë
Q të bante të pa ftyrë,
Ose qe e ndihmon dallimin
Me fitue autorizimin.
E n'at shtpi ku ai gja send
Hynte kishte aq shum shend,
Sa t'gjith prej atij lezet
T'vinin miq e shokë si era
Me ndonji dhuratë
E mandej s'të lshohej dera
Ditë as natë,
E kur kjo, n'vitet tetdhetë
T'shekullit njizet.
Edhe çka me pa Tiranën,
Që ma mirë me ta sha nanën
Se me të shtërngue me pa
Djem e vajza, burra e gra
E fëmijë e plaka e pleq
Tue punue tue ba urraaaa
Duke brohoritë at dreq
Që i ban me heqë aq keq.
Me ndije lajmet ardhë prej fshatit
Ku u holl dora e nitratit,
Dora e parë, a e dytë a e tretë
E çdo rrenë me e ba t'vërtetë,
Thu' s'e jetojme ne vetë
E t'vërtetën me e ba rrenë,
Thue se ktu nuk kemi qenë
Me e pa at situatë
Që Enveri i prinë me shpatë.
Eh more popull krah thatë
Shumë e keqja të ka zgjatë
Aq t'bani me u msue me të,
Sa me thanë ende,
Ma mirë ishim dje.
A harruem vallë se fëmija

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Në at kohë me nderë me thanë
Në vend t'fjalve babë e nanë
Msuen Enveri e partia?!
A harruem se me pasë pre
Ndonji stof a basëm t're
Si partisë tonë nuk i kande
Ti ke veshë të zezën tande?!
Me nji herë ty policia,
Ose e rinisë kryesia
N'rrugë të madhe do të ndalte,
Ose në ndonji rrugë balte
E pa t'lanë nji hap me ikë,
Do t'i priste copë e çikë.
E "Qafleshërave djelm"
Siç i quejti xha Enveri
U a shëndrronin flokët n'helm
Kujt me grusht e kujt me shkelm
Që i binte polic Hitleri,
Tue shtijë dhunshem tek berberi,
Si pas urdhnit ardhë nga nalt,
Me ia ba kokën asfalt.
Sepse floku i gjatë në krena
Quhej nji ndikim
I rrezikshëm si antena,
Mbi televizor
Qe do t'bante me pa skena
Atje n'perëndim,
Ku popujt jetojnë me zor,
Vetëm nga se nuk kanë prisë
Ketë yll të Shqipërisë
Qe e pat fat vetëm Shqipnia,
Prandej i kendoi partia,
Partia e populllsia,
"Lum kuj i bien rrexet e tija."
Kur e ndjeu ktë kangë nji plak
E po thonë qe prej Oblike

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Tha nji fjalë me i vu kapak:
"Sa me t'ra rrexet e tija,
Ma mirë rrexet atomike."
Ketij plak i tha nji ditë
Nji qe e donte shum partinë
Ti ma parë s'ke pasë kaq dritë,
Ne elektrifikuem Shqipninë.
Po ia priti atij ai gjysh,
Kemi linjet me tel dysh
Tel të cilit mund t'i themi
Për kto llampa që sot kemi
S'ke nevojë me qenë ma i trash.
N'mos u baftë nuse ndo i vashë
E me u shtue ma popullsia
Në paçim gjithmonë n'shtëpia
Sa kem sot or miku im,
Ky elektrifikim
Na mjafton e na tepron.
At tepricë mundet me e shitë
Tek ata qe duen ma dritë,
Dritë sa me e ba natën ditë.
Por nse shtohet popullsia
E paisja elektronike
Shpejt do t'ngelë në terr Shqipnia,
Kanë me thanëEnver na fike
Se ky rrjet që ti ke ba,
Duhet zhba deri n'asgja,
Me u nisë rishtas prej fillimit,
Pas normave t'qytetnimit,
Se gjithmonë s'rrin kjo Shqipni
Me nji rradio në shtëpi
E at' rradio për me ndi
Çka po thotë nana parti.
Se parashikoi "Profeti"
Se n'Shqipni merr fund qahmeti
E na i sjell demokracia

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Edhe në tonat shtëpia
At elektronikë
Si n'Europë e n'Amerikë.
Tash kur drita elektrike
Na lëshon e n'terr bijem zhyt,
N'vend me thanë Enver na fike
Kshtu baftë dritë edhe shpirti jyt,
Per mungesë t'drits elektrike
Nji morijë fillon të shajë
Fort Partinë Demokratike
Edhe kryetarin e saj.
Thue se atyne u bije kjo hise
Se dhanë rast me sjell paisje.
Për çka asht thonë qeveria
Që me u ba edhe Shqipnia
Si çdo vend i Perendimit
E pra kur edhe ne jemi
N'Kontinent të qytetnimit,
Pse ato t'mira t'mos i kemi?!
Pse e përdorni pa pushim
Enverin justifikim?!
Ai nuk asht tash ma ndër ne
Se ka vdek e ka hy n'dhe.
O zojushë, zojë e zotni,
Asht kollaj me folë me gojë
Se flet mbrapshtë e mbarë
Enver Hoxha do t'fillojë
Për me vdekë kur çdo shqiptar
Me gjith zemer ta dënojë.
Der sa t'jetë njeriu i rij
Që formoi partia e tij,
Ai s'asht i vdekun për nën dhe,
Por do t' jetë kambëkryq ndër ne.
Me Enverin nëpër kambë,
Sa do të punosh
Nuk po them shkon puna bosh,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MIRIN BARLETI" SHKODËR

Por ta ban pashin nji pllambë.
E ne kemi nevojë tjetër
Me ba pashin kilometër.
E kjo do t' arrijë ndër ne
Kur partinë ta kemi Atdhe
E Atdheun ta kemi ide.
Kur pozitë e opozitë
T'jenë në t'njejtën udhë qëllimit
Në shërbim të përmirsimit
Që Atdheun ma lart me e ngritë.
E jo me iu gzue dështimit
T'palës tjetër, për ma keq,
Me u mundue edhe ma për dreq,
Me gjetë "Halen në përpeq".
Ne e dimë demokracia
Ka shum t'mira e pak t'kqija.
Dikush don për hirë të s'vjetrës
Me i vu n'vend të njana tjetres,
Por nji gja dihet vetiu
Kafsha e din, jo ma njeriu,
S'ia nxen vendin terri dritës,
Nësa nata ia nxën ditës.
Nji morijë sot po ankon
Se ka korrupsion.
Kjo morijë ka të drejtë shum',
Korrupsioni sot asht lum
Veç kush krah t'drejtës i mban
Thotë: "sot lum, dje oqean".
Veç të sotmin korrupsion
Kush e mbron kush e lufton.
Korrupsionin që ka qenë
Nuk guxueme me e permendë
A nuk ishte korrupsion
Djersa jon bunker e klon
E tunele sa s'po don?!
Spijunazhi jashtë e mbrendë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Me ktë djersen tonë janë zhdem
Marksist leninistat n'Botë
Djersën tonë e kanë pasë kuotë.
Ai Enver i patenzonë
A përdori djersën tonë
Shkrimeve me u ba jehonë?!
Korrupsion ma t'madh ku ke
Se me djersën tonë me ble
Çka i duhej me vra ne?!
Disa e quejnë at kohë flori
Se ka pasë thonë: "Shum qetsi".
Si me u mburrë se ke mbajtë rend
Kur shëndrron në burg nji vend?!
Atherë pat tepër robni
E tash ka tepër liri.
Veç dje huni e sot arsyeja.
E arsyeja na jep shpresë
Se për mirë do të bajmë kthesë.
Nse ia duem të mirën kresë
Kem me dashtë e kem me ditë
Terrin me shëndrrue në dritë
E kush do nuk mendon keq
Mirë e din se për nji ditë
S'bahet fmija njizet vjeç.
Ai që thotë: me e pasë un n'dorë
Nji zet vjeç e baj n'nji orë,
Rrena e tijëpllet sa nji lopë
Ma za madhja në Europë
E ajo muuuu ban aq jehonë
Sa me u ndije rrena gjithmonë.
Me pasë qenë puna për fjalë
Qeëna erdhën n'majë të hundës
Kush në Botë s'na kishte dale,
Sa kem pasë partinë e punës.
Për me fjalë kush qe mbi dhe
Aq të lumtun sa qemë ne?!.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Do thonë t'mirat e Shqipnisë
S'janë meritë e qeverisë,
Por të kohës që ka ardhë.
Je gabim moj faqja e bardhë,
Mos i nxirr fjalët së koti
Nga se gojën e ke t'lirë
Per nji shtpi që e kalon mirë
Kryesisht ka meritë i zoti.
Tash e dashtun çifteli
Kangën tande e kanë ndi
Kush ka dashtë veshët me i hapë,
Mirë kuptimin ia ka kapë.
Kush ka dashtë me i shti vesht n'lesh
Zoti e ktheftë me ftyrë prej nesh.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

KOMISIONI I GJUHËS SHQIPE 2006

Po kndon shqipja majë krahit
Tash me erdhi dita e pahit
Që ma patën heqë derzitë
Enverat e Androklit.
Mos u ngut moj shqipe e mjera,
Se ky komisioni i rij
S'asht ma Envera e Androkli,
Por asht Androkli e Envera,
Janë Shabana e Gjovalina
Me do orta nga Prishtina
Që janë mbledhë veç me përsosë,
Çfarë n' kongres patën firmosë.
Nji ndryshim veç ka në ta
Gjuhtaret që jetën ndrruen,
Me të tjerë i zëvendsuen,
Kostallar e ma daha.
Ndër shum mbledhje, kush di sa,
Që gjuhtaret kanë me bâ
Do të diskutojnë nji gjâ
Që në dyshë i paska nda.
Njana palë e paska gjetë
Nji të metë që duhet ndreqë
'Në nand fjalë dhetë a njimdhetë
Shkronjen "Ë" duhet me e heqë.
Se për shembull shkronja "Ë"
Fjalën burr e ban burrneshë.
Pala tjetër çohet peshë:
Femër qoftë a po qoftë burrë
T'drejtat e njeriut janë një
Qe ne "ëëën" s'e heqim kurrë.
Ia kthejnë fillë gjuhtarët gegë:
Shokë ne për të tuajin hatër
Edhe pesën e quejmë katër

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Trungut mund t'i themi degë
E me nji urraaaaaaa za lartë,
Thrrasin: Rrofte "gjuha standarte"

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

KORRESPONDENCË ME NJI MIK

_____Fort i dashtun mik i rrallë
Se them dot sa me shum mall
E fillova ta lexoi
Letrën që më befasoi,
Kur më fole për të mirat
Që ke gjetë në Përendim.
Më the: s'asht ma vendi im
Ai që s'ia njehë dot t'vështirat
E më pyet xhanëm përse
Vazhdon me qëndrue atje
Ku s'ndryshon as gja nga dje,
Atdhe e quen Shqipninë ende?!
E me thue: Fjalza Atdhe
More mik të ka ba pre.
Atdheu yt asht vendi i lirë,
Ku ti mund t'jetosh ma mirë.
Kur ke rast me ba jetë beut
Merresh prap me punë t' atdheut,
Prapseprap ti me at Atdhe,
Ku qemë gjallë veç sa per be?!
Me m'thanë:merre tek e ke
Gjithçka ka asht veç për ty
S'më shkon mendja n'të me kthy.
Për mue kulm, temel qoftë shamun,
"Se ai asht nji vend i namun"
Namun janë ajo e ai,
Kundrejtë vehtes bajnë shum faj,
Që Shqipinë sot mund e len
E në Perëndim nuk vjen.
Kto mendime t'mikut tim
U ban padurimi im.
Me ta kry letrën e grisa
E përgjegjen kshtu ia nisa:

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

-Mik i dashtun n'ktë Planet,
Gjithkush ka Atdheun e vet.
Ska Atdhe n'ktë Rrokulli
Për të cilin s'janë ba flijë
Dëshmortë e herojt e tij.
Të flijuemt e ktij Atdhe
A u flijuen për me ikë ne?!
Gjaku i tyne as na flet
Si i flijuemi i flet gjithkuj
Duejeni Atdheun tuej
Si gjithkush Atdheun e vet?
Gjithkush quhet çdo njeri
Që nderon Atdheun e tij.
T'mos harrojmë ka nga shqiptart
Qe Shqipninë e quejnë Atdhe
Nga se ktu u kanë le të parët,
Jo ma ne që ktu kemë le.
Të punojmë çdo çast pa u ndalë
Për atdhe t'durojmë çdo dramë
Asht gënjeshtër ajo fjalë:
"Që Shqipninë Zoti e ka namë."
Me e pasë namë s'e kishte falë.
E ç'të falun n'ktë farë mnyret
T'dejë me u quejtë nuse natyret.
Nëse ikim ne të tanë
E kujtë thue ti me ia lanë?!
Me ua falë t'huejve Shqipninë,
A por me e lanë shkretinë?!
Kur ketë as kush mbi dhe
Nuk e bani ta bajmë ne?!
Nse nji popull e ka fat
Me u sundue nga nji xhelat
Kur tirani t'shkojë në ferr
Nji minut s'duhet me e bjerrë
Me afrue tek Atdhetë tjerë.
Ti rri ku të duesh ani

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Ku e mendon ma mbarë,
Por mos lyp me ba si ti
Cilindo shqiptar.
Ne gjithmonë fjala e s'vërtetës
Na thotë me ia hy përpjekjes.
Optimizmi asht biri i jetës,
Pesimizmi biri i vdekjes.
Optimizmi motër shpresën
Qe thotë: Ec se e mbrrite kthesën.
Kush punon për Atdhe t'vet
E ban andrrën rrealitet.
Jo ma ka shum faqendytë
Që Shqipnisë duen me i nxjerrë sytë
E me e ba me ecë për mbrapa
Si me të përparshmit hapa.
Nëse t'keqes marshalla
Edhe ne i themi si ata,
Ne do t'ishim ma daha.
Ndaj me shpartallue të keqin
Duhet me luftue me dreqin,
Jo me e lanë me ba si t'donë
Edhe tash me Atdheun tonë.
Sa ma i fortë t'jetë ai mikrob,
Që na la ma e keqja farë
Mos me e lanë me na ba rob,
Por ta ngordhim sa ma parë.
Ne e dimë o miku im
Se shum poshtë sot asht Shqipnia,
Por veç edhe ai qytetnim
Që ka aq të mira t'tija,
Ka po thuej aq të këqija.
Atje t'mirat materiale
I sfidojnë t'mirat morale.
Si mund t'quhet punë suksesit,
Si mund t'jetë demoraci
Asajë që i jep nji liri

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Si virtytit e si vesit?!
Tash i dashtun due me m'thanë
Me i dhanë t'drejtë t'mirit e t'keqit,
Kjo a nuk do t'thotë me i dhanë
T'njëjtën t'drejtë Zotit e dreqit?!
Pra shum t'kqija nga ne t'msueme,
Po thuej janë të importueme,
Nga ato vende që ti i quen
Si "Parajsa të ksajë Botë,"
Ku po paska t'drejtë të plotë
Me u martue grueja me gruen.
E me ketë ligj me u mburrë,
Që të jep liri,
Me u martue burri me burrë.
E ndaluen pushkatimin,
E legalizuen dështimin,
Thue ka ma faj fmija n' bark,
Se ai që krimet i ban varg.
Sa për kshtu pasha miqsinë
Me këtë farë qytetnimit,
Ma mirë e kemë pasë Shqipninë
N'kohën e Lek Dugagjinit.
Ti më thue n'Shqipni asht keq
E vërtetë, un ta pranoj
Por dje ishte ma per dreq,
Keq e n'dreq nuk asht nji soj.
Na ka lanë i moçmi fjalë
Kush fillon me ecë ngadalë
Shpejt len mbrapa ngadalsinë,
Ngadalsia sjell shpejtsinë.
Ti më thue në Shqipni sot
Korrupsioni asht kala
E vërtetë sa ma nuk ka,
Prandaj s'mund ta mohoj dot
Por s'asht aq sa me Enverin
Kur me djersë banim bunkerin

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

E tunele e me -ce -re
E s'guxonte kush ndër ne
Me pyet: Djersa jonë ku shkon,
Jo ma fjalën korrupsion.
Me pasë folë pasha babë Markun
T'ish ba shpinda prej kërbaçit
Ma e butë se e ke barkun
E do t' çonin n'ferr të Spaçit .
Siç e dimë o mik të dy
Atherë tash ndryshimi asht ky:
Atherë gjuhën me e pasë mprehë
Fillë anmik të kishin njeh,
S'paku tash na lanë me lehë,
Jo ma lehë si qeni n'hanë,
S'paku janë ma zemer gjanë,
Nuk na çojnë si ata n'at anë.
Ti thue u zmbrape n' kohë antike
Se u len n'terr drita elektrike.
Në errsinë mbesim lum Hila
Se s'janë llampat si kandila
Si atherë sa nji bishtuk,
Sa me pa me hangër bukë,
Atë bukën katërdhetçe,
Si me ngranë fshisen rremetçe
E përcjellun prej ndo i çorbës,
Që me i ardhë marre edhe vorbës
Me pranue me zije at send,
Që sot s'merret ma me mend.
Drita elektrike e athershme,
Ka qenë drita e kohës s'tmerrshme
Si s'i dilte asaj vorfni
Që rradhë kush kishte n'shtëpi
Televizor bardh e zi,
Ndonji radio e dy, tri llampa
T'asajë kohë qe i humbtë shtampa.
E tani more lum Hila,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Janë ndërtue pesdhet' mijë vila
Që shqiptari as në anderr
S'i ka pa jo ma në zhgjanderr.
Tash o mik në Shqipni
Telvizorit bardhë e zi
S'i duket as fara e tij.
Çdo shtpi ka televizor,
Si i thonë t'huejt me kolor.
Kur ti shkove nëAngli,
Ke lanë në Shqipni:
Nji television,
Pes rradio stacione,
Tash ke sa po don.
Sot ka i qind televizione
E po aq radio stacione
N' vend zhurmuesave sot kena
T'satelitave antena
Edhe kemi dixhitale
Per me pa mija kanale.
Me i ra shkurt ktu more vlla,
Vetëm qumshtë dallndyshe s'ka,
Sepse nuk e keni as ju
Po ta kishi ju atje,
Dota kishim ne këtu,
Ky asht ndryshimi me dje.
Rrealizmi socialist
Pseudo arti komunist,
Sot ka gjallë veç perfaqsuesat
E braktisun nga lexuesat,
Që mundohen prap me i ngrohë
Nostalgjikët e asaj kohë
E me i mbaajtë me shpirt në dhambë
Kufomat e gjalla n'kambë.
Nga lexuesi i mirfillet
Gjithçka shkruen ata s'përfillet.
Ato shihen me sy serit

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

E nga ndonji herë përmenden,
Veç se ata e ndoten penën
Duke e ngjye në mut t'Enverit.
E si munden me pasë vlerë
Shkrimet që u vjen kjo erë?!
Sot artistat shqiptar
Që e meritojnë ktë emen,
Diku mashkull diku femën,
Janë t'suksesit ndërkombtar.
Ja pra Zoti na dha dorën
Me ia thurë Shqipnisë kunorën
E lavdisë që meriton
E me e vu me ndejë n'at fron
Ku vetë Zoti don.
Ndaj si nji e nji bajnë dy
Do t'ia vemë kunorën n'kry
E me motrat europiane
Si mbretneshë me fytyrë zanë
Rrexe dielli, rrexe hane
E ardhmja e kjo mbretneshë,
Njana- tjetrës me i buzqeshë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

PARADHANJE

O fort i dashtun daja im i mirë
Vargjet tua të shkrueme plot satirë
Që në letër m'i çove, i lexova;
Duke i lexue, pak qesha e shum vajtova,
Sepse qe besa more i dashtun dajë,
Për cilindo që gja ka mbrenda kresë,
Satira asht nji e qeshun plot me vajë,
Jo ai humor që t'ban vetëm me qeshë.
E qeshuna e satirës asht e urrejtshme
Nga t'gjith ata qe i bahen mprehsa tehit
Se ajo atyne u ban shtatore plehit,
Permendore që u mbesin të përjetshme.
As plehi s'do t' pranonte krahasime
Me ata që emnin munden veç me i fy
Se plehi asht shëndeti i çdo bime
E kta nuk vlejnë gja tjetër veç me ndy.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

ARTI E LEVERDIA

_____ S'ka ma mizor se at interesaxhi
Që veç për hirë të shijes leverdi
E quen art çka artit s'i përket
E çka asht e artit mizorisht e vret.
Nuk ke se si e quen ma pak mizor
Atë njeri që maskarejve u len
Peshoren e vlersimeve në dorë
Si un padrejtsinë, ai drejtësinë e urren.
E deri kur do t'lehen kaq të lirë
Kto qenje që me turp kurr, kurr nuk ngopen?!
Me kta që i shtojnë flligshtisë eren qelbsirë
Shqipnia do me qelbë edhe Evropen?!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

FJALET E SË VËRTETËS

Pse tu lag ftyra me lot
Pse frymzimi n'lot t'u zhyt
Kujtë ia vuni synin sot
Ky frymzimi yt?
Ajo m'tha: Gjithkush ta dinë
S'dijë si deri tash un heshta
Do të flas me vargje t'thjeshta
T'më kuptojnë kushdo t'më ndinë.
Mirë ka thanë nji plak nga Batri
Fjalë për me u kujtue gjithmonë
Qofshin miq, a po anmiq
Nuk ia bani artit tonë
Rrealizmi socialist
At që sot po ia ban hatri.
Kanë shpërthye e kanë vërshue
Sa nuk mundesh me i numrue
Talentet e Shqipenisë
Thue Shqipnia asht vend zhenishë"
Hyn me zor n'çdo librari
Kah nuk t'lanë librat me hy
Rrealizim pa pà, pa ndi
Që mund t'bash sot në Shqipni
Kasetë, libër e parti.
Ndaj po qe se me kto t'trija
Mund të hy n'Europë Shqipnia,
Ne me kohë do t'kishim hy,
Që Europës me i prijë
Drejtë nivelit të pa parë
Që quhet "Nivel shqiptar".

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

SHKODRËS

Shkodër a t'mbeti krenari kund ma,
Ku i ke poetët korifej t'madhnueshëm,
Që çdo ditë bahen ma të pa lexueshëm
E ti për ta gjithnji e ma pak zâ?!
Djalektin gjuhë "Si kangë e zogut'verës,
Si vala e detit e si flladi i erës"
E flake tej n'koshin e antivlerës,
Ku shpirt po jep, heu! Eposi verjorë
E letërsinë që e ban Shqipninë krenare
Sot rrallë e tek e merr ndokush në dorë
Me të thanë mendja gegët kanë dalë fare.
Djalektin e vendosun prej Enverit
Me u quejt gjuhë shqipe t'gjith shqiptart e flasin;
T'drejtat gjuhsore randë ma randë i shklasin
Edhe ma randë se i kandet Luciferrit.
Tash na ka dalë nji tjetër krenari,
Me u quejtë krenar ai që duron ma shum.
Kush don me u zhytë në të s'pa drejtës llum,
Po u quejka: "Qytetar i tipit ri",
Po u quejka: "Qytetar i markës s're"
Ala Enver, brumosun prej Enverit
Që e ka për nderë përpjekjen me u bâ pre
I padrejtsive, i thonë: "Qytetar nderit"
Gegë, ti e le t'pa drejtën me t'marrë hopa
E si shpërblim e përkdhelë tash e parë.
Punon pa pra me zhdukë tandin thesar
Thue se ktijë krim ia hapë derën Europa.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

TREGIMI I NJI PRILLIT

T'falem nderit o Nji prill,
Që në ndimë i erdhe fillë
Vjerrshës time krye naltë,
Që prej goje i rrjedh mjaltë.
Njerzit që me thimc therë
Mjalta e sajë u duket vrer
Tash na thuej mbarë e mbarë
Çka po sheh nëpër Shqipni,
Çka po sheh nëpër shqiptar,
Por mos fol si rrenaxhi
Me thanë ditët para meje
Se Shqipnia asht fushë beteje
E ka armë çdo shpi shqiptare,
Por ktu arma s'ndihet fare,
Thanë mos shko në Shqipeni
Se po t'vrasin edhe ty
E po "shkon si qeni n'rrush
Si po shkon shum e shum kush".
Ktu jo veç nuk janë tue u vra
Por t'gjith shkojnë si vllau ma vlla
Thonë n'Shqipni ka korrupsion
Shum ma t'thellë se detin Jon
Korrupsioni ktu nuk njihet,
Biles as si fjalë nuk dihet
Populli nuk ka nevojë
Këtu han çka don moj gojë
Këtu jeta asht shum e gjallë
Investuesat rradhë e rradhë
Shqipenisë i ndrruen bojë
Për puntor ka shum nevojë.
Mund të them me gojën plot
S'gjenë shqiptar që të rrijë kot.
Në Shqipni mallnat tregtare

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Çmimet gati krejt pa pare.
Ktu me mjek e infermjer
Me u dhanë pare bjen në sherr.
"Humanizmin thotë s'e shes
Me shëndet s'bahet biznes"
E sa per kulturë shqiptare
Lëre e mos e nga fare,
Ktu kritika asht shum lart
Prandej arti bahet art,
Fjala e huej në gjuhë të tyre
S'mund të hy në kurrfarë mnyre.
Në shkollë s'shkohet sa me shkue
Këtu kur mbrrinë me u diplomue,
Syni gjak të ka pikue.
Nuk e dijë a asht kështu,
Por m'kanë thanë se tash e parë
Shihen maska aty ktu,
Që përshndeten me udhtar
E udhtaret i shpërblejnë
Këto maska që i defrejnë.
Nuk kam pa kurr karnivale
Në mnyrë kaq origjinale.
Ktu zyrtartë i rrinë detyres,
Aq sa nuk i shkul prej zyres
As me u dhanë paret e mbretit
Na mjafton thonë rroga e shtetit.
Ka nji pastërti t'çuditshme
Të përnatshme e të përditshme
T'gjitha rrugët shqiptare
Si n'asfalt, si n'trotuare
Janë të shtrueme në at mnyrë,
Që të kujtojnë nji pasqyrë.
Gjith kto t'mira moj faqja e bardhë
Në Shqipni ne na kanë ardhë
Kemi ba si tha myftiu:
"Duhet gjetë punës njeriu."

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Prandej t'mirat e ktijë vend
Nuk ka letër qe i nxen,
As nuk mund t'merren me mend
Kjo ndodhë se punojnë pa hile
Deputet e plot shend
Se sa hyn n'parlament
Fillojnë me firue kile.
Si pozitë e opozitë
Me i dëgjue n'at kuvend paqet
Loçka e zemrës të kenaqet,
Thue janë rrexe t's'njëjtës dritë.
E kur duen me shtrue ndoj çështje
Fjalën gati e kanë heshtje
Si ata që bien drejt,
Me pak fjalë kuptohen shpejt
Se duen punve n'krye me u dalë
Pa e humbë kohën me fjalë
Me t'thanë mendja kta kanë le
Me punue veç për Atdhe,
Prandej populli thërret
E sa larg ndihet jehona:
"Rrofshin kta deputet,
Qe jetojnë me hallet tona".
T'gjitha fjalët që i thashë vetë
Janë fakte të pa mohime
S'ju rrejë pasha datën time,
Që u vjen veç nji herë n'vjetë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

SHKODRA

_____Mirë se t'gjejë o Shkoder loce
Qe traditë ke kangë e valle
Për humor je e pa shoqe.
Vërtetë shkoi e zeza e madhe,
Por i ke edhe do halle,
Halle që as kush në Botë
Si humori yt s'i thotë.
E të ban me qesh me t'madhe.
Hapi vesht Shkoder me ndi
E si ti tanë kjo Shqipni
Nuk do t'flas fjale cilsish larta,
Fjal' të njelma,t'idhta e t'tharbta
Do të masim e të presim
Si pas kreje me vu fesin.
Jo se fesin e pranon
Koka s'cilës i perkon,
Por don koka a s'don koka,
Fjalt e veta i flet Gjoka
Jo ma fjala nuk ban pare,
Ma mirë kaq a por hiç fare?
Ma mirë t'thonë nuk na bajnë gja,
Se të marrë i kemi bâ.
Ta kuptojë gjithkush ka faj
Se e di mirë por s'kam çka baj.
Pra po flitet se kte verë
T'gjitha insektet ledhatare
Kanë vendosë me na bâ nderë
Me na i qitë kto plehna fare
Me punë vullnetare.
Lum e lum këndon fshatarja
Besa edhe qytetarja
Po na kthehet prap malarja.
Se ai gjak thithun nga ne

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Ban mushkajen sa i shkërbe
E i ban mizat ce-ce.
Krye qind metrash nji ve-ce
Nji ve-ce e modës re
Pa mbulesë as gropë, as mur
Me të ba me e qitë n'piturë
Çka zakon s'ka qenë nder ne.
Ai na thotë: Halli o vlla
Se ve ce në xhep kush s'ka
E diku duhet me e ba.
Mundemi n'shtëpi me u turrë
Gjith sa herë na vjen me pshurrë?!
A din çka me tha nji grue,
Bre hallallë, për ke asht burrë,
Ne të shkretat ku me shkue?!
Me ta thanë t'drejten o vlla
Nji ditë m'kapi ky gazep
E m'u desht prap me ia ba,
Si atherë kur isha n'djep.
Kur kto vargje qeshë tue thurë
Gati m'zuni nji veturë,
Për shyqyrin që shpëtova
Prej atijë veturaxhi,
Keto vargje ia kushtova,
Me nderim atijë zotni.
E kujdo e grahë si ai
Që me m'shtypë nuk ka hiç faj
Pse me i thanë grahë veturen
Si nuk fikë vehten e tjerë
E din vetë ai si e çan turrën,
Si e ban veturën erë.
N'qoftë se ti nuk don me ra
Nën rrotat e tija,
Ai me zor nuk asht tue t'ba
Der t'kalojn rri ndrytë tek shpia.
Ty t'pret puna, at s'e pret

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Se ai ka shokët e vet
Tue e pritë në kafene
Me pijë kafen bashkë me te.
Ti më thue moj zemra e njomë
Me veturë për se t'pershkohet
Nji udhë dy e tre qind metër,
Mue m'vjen keq me ecë në dhomë
Se me të nuk mund të shkohet
Nga nji dhomë në dhomen tjetër.
Tue e pasë veturën n'derë
Po e la n'shpi, jo as nji herë
Ajo t'ban njeri me vlerë.
Un në kafene krenar
E vetura tue me pritë
Para kafes n'trotuar
Kalimtart i ban me zbritë
E me ecë rrugës për brijë
Tue ma përkdhelë me sy
E ti thue me e lanë n'shtëpi
Jo more zotni,
Se ke si dikur shqiptarin,
Tash parking ka trotuarin
Se e kemi bashkinë e mirë
Sytë i hapë veç për sehirë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

PËRGJIGJE LETRËS SË NJI MIKUT

I dashtun mik me duf t'vrulleve t'shpejta
Ti letres time t'rrebt ia dhe përgjegjen
Vlerat që çmoj ma shum janë Zoti dhe e drejta
Kush mohon t'drejtën e mohon ndërgjegjen.
Zoti na dha ndërgjegjen si peshore
Per me peshue me të vlerat njerzore.
Për cilindo që ka nji pikë arsy
E djeshmja dhe e sotmja e Shqipnisë janë dy
Ti mundohesh me i lidhë me t'njejtin ny.
E di se me ty fjalët n'baltë më ngecin
Shum spatë me t'ra nji ashkël nuk ta heqin
N'qofsh veç ma kokëforti i ksajë bote,
Fakti asht ma kokëfortë se koka jote.
Ti sot shtetin e shanë si të don qefi
E shanë e shanë e shanë sa të don mllefi
E as bija e mendjes nuk i shkon kurrkujë,
S'paku ma t'thanë përse qet petlla n'uj.
E psuen kleriket zhdukjen pa derman
Sot kemi ambasadë në Vatikan,
Dje patëm rrealizmin socialist
Format e edukimit komunist,
E kolektivizim kooprativist.
Rrealizmi socialist ngordhi n'llum t'vet,
Format e edukimit shkuen n'fe t'tet
E kolektivizimin e rroi djalli,
Jo djall e gja, por djalli ma i madhi.
Dje veç po t'ishe mirë me biografi
Për nji autorizim mund t'xeje rradhë,
Me marrë televizorin bardh e zi
E me e pasë n'shtëpi veç sa për mall,
Sepse mund t'shihje nëpërmjet të tij
Ato që me t'ardhë marre se je gjallë.
Nji stacion kishte edhe at' qeveria,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Në të me pa vetem çka don partia,
Se ma pertej s'të lente gjallë zhurmuesi,
Me u perpjekë me pâ, t'ndiqte gjurmuesi,
Gjurmuesi që të çonte tek hetuesi.
Sot a ke sy me pa e vesh me dëgjue
Te-ve e radio s'mundesh me i numrue.
Dje në aeroportin tonë n'dy javë nji avion,
Sot aeroporti fluksin s'përballon.
Dje banesa me punën vullnetare
Që më u thanë pallate tash asht marre.
Pallatet sot janë të asaj cilsije,
Që edhe vetë Europes i ka hije.
Dje mund shihje vetura veç për be,
Sot prej tyne s'ka burrë rrugat me i pre.
Dje nji shqiptar në muej dilte jasht shtetit
E po t'ishte i përkdhelun prej dauletit
E ndërsa sot vshtirë mbahen prej tragetit.
Dje kishim n'shpia energji gjysmake
Sot orenditë elektro-shtëpijake
Duen rrjetin elektrik si e ka Europa
E jo kështu t'arnuem me grima e copa
Si na la trashigim ai që n'fund t'ferrit
N't' përjetshmen jetë qoftë i mbulum prej territ.
T'djeshmen e t'sotmen tonë i dallon lopa.
Të mos shpresosh do t'thotë të mos dëshrosh.
Atdheun o mik ne Zoti na ka falë
Me e dashtë si shpirtin, gjithmonë zot me i dalë,
Si na mëson virtyti i drejtsisë,
Se Atdheu asht dhuratë e Perëndisë.,
Ndaj autori i "Lahutës se Malcisë"
Ktë porosi të artë e la për ne:
"Njeriu i ka t'pandashme fe e Atdhe"
Prandej secila shtyllë nga kto të dyja,
Janë sinonime si logjika e arsyeja.
Kur t'gjith krenohen me atdhet e tyne
E lavdet ma të mdhaja ia bajnë hymne

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETA" SHKODER

A nuk asht marre e turp i madh për ne
Me ulë para t'huejve të tonin Atdhe?!
Mue po për Zotin më vjen turp e marre
Të mohoj at që asht, un jo, nuk mujë
Kur Nanë Tereza tha: "Un jam shqiptare"
A s'jam krenar shqiptar vehten ta quej?!
Për politikë t'Evropes më fol pak,
Se politika e sajë na shtini n'lak
Mbasi na la n' turturat e atij lakut,
Tani iu tek me na dalë disi hakut
Përse Shqipnia s'mujt me dalë nga balta
E komunizmit, mirë ta tregon Jalta.
Për pësdhet vjet ne nuk na u hoq dajaku,
Veç se nuk patëm naftë si ka Iraku.
Ti thue prap në Shqipni janë sigurimsat
Që deri dje në shpirt na i futen thimcat.
Ke të drejtë mik, e dij sa janë t'pështirë
Vërtetë ky asht durim shum i vështirë,
Por kur terrori i kuq po binte tuç
Evropa tha: "Në doni me m'pasë mike,
Stop për gjithmonë dënimet politike"
Tash pra më thuej more i dashtun mik,
A pse shoh kshtu jam Shakshin politik?!
Vlerat duhet me i pa si qiellin dielli
E me i peshue si i peshon Shën Mhilli.
Ti thue ndryshimi na han nji qind vjet
E kujtë s'iu deshtën kaq në ktë Planet?!
Për ne që dolëm nga i Enverit llum
Ku e merr meqenë nji qind e jo ma shum
Ti mik shqiptarve u numron të kqijat
Nga friga jonë thue n'shula janë mbërthy
E kur ne izolimi na pat ndry
Nëpër Evropë kush ua pat thye shtëpijat?!
Ti na ankon se s'kemi uj' as dritë
Ktë gjendje Evropa e projektoi at ditë,
Kur Enver Hoxhen na pat vu kalurë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "SAMARINBARLETI" H. O D E R

Për me na grahë si deshte kryq e tërthurë.
Për me mohue të drejtën asht kollaj
Se gjuha tulit asht na pat thanë ai,
Por me mohue te drejtën asht shum faj
Me mohue të drejtën kot së kotit
Nga se e drejtësia asht o mik e Zotit.
Kush artit don me i mbajtë flamurin lart,
Nuk ka si e përzien mllefin me art.
Se ai që artit tij don me i ba nderë,
Matet shum e shum herë me folë nji herë.
Çdo artisti i duhet t'jetë Sokrat,
Që fjala e tij mos mund t'nxehet mat.
Ti thue shqiptarët shesin drogë e fmijë
Blersat e tyne e ku janë zotni?!
T'kam thanë o mik, matu shum mirë kur flet
Ma i keq asht ai që i blenë a ai që i shet?!
Simbas mendimit tand o mik dashtnia
Shqipnisë i del zot ai që e nxen pija.
Kjo thanje e mjeron edhe at letër
Në t' cilën me nxitim shkrove kto fjalë.
Atdheut un gjithmonë zot kam me i dalë
Esull e dejshëm e në Botën tjetër.
Të komunizmit vehten bana pre
Që ky Atdhe të ketë liri e fe.
Po të mohoj çka hoqa për të dje,
Mohoj Atdheun e vehten bashkë me të.
M' thue Zotin falnderoj për liri t'dlirtë,
Që s'jam në Shqipeni n'at vend të errët,
Nsa un i lutem Zotit me gjith shpirt,
Ta kemë lirinë shqiptare me të tjerët.
Liria duhet ku e ke nisë jetën,
Në vend të huej je i lirë sa me rrejtë vehten.
Un të uroj me qenë sa ma gjakftohtë,
Për vendin tonë dashtni sa ma të ngrohtë.
Ktu kem kujtimet tona t'mira e t'kqija,
Ktu asht fminia jonë e ktu rinia,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM FRASHËRI" KORÇË

Ktu kemi dashamirë e miq e shokë
Eshtnat e ma të dashtunve n'kte tokë.
E zani i ktijë Atdhe gjithnji na flet,
"Guri ma randë peshon në vend të vet"
Jetofsh o mik gjith sa të kesh dëshirë
E vendin tonë e pashë gjithnji ma mirë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

ATEISTI

Ti ke shkollë t'madhe, un veç sa më thanë
E n'saje t'ditunisë tande të gjanë
Na thue Gjithsia u krijue vetiu.
E thue Zotin e ka shpikë njeriu.
Tash due me m'dhanë nji shembull qe me m' bindë
Çka u vetkrijue e çka vetiu ka lindë?!.
Kur me i dalë lakut s'ke tjeter mënyrë,
Na thue i krijoi nana natyrë.
E un të them: Natyra nuk asht qenje
E nga s'asht qenje s'ka si me pasë mendje
E kush s'ka mendje, s'krijon dot as gja
E jo aq mrekulli sa numër s'ka
Qe tua perfshi ma t'vockelen e pjeses,
Gjithçka pra u krijue prej Krijeses,
Që egzistoi para se t'lindë Gjithsia
Ndaj krejt Gjithsia, asht vepër e tija.
Vetëm nji mendje që s'e arrinë pjekjen
Se din se Hyu krijoi lindjen e vdekjen.
M'thue paraardhsi jonë majmun ka qenë
E un ta kthej: Kjo asht ma e madhja rrenë
Ç'se nisi e njerzimit histori,
Cili majmun u shndrrue në njeri?!
Evolucioni a nuk do t'vazhdonte
Gjithnji majmunat në njeri t'i shndrronte?!
Un po, e quej njeri mendje majmun
At që ktë çeshtje s'e mendon si un.
Ateistit i mbetet rrota n'disk
E teoria e tijë i nxehet pisk,
Sa herë e pyesin për gjith ato ligje
Të Gjithësis, që n'vend me dhanë përgjigje,
Mundohet teoritë me i ba gafa
T'ngranshme nga ai që koka i din sa qafa.
Përmendë arritjet e inteligjencës,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" H K O D E R

Të pasqyrueme nëpërmjet të shkencës
Pa thanë kush asht krijuesi i krijimit
Të materjeve në shërbim t'zbulimit
E kush prirjen zbuluesit ia dhuron
Me u shërbye njerzve me çka ai zbulon?!
Ç'përgjigje vallë më jep nji afetar
Nse e pyes si u krijuen çiftat e parë
Të kësaj bote ku jetojnë gjallesat
Nga t'cilat do të shtoheshin krijesat?!
Ateistin e mendjes ma me famë
Kjo pyetje e ban me ngelë si huni n'lamë
Ai me m'zanë ngusht më pyet me krenari:
Si mund të egzistojnë dy pafundsi,
Njana Gjithsi e tjetra Përëndi?!
Pa nji pa dy un mundëm me e lidhë ny:
Âsht pafundsi për shokët tu e ty
Që mund të shkoni der ku u mbrrinë takati
Pse asht pa fundsi, cili nga ju e mati?!
Kërmilli që sheh veç tre centimetër
Thotë: vetëm çka shoh un, nuk ka gja tjetër.
Çka vlejnë studimet tua të vazhdueshme,
Kur e mohon çka asht ma e pa mohueshme?!
Ti thue ringjallja s'âsht veç se nji prrallë
Zoti krijues a s'mundet me ringjallë?!
A s'e din se për t'lumin Perëndi
Nuk egziston as fjala vështirsi?!
Na thue ban keq sa t'mundësh, s'ka shpagim
Nga se nuk ka parajsë e ferr e Amshim!
Nëse e vërteta do të ishte ashtu,
Gjaja ma e kotë do t'ishte jeta ktu.
Për ma t'çmendunin âsht e pa pranueshme
Se Krijuesi i veprave t'madhnueshme,
Krijoi ktë Botë si na thonë ateistat,
Që nga kjo Botë ia mbushin ferrit listat.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODËR

BIOGRAFIA E ENVERIT DHE E ENVERIZMIT

_____Kush nuk don t'i sillet rrotull,
Por ta thotë fillë rrumbullak
E thotë edhe me kaq pak:
Sikur çdo shqiptar
T'ishte nji Balzak
E të shkruente nji ditar,
Nji ditar dyzet vjeçar
Me lot e me gjak
Nuk e dijë a po a jo
Do t'i thonte t'gjitha ato,
Që Enveri i suell ktijë popull.
T'kish me ndodhë çka kurr s'ka ngja
E të bahej prijsi
Shum e shum miliona fishi
I atij që është
E të vunte shum vjet rresht,
Nuk e dijë a po, a jo
Do t'i lante t'gjitha ato,
Që ktijë popull borxh i ka.
Si kur t'kisha penë të epër,
Ky tregim do t'ish kryevepër
Prapseprap o shokë të mijë
E të dashtun miq
"Ma mirë pak se hiç".
Në mos tjetër kanë me thanë
Aq sa mundi na ka dhanë
E si kur në Shqipni
Të na jepte çdo njeri
Vetëm aq sa pat mundsi
S'do të rrahej kurr kjo temë,
S'do të lindte kjo poemë,
Kjo do t'ishte mrekulli.
Por mbasi kështu s'ka ngjarë,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Po u tregoj tash mbarë e mbarë
Se si fatet na u ngërdheshën
Se si t'kqijat na u reshën
E të zezat na u mveshën.
Qe ta dini o shqiptar
T'brezave pas nesh
Kush pat qenë ky sundimtar,
Kush pat qenë ky kriminel,
Që për fytin na u ba tel,
E për kokën shkemb
E për zemrën xhemb,
E për shpirtin dhemb
Tani mbani vesh:
Ky qe djali i njanit djall,
Që punonte në Bishtpallë,
Si poeti thotë.
Nji djallushë aty shtatzanë
E pat pjellë dhe e pat lanë,
Si nji gja të kotë.
Shpesh mbinë sherri ku s'e pret,
Sidomos kur e përket,
Mirë e mirë pa u matë.
Kur dhuraten që s'e priste
E pat gjetë
Qe nji mijë nand qind e tetë,
Ah medet si kur të vdiste
Në nji mijë nand qind e shtatë.
Me që djal shtëpinë s'ia gzonte
Mendoi grues prehnin t'ia njomte
Me dhuraten e pa pritun.
E ç'gëzim kur të jetë rritun,
Tha nga shendi i grabitun.
Historia za po t'kishte
Do të thrriste:
Mbyte, mbyte at ferishte,
Ndryshe Shqipni u fishke.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Mirë po historisë se mjerë
Qe verriste tash e parë:
Pse keshtu more shqiptar
Zani i ishte çjerrë,
Se të gjores histori
Asht a s'asht nji nder nji mijë
Qe don zanin me ia ndijë;
Tjeret janë për të burreca,
T 'verbër shurdha e memeca.
Per ta emni histori,
Sinonim me leverdi,
Për ta emni Shqipni
Asht nji sofer plot per plot,
Qe ngopë njerzit e pa zot.
Njerzit më të vetmin faj,
Qe s'dëgjojnë me u shtrue kollaj
Rrojnë si kudhra nën maj.
Tash me thuej ç'u ba pastaj
Me at beben,
Qe Shqipnisë ia thau mirë heben
E në shpirt ia shtini zgjeben?!
Sa po hyni ai zog shejtanit,
U ba shpia fushë mejdanit
Me t'ia paraqit ai zojes,
Zojë me gjuhë si brisku i rrojes,
Çfarë nuk la pa nxjerrë prej gojes.
Sa flok shkurti e sa flok gjata,
Lart ma lart u ngrit shamata
Qesin presin, presin qesin,
Deri sa grueja e mbushi thesin.
Mbasi pau se kupa u mbush,
Grueja ma nuk u perpush
Ndoqi kshillen e Tartufit
Bane koken si pas zhgufit
Nse s'hapë sytë e s'e mbyllë gojen,
Pas kepucës s'e ven bojën,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Do ta keshë të humbun lojen.
Nse s'e ke mendjen e smurë,
Me pa udhën pre me mur,
Me ngrejtë kamben ku ka gur,
Ke me u rrxue kryq e terthurë.
Keto kshilla u banë kapister,
Qe terhoqen varg e vister
Shum shqiptar qe u mbet në derë
Emni shqiptar.
Nuk do t'donte shqipja e mjerë
Ta therriste me ktë emen
As nji mashkull, a por femen
Qe nuk asht krenar
Per kte emen kaq fisnik,
Per të cilin do dhanë jetën,
Do e ndrruen me metelik,
Kush me leter e kush me ar
Si të kishin shpallun garë
Shoku-shokut kush ma parë
T'ua shiste t'huejve vehten.
Hej frymzim ke shmangun rrugën,
Këto i dimë sikur dimë lugen
Kur asht plot me e çue te goja,
Ti na thuej si i eci loja
Foshnjës me ata pleq.
Mos kij frigë se heq fort keq
Zogu i dreqit me u ba dreq.
Edhe ku n'Shqipni,
Ku ai ka aq pasuni,
Sa s'ia del ta hajë të tërë,
Ndaj ua jep dreqenve tjerë.
Kur nji organ artificial,
Zëvendson nji natyral
Trupin s'pari e vret,
Por kur trupi me të msohet
Aq mirë me të pajtohet,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Sa e trajton si organ të vet.
Keshtu i ndodhi edhe asajë
Qe e pat pritë foshnjen me vajë,
Thue i solli n'shpi murtajë,
Qe jo veç po i prante shpinë
Me at murtajë,
Por krejt Shqipninë.
Djalli lind me shkollë djallzije
Me tu bâ pjestar shtëpije,
Nisi vehtes me i ba vend.
E si prind që bâhen rrumbull
Nga çdo teke që ka n'kungull
Fmija i tyne e bahen erë
Me i ba teken urdhën t' prerë,
Ndaj sa do t'i zgjatej krraba,
E lakmisë se tijë çdo herë
T'u bëftë nena t'u bëftë baba
Tekja e tijë urdhen i prerë;
I sterkaste kryq terthurë
Sa të donte ai i milte
Pa u kujtue se dikur,
As Shqipnia s'do t'i dilte.
Rreth e rrotull njerzit tjerë
Shpejt filluen me e nda me gisht
Djallin me t'pa dukshmin bisht,
Ai bisht ma vonë do t'shendrrohej
Në kamxhik qe do t'vringllohej,
Tash e parë mbi ne.
E ja pra n'ktë kohë të re
Bishti i djallit ne ktë vend
Po ban punë sa as nji send
E çdo ditë trashohet
E ma rrebtë qëllon
Ke e kundershton
Se thonë ndryshe s'perparohet.
Prap frymzim i je shmangë drejtimit

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Del nga rrjedha e zemrimit
Shko pas personazhit tim.
Kur filloi në rrugë të luente
Çdo fëmijë në sherr e munte
E çdo sherr e bante tinës
E ua ngjiste tjerve shpindës.
Ktu nji fmijë prej tijë bertiste,
Pak ma tutje nji qen klliste,
Thupër, shkop e gur e tel,
Patë e rosë e pulë e gjel,
Jashtë prej tijë nuk kish pse del,
Shkuen vitet mirë e keq,
Zogu i dreqit u ba dreq,
Biles dreq me shkollë.
Kush ban dreqin bir në shpirt,
Ai në shpirt e hapë nji birë
E aty ban strofken.
Per sa kohë të rrijë ne gji,
Je buria e gojes tijë,
Ndaj citat do ia quesh profkën.
N'mos ia quejsh dokrrat kokrra,
Ai të bluen si misrin mokrra.
Pra ky djall me trajtë njerzore,
Qe Shqipnisë do i lente kore
Tue i pru kohen ma mizore,
Prindrit e derguen të msojë
Siç Shqipnia kish nevojë,
Per mesues me pervojë.
Ja çfarë priste Shqipnia,
Ja kush ishte i sajë shpetimi,
Nse shpetim quhet mjerimi.
Djalin baba e dergoi
N'fakultetin e drejtësisë,
Si ç'i duhej Shqipnisë.
Shqipni brof e hidh vallen
Se tani e paske rradhen

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Të shperblehesh per çka hoqe
Edhe pak e s'do t'keshë shoqe
Veç të vijë ai prej Evrope,
Se ti ma s'do të jeshë miope.
Sa po shkoi thanë: Asht kokë rrum
E s'i jepka msimit dum
Sepse pa kalue shum,
Pau se msimi iu ba thumb
S'merrej shkollë hallakatrum.
Kur ia pau vehtes n'tru mykun
E se atje s'e çmonin bykun,
Tha: ç'më duhet mue ky vënd?!
Shkoj atje ku un jap mend.
Ketë shkollë koka s'ma don
Çfarë të msoj për drejtesi,
Kur per të un jam kamion
E pastaj fillë ky "mesje"
Drejtë u nis për nga Shqipnia,
Qe nuk dij si ndej pa të,
Se pa të vuente liria.
E dërguen në nji vend tjetër
Se mos klima kishte faj,
Mbas gjasht muejve maj se maj
Prap u kthye nga shkolla e epër,
Duke shfry për Perëndimin
Qe s'ia dha si e desht arsimin.
Atherë tha: Evropë idjote
Mue s'më duhet shkolla jote
Shkolla jote asht krejt kote
Profesorat tuej kokota,
N'krahasim me mue janë rrota.
S'do ti njohë si mue Bota.
Cilitdo në klasë më mbet
Un' i them kjo nuk më vret
Djalli ka shkollen e vet.
Shihni pra sa kam të drejtë,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Duke rrejtë ktu m'quejnë të shejtë.
Kanë nji faj shum t'rij e pleq,
Kur janë keq thonë s'ka ma keq
Edhe n'ardhtë nji tjetër dreq
Nuk na ban ma keq se ky,
Por kur dreqen janë të dy
E i dyti e rrxon t'parin,
Ky ma t'fortë e ka litarin
E per ne e ka at litar
Per me lidhë me rrahë me varë,
Si pas t'gjorit kundreshtar.
Sa të jetë pa u ngjitë tek froni,
As po t'donte Ciceroni,
Aq mirë nuk ta servirë helmin.
Të pa ditunit i binden
E nen kambë ia ulin shpinden,
Ai në zverk u randon shkelmin.
Mirë ia ban more shejtan,
Qe të shkelmit ban nishan
Kujtë të bahet ty nallban;
Ndaj ata qe ty të ndihen
E nuk janë pak por shum kush,
Varrin vehtes ia germihen
E shkuen t'gjith si qeni n'rrush.
Tash servilit rrahi shpatullat,
Gjoja shpirtin po i jep n'dorë
Nzeni priten, thaja hatullat,
Shpejt e shpejt shpalle deshmor.
E kur puna ashtu e do,
Përse jo edhe hero.
E në qoftë se i dilte kokrra
E mbulonte shpejt me dokrra.
Kujt e dinte të vërteten
I than' qoftë se e don vehten,
Vetem heshtja ta mbron jeten.
Qoftë i huej a por shqiptar,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Cilido që at litar
E ndimoi me e thurë
Ngado shkoftë kryq e tërthur,
I raftë nama e t'Madhit Zot
E pagoftë me gjak e lot
E pagoftë si mos fol më,
Veni gjuhës fre.
Hesht frymzim tu thafte satira,
A s'po sheh si qindra e mira
Flijuen jeten nën at shpresë
Qe u dha ky djall pa besë?!
Mue satira mos mu thaftë,
As nji e keqe mos mi raftë,
Por u baftë pjesë e atij art,
Qe e ngrejnë brezat lart ma lart
E shpoftë zemren e çensurës
E i thaftë zemrën diktatures
E në çast ia shoftë jeten.
A mendove t'raftë e mira,
Kur më the tu thaftë satira
A e pyete ma parë vehten
Ç'faj kam un që shkruej t'vërtetën,
Ç'faj kam un që shkruej satirë,
Kush dëshron me qenë i lirë
N'saje t' djallit a ban mirë?!
A e ngren folenë liria,
A lulzon demokracia,
Ku nuk lutet Perëndia?!
Mallkue kush i ndihi Enverit
Me ia vu themelet ferrit
T'komunizmit në Shqipni
Popoviqi e Mugosha
Deri t'mbinë orizi e grosha
S'ia gjenë shoket n'as nji vend
Keshtu Enverit i dhanë mend:
Nëse don skeptrin e prijsit,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

O Enver në qoftë se lisit
S'di t'i biesh si i duhet rënë
Në mënyrën ma të duhun,
Nën trung t'vet ka për të zënë
E t'i ban ty kockat pluhun.
Lypset ta kuptosh t'vërtetën
Ja ku e ke me dy fjalë t'shkurta;
Sa ma fort t'ia randosh kambën
Per mbi zverkun krrusë nga cfurku
Sa ma shpesh tu tregosh pllamën
Do ta keshë të urtë si murgu
Qe i kushton veç dogmës jetën,
Veç kështu do ta ndjesh vehten
Ma i sigurtë se e sigurta.
Kështu pra ti "druzhe moja"
Në don n'mjaltë me të ra spata,
Sa ma e vogel t'jetë kafshata,
Ma kollaj do ta nzan goja.
Ndaj mbasi ne jemi nji
Si janë vllaznit ma të mirë
Qe ma letë ta kalosh provën
Në ktë kohë kaq të vështirë,
Po t'heqim qafe Kosovën;
Se Kosova qe ta dishë,
Çdo banor e ka si bishë
Qe as forca e Serbisë,
Nuk arriti ta molisë
Sa t'heqë mendjen prej lirisë.
Ky sherbim nuk ka t'paguar
O i uruar,
Ky premtim tha Enveri m'knaqë
Se me ta s'do t'kisha paqë.
Sa Kosova t'jetë n'duer tueja,
Çka t'ketë ktu do t'jetë e jueja.
Ksajë i thonë miqsi e vertetë,
Me ta lanë mendjen e qetë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Pra Kosova aq kërcnuese,
Qoftë gjithmonë e jueja nuse.
Maje krahi kndon Gegë Toska
Ushtojnë male, kodra e prroska
Tito Gjeli, Enver Pula
Enver Letra, Tito Vula,
Fatit tonë i ra gerbula.
Komunizmi u ba kryq
Per mbi shpinden e shqiptarit,
Shqiptari udhtar Kalvari,
Drejtësisë goja iu kyç
I hueji vlla për kokë të vllaut,
I yti anmik për vdekje,
Bash ashtu si i duhej shkjaut,
Që ia doli n'çdo përpjekje,
Gjith sa herë pat dashtë trathtar,
Që u pandehën shqiptar.
Ja ç'tha Enveri nga tribuna:
Shoqe e shokë mbaroi furtuna
E robnisë pabarazisë.
Kudo fshati e malsia
E qyteti e mbarë Shqipnia
Do t'jenë rrimat e poezisë,
Që po thurë për ju partia.
Ne sot kemi miq të radhë
Kemi motrën gjeografike,
Historike, ideologjike
E udhhequn prej Marshallit,
Që s'na len si peshkun n'zall,
Por na don si sytë e ballit
E Bashkimin sovjetik,
Vlla i madh trim e besnik
E i prinë nji burrë çelikut
Që kur doren ia jep mikut,
Nuk e len me ra prej fikut;
Aleatet tonë të mdhej

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Që sa do të jenë përtej,
Nuk ka det as oqean
Që miqsin me ta na ndanë,
Lidhë si laknat me kërcej.
Kështu tha Enver Urtia
E buçiti Shqipnia
Nga slogan qe mbushen qiellin
Për Rusveltin e Çurçillin.
Mirë po USA, Anglia e Franca
Që nuk deshten me qenë nxansa,
"Nxansa nderit,
Të Stalinit e t'Enverit,
Qe të msonin me vullnet
Per me çue popujt e vet
Si Enveri n'selamet"
U shkputen nga profesori,
Si nga ylli meteori.
Dhe e moren vehten n'qafë,
Me ktë gafë.
Ç't'i bash mendjes së njeriut,
Mendjes prijsave t' Prendimit
Qe nuk dinë me e çmue lirinë
E mësueme prej Stalinit
E demokracin,
Që i mson maçoku miut.
Ja njeriu llafazan
Qe e ka trunin pa taban,
Kur miqsohet me ndokënd,
Ia thurë lavdet rend e rend,
Ku me vend e ku pa vend;
Ia ban shkallë me u ngjitë në qiell
E kur prishet me të e hedhë
Poshtë ma poshtë ku s'ka ma thellë.
O Enver, "o goja plot"
Rrejte dje, a genjen sot?!.
Ne mos shtiresh se i nzen besë,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Mirë ia pave sherrin kresë
Sa me ia pasë lakmij kujt t'vdesë.
Barazia nisë punon
Me nji fshisë në dorë
Fshisen quen rrevolucion,
"Biles popullor"
Barabar të gjith ata
Që i rrasi n'dhe,
Barabar ne që na la
Gjallë veç sa per be.
Edhe krenat barazim
Si pas ktij proverb latin;
"Mendja e shndoshë në trup të shndoshë"
E kjo s'mund të hidhet poshtë.
Baras ata që punonin
"Shqipnis me i dhanë tonin"
Ata t'rrojnë mirë e ma mirë,
Që t' punojnë për tonin hirë.
Me këto tri barazi
Ia banë rrotat bukuri
Qerres përparimit;
Nuk prishë punë se ka tri rrota
Ne s'bajmë qerre si e ban bota
Pa Enverizim.
Shpiksi i ksajë qerre t're
Muer hostenin hipi n'qerr,
Shqipninë e hipi n të
Që ta nxirrte nga ai terr
Ku pat ngelun dje.
Qetë e qerrja nisen hapa
Majtas djathtas para mbrapa.
E rregresi i mbetun shkret,
Pau si ecte qerrja e çalt,
Nëpër baltë.
Tha si e sheh more progres
S'je veç ti që ke sukses,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Gjithkush ka rriskun e vet
Ja ku u gjet këtu nji vend,
Qe ma ngjet mue emnin tënd.
E ky prijsi ynë lum miku,
Nji palë syze na i shpiku
Që çdo gja t'kundërt e qet
E për hundë aq fort ti ngjet,
Sa po t' duesh me i hedhë në tokë,
S'i shkoqë dot pa hundë e kokë.
Xhami i syzeve partia,
Rrathët ideologjia,
Bishtat arti e arsimi,
T'hartuem nga Enverizimi.
Për secilen pykë,
Vetem kta gjyslykë
Shohin rreaalitetin.
Kta huj për partinë e shtetin
Quhen "vepra ma e ndritun"
Që partia i ka rritun
Për deshirë t'Enverit,
Larg prej besës, fesë e nderit.
Për t'i zhdukun fé e besë
Qe i nxirrnin shum andrralla,
Nisi luftën kundra fesë,
Se ajo i mbante t'gjalla,
E tha: Feja asht opjum,
Ose si të thuesh thumb
N'kambë të përparimit.
Ne nuk jemi pro besimit,
Por as kundra mazalla.
Ne i duem të gjith' ata
Qe nga ne kërkojnë kujdesin,
Por jo ata që e mbushin thesin.
Do ta shlyejmë "Prrallën e vjetër"
Që pat folë per perëndi.
Për këtë popull s'ka zot tjetër

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Veç asaj qe e quejnë parti.
Ktu asht veç Partia e Punes,
Dokrrat tjera n'fund të Bunës.
Asaj fe qe ndryshe flet,
Ne themi s'je për ne.
Ne vertetë jemi t'pa fe,
Por kur veç prej sajë dëgjojmë
Fjalën e partisë,
Nuk do mend e respektojmë.
Ndaj në çdo xhami a kishë
Ku shkojnë turmat besimtare,
T'i ndimohet qeverisë.
Ja kjo ishte e para faqe
E prologut të lirisë,
Që pat shkrue "kjo parti paqe"
Per besimet e Shqipnisë.
Kujt s'e deshti bujarinë
E ksajë zemer kaq të plotë
U dhuroi dredha për shpindë,
Ma kryeneçve u ndrroi Botë.
S'ka kështu e s'ka ashtu,
Veç nji gjel kendon ketu.
Kush kërkon t'ia dalë ktij gjel,
Ia bajmë shtpinë kulm e themel.
E aq trashë na sheh ai sherrin,
Aq e tmershme i ngjanë jeta,
Sa t'hapë varrin me duer t'veta
E ktë Botë ta ndrrojë me ferrin.
Këtë mirë gjithkush ta dijë,
Un do t'kem "Demokracinë"
Për ata që duen partinë.
Tjerët populli i fshin
Nga kjo Botë kryq e terthurë.
Si ne s'gjen,
Lindë nga nana diktaturë;
N'zemrën time popujt gdhenë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Pra zotni zojusha e zoja
A nuk asht nji soj si t'thuesh
Se nga ujku e ulkoja
Lindi nji drenushë?!
Mjera ti moj Shqipeni!
Ç' prespektiva po të çelen
E ka thanë nji burrë në Klos
Mjerë kush armës s'ia njeh krizmën
"Kur të bahet deti kos"
E ta zanë e hanja t'dielën
"Do të shkojmë në komunizem"
Ndaj qe besa djem e cuca
Enverizmi asht nji rryp,
Rryp i trashë me shum biruca,
Qe ma t'bukur mos e lyp;
Bira nda në milimetra
Qe kur togza të kalojë
Nga nji vrimë tek tjetra,
Aq i letë të jetë shtërngimi,
Sa as kush t'mos e kuptojë.
Çdo shtërngim justifikim,
I gatuem me mashtrim
N'mos i thue aferim,
Tang e dung e bam e bim,
Si fshinë grunin n'kohë të vjetër
E mandej ndoj turtur tjetër
Herë moderne e herë të lashta
Duke i pa me të plasë rrashta.
Prijsi asht goja e Shqipnisë,
Ai asht dora e lirisë,
Ai asht syni i vigjilencës,
Ai asht truni i inteligjencës.
Çfarë s'asht ai, ai asht gjithçka,
Un, ti, ai, ne, ju, ata.
Çdo banorit të ksajë tokë
Po t'i ndanim nga nji pjesë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Nga ai tru që ka në kokë
Do t'i mbeste brenda kresë,
Jo veç aq sa i nevojitet,
Të sundojë, por edhe t'shitet.,
Brezave që vinë.
Ai ka shpikë me at mendje t'lartë
"Shqipninë e lugës s'artë"
Që ai nisi ta godisë
Në çlirim të Shqipnisë
Për shqiptar e për shqiptare;
Bishti i sajë reforma agrare.
Kur don pulës me i pre kokën
Nga që e din se ndryshe s'vjen
Me pak kokrra e gënjen,
Se s'din pulë as nuk din gjel,
Se ku kokrra tash po i del.
T'pasunve u rrëmbeu tokën
E ia dha
Çdo fshatari varfanjak
E i tha:
Kjo dot' jetë tash toka juj,
S'do t'ia keni lakmi kuj.
Ai që e pat do t'jetë kulak
E gjithmonë do t'paguej hak
Se u ka mbajtë si demin n'lak
E ua dha bukën me gjak
Tash i bini me dajak,
Banja shpinden butë si bark,
Të gjith' jetën hiqnje zharg,
Pa e lanë në kambë të ngrihet,
Deri sa në varr të shtrihet
E të shkrihet.
Kush të lidhë me ta miqsi
Asht anmik i ksaj parti
Si ai e daha ma zi
Pasuninë e Shqipnisë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

U a dha njerzve të trathtisë
E Shipninë ia dha vorfnisë.
Në kufinin shqiptar
Të ziun klon e peruronte
Zilja e tij e tash e parë,
Ogurzezë tingllonte.
Blejë spijun e armë e prangë
Qe nga Bota me na shmangë
Mbet mirqenja jonë krejt zhangë
E ushtuen urraaaaa e kangë
Për Enverin e partinë,
Qe na linden begatinë
Dhe e rrisin me at hysmet
Qe rritë prindi fminë e vet
E qe t'ishte e t'gjithve tok,
Vendosen me e rritë në Bllok
Të udhheqsave të shtetit
Nga që ne s'ia dimë hysmetit,
E na smuret begatia
Që po priste Shqipnia;
Prit e prit mos u mërzit,
Nga nji vit në tjetrin vit.
Shpejt do t'jemi ne xhehneti
Tha "Enver Sinqeriteti"
E si ndryshe të sundonte
Kur pa skllevër nuk mund t'rronte,
Nesa rron bisha pa pre
Ja seç hise na ra ne,
Me na ba Shqipninë e re,
Pa kund shoqe per mbi dhé,
Pa zakon, doke e fé.
E që ta arrijë këtë
Eci mirë e me kujdes
Sot pak sa ma shum' se dje,
Nesër pak ma shum' se sot,
Nuk do i shkonte mundi kot,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Se pat thanë nji plak në Mes
Dalngadalë e me kujdes
Mund të mbrrishë edhe aq sukses,
Sa me shtij edhe ujkun n'thes.
Se kur shteti ta ven zgjedhën,
Por si kaut kur lëron tokën
T'ka në dorë bukën e gjellen
E nse drejtë nuk ia ndjek rrjedhën,
Të ban aq sa t'mallkosh loken,
Qe të lindi në ktë jetë.
Mplakë tha asht reforma agrare
Nji udhë ma përparimtare
Do t' na çojë sa ma parë
N'socializmin shqiptar.
Me do njerz të dalun mendsh
Bani ekipe agjitative
E ua msoi ca fjalë permendsh
E i lshoi fshatrave e malsive
Me i ba fshatrat kolektive.
E kush fjalve u ra ndesh
Shpejt i msoi si me marrë vesh.
Eh moj toka e Skënderbeut
Qe u bane nami i dheut,
Kurr e keqja pa tu ndalë.
Ma mirë t'ishe det me valë
Ku e keqja nuk ban shteg,
Sepse e qet plehin në breg.
Si kur toka më pergjigjet:
S'kam faj un more poet
Se e keqja ktu përligjet
Kanë faj kta që si njerz hiqen,
Këta Moma që e flliqën
Kaq ndyesisht vehten e vet.
Sot Shqipnia asht nji hon
Që ma t'thellë kot e kerkon.
Shum shqiptar po zanë e tallen

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Me ata qe s'heqin vallen
Si pas dirigjentit
E thonë:
"Çfarë inteligjentit,
Deshi ky t'na ndryshojë gjendjen
Eh ky rrotë ku e ka mendjen"
Çfarë tu desht more tru djerr
Shteti e nxen leprin me qerr
Çfarë të nxiti more ty,
Me i ra murit me kry?!
Kur s'e din se muri e then
Koken tande ku ke mend?!
Un kur kam rast me ra n'çyl,
E fus doren deri n'brryl.
Ma parë due jetën me kore,
Se vdekjen me përmendore.
Me Atdhe ia dolën hurq
Kastrijot e Gurakuq.
Na ka Enveri t'gjithve n'darë
E na thotë: More shqiptar
Jeni shahu, un jam Morsi,
Jeni kali, un kalorsi
Hyjo more kal i bindun,
Të më mbash në shpindë ke lindun.
Eh medet o zot sa hall,
Fshisa e vogël, plehi i madh
Këtij pleh si i përballohet
Sot e fshinë e nesër shtohet
Se servilat e Shqipnisë,
rrekordmenat e Gjithsisë
Bahen dielli i partisë
Qe u leverdisë.
Vendi ynë prej tyne u ndot
E me pleh na mbushi plot
E sa shtohen mot për mot
Sa shum janë he vdekshin sot.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

PJESA E DYTË

Tash pi të kuqa veze o Shqipni
Mprehe zanin me i këndue çiftit të rij
Këndo he zemra të këndoftë per herë
Se tash po i sheh si ke me i pasë per nderë.
Frymzim un kurr prej teje mos u ndasha,
Ndihmën tande kërkoj edhe ksajë herë
Per ketë çift me folë tash gjatë e gjerë.
Djalin Rreso e quejnë, vashën Natasha.
Rreso nga rrealizmi socialist
Që ashtu si ndriçon rryma elektrike
Llampën, ashtu kjo rrymë kaq artistike,
Cilindo ta përshkoj e ban artist;
Nsaj t'Enverit që bani at mrekulli,
Që kur i ven sasisë partishmeni,
Pa nji pa dy shëndrrohet në cilsi.
Prandej Rreso iu vu në shpindë botimit
Çdo shkarravinë e tija i hipte çmimit.
Me pa si mungulloi ky "Fenomen"
Po ju tregoj si qe e sot çfarë bën:
Rresua jonë me msime ishte gafë,
Por punë s'i prishi hiç ky rrealitet
Biografia e mori kaliqafë,
Nga fillorja në universitet.
Prodhonte proza, poezi, poema
Të larmishme si ngjarjet e partisë,
E në çdo shkarravinë i printe tema
Enver "emblema e partisë dhe e poezisë"
U ba si ai që fati e nxen mik
E don si e si t'ia bajë të gjitha t'mirat
E ndeshi me të lumtunin dekik
Me vajzën qe i permbushë t'gjitha dëshirat.
Ma i perkueshëm s'ka si bahet çifti,
Janë të brumosun nga e njëjta krunde,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" KODER

Janë si të thuesh thoni i nji gishti,
A por ma saktë si qyrrat e nji hunde.
Je i ambël Rreso s'ke nevojë për mua
Per famën tande flasin shkrimet tua;
Ndaj për atë qe t'fali ty gëzimin
E mue frymzimin po e zgjas tregimin.
Pra ja ke mori Rresua për grue:
Nji veper të shkelqyer të partisë
Se familja e sajë na ishte krue
I urdhnave t'kreut të qeverisë.
I pari un jam Perëndija jote
Ndryshe do t'i perkasësh asajë Bote,
Qe do ta neverisnin vdekja e jeta.
Të gjitha çastet do t'i kesh shigjeta.
I dyti, në folsh për mue fjalë të këqija
Lufta ime ka me të ndjekë si hija
E trupit tand kudo që trupi t'shkon.
I treti, thirrjeve mu thuej po,
Urdhnat mi duertrokit e mi zbato.
E katërta, në don të rrosh me mend,
Kurr prindrit tu mbi mue mos i ven.
E pesta ,t'gjith anmiqve shtinu ethet
E t'jeshë për ta si vjeshta asht për gjethet.
I gjashti, n'shtet mos vill, grabit privatin,
Që s'ma sheh dot, as s'ia shoh dot surratin.
I shtatti sa të duesh bane kurvninë,
Por mos e shtin në shpirt ku ke partinë.
I tetti, rrejë vetem për timin hirë,
Pra rrejë, kur rrena yte më ban mirë.
I nanti, objektivat e lakmisë
T'jenë veç ata që i shërbejnë partisë.
I dhetti, merr veç aq sa të jap un,
Për ndryshe jeta jote keq merr fund.
Këtë rasat që xha Enveri u jep
Skllevërve të tijë ta mbjellin në çdo kokë,
Natashës tonë ia mbollen qysh në djep,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Ndaj kur u ba me dalë me shoqe e shokë,
Kush ia ngjiti revistë radio fonike,
Kush titujt e gazetave shqiptare
E dikush tjetër thikë ideologjike,
Kta mbiemna e banin ma krenare.
Rrezo e ço ia mbrriti shpejt rinisë
E në çdo vit e ngrente grada e re
U ba aq, aq e dashtun e partisë,
Sa për krye t'sajë partia bante be.
Kështu Natasha jonë mend trokolaqe
Rrezo e ço siç thashë edhe ma parë,
Fallet e saja ecën mbarë e mbarë,
Aq sa çdo punë i dilte fillë në faqe.
I jati roje i mureve të tmerrit,
Kush din sa të burgosunve u pat zanë
Kafshatën n'fyt me tytë të revolverit
E sa me hu të vdekun kishte lanë.
Ky gur nga ma të mdhejt e atij themeli
Mbi t'cilin u ngrit kshtjella ideologjike,
Ky rracë njeriu spijuni e krimineli,
Rrjedhë para rrjedhe i quejtun marka "m'fike".
Baballarët e tijë den babaden
Atdhe, ide, nderë, besë e fe i shitën
Me çdo pare që vlerë pat në këtë vend,
Per pare edhe vllaut ky ia zen pritën.
Për këtë shërbim që baba i Natashës
I bani shteti, i akorduen vashës
Bursën për në at vënd që andrroi.
Si lum Shqipnia për këtë vajzë qe rriti
E si lum vendi që këtë vashë e priti.
Në vendin e Natashave kur shkoi
Ta dinin kush Rusisë i shkoi në zemër
Të gjitha vajzat që e kanë këtë emër
Po qe se në Shqipni s'do t'mund ta sillnin,
Pa dhanë pa marrë në kryq do ta përdridhnin.
Veç për nji gja ajo atje ankoi:

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" KORÇË

Bubu si do t'ia baj, s'due të msoj!
Jo, jo për hirë të universitetit
Nuk rrij pa ia bâ dot qefin lezetit.
I msoi rruget e Moskës një për një,
Ma mirë se cilado që lindi atje;
Shpejt nuk pat skutë që nuk u njoh me të
Në shum prej tyne bani rrepete.
Por kur n' at qef u zhyt aq zhyt e mbyt,
Çohet dreqi e qefin ia zen n'fyt.
Në komunizëm plasi ajo shamatë
Që vitet do ta shndrronin në lëngatë.
Me Kinë Enveri s'u tregue gjuhë gjatë
Jo për burrni s'i mbajti krah e pajë
E rrejti mendja me u ba msuesi i sajë.
E por si ai qe dreqi n'vesh i thotë
Mshoji se do të jeshë ma i madhi n'Botë
Ndërzye nga premtimi i atij djall,
Ia nisi n'kupë të krejsë me u gervallë:
"Ndalou pak o beg se ka hendek"
Se un' Enveri nuk e ha at tek.
Un me Stalinin nuk jam pa hanë pisk
Ju rrotën e zhvillimit na latë n'disk.
Kur Enveri aty u ba mollë sherri,
Mauceduni e quejti moll sheqeri
Bashkimi sovjetik ia mbylli gojën
E hipi n'tren e ktej ia treti bojën,
Kur e qitën per bythsh përjashta Enverin,
Kina e vazhdoi me të gjith' tjerët sherrin.
E tu ngatrruen si qimet n'bashk të leshit
E t'ia perplasën njani tjetrit sheshit,
Sa s'dijë si mbet pa plasë timpani i veshit.
Si ato gratë që bashkë e bajnë kurvninë,
Mandej me njana tjetrën bijen teftik,
Shoqja shoqes i thonë çka dinë e s'dinë,
Ashtu Kina e Bashkimi Sovjetik.
Pse grindeni, a u ka lanë arsyeja?!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MIRAN BARLETI" SHKODËR

Tha Eurkomunizmi me miklime.
U tregoj un' si duhet zgjidhun nyja,
Ju veç i veni veshin fjalës time:
Paraja ,pjella ma e fuqishme e dreqit,
Paraja fija e lamshit të njerzimit,
Paraja, perëndija e të keqit,
Mjeshtria ma e përsosun e mashtrimit;
Paraja asht frymarrja e politikës,
Shplaka ma e ngjeshun në gojën e logjikës,
Gisht në kambzën n' armën e padrejtsisë,
Paraja plumb në zemrën e drejtsisë.
Atij qe n'xhep kuleta i ngelë lmuç,
Lëmuç i mbetet edhe çdo qëllim.
Shihni sa pare derdhë Kolibri i kuq
E shih sa larg e hapi spijunazhin,
Se s'ka bagtijë që rrefuzon silazhin.
Prisi që kombit ia rrëmben kuletën,
Me at' komb luen si qeni me nji sukull.
Ma të fuqishmin e shëndrron në kukull
E ku t'i thotë deshira e sheh vehten.
Atij qe i kapë kuletën paraliza,
Mundet po me i ardhë hakut edhe miza.
Me m'falë Natash se rasti nga ti m'shmangu,
Jo pse ata janë mishi e ti langu,
Edukata me endje e pa endje,
Të huejve u kushton ma shum vëmendje.
Nuk dihet nëse e zgjueme, apor fjetë,
A në kllapi s'e din as ajo vetë,
Se mendjen as nji herë s' e pat në qendër,
Natasha vetëm din se pau ktë ëndërr:
Kur përpara nji dere t'madhe sosi
Mbi t'cilën ishin shkrue këto fjalë:"
Këtu leni çdo shpresë ju që po hyni"
Natashës iu afrue me ngadalë
Dikush e tha: dëgjo: un jam Minosi.
Hyn shpejt e ma shpejt del, se mbyllet dryni.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" H K O D E R

Shpirtin që do ta leshë pas kësaj derë
Do ta shpërblejmë me ma shum se nji nderë.
N'at vend që s'e përshkruen forca e fjalës
Qindra e mira zanë ajo dëgjoi
Ndjeu at që vrriste fort: "Doiç Yber ales"
E krizmën e kamxhikut që e qelloi.
Sa herë kjo moto nga ai djall të vrritej,
Aq herë ajo goditje n'të përsritej.
Ai vrriste: Mue nji' Stalinit dhetë,
Se ky qe dhet herë ma tiran se vetë
Te dy ne me keqbamje shtyme caqe,
Por ky ma shkoi ma larg e shum ma larg;
Sa vrava un në luftë, ky vrau n'kohë paqe
E në çdo fjalë kullonte gjak e jarg.
Vërtetë un' nuk përfilla zot as fe,
Por kundra tyne s'holla kurr' rrufe,
Si Stalini ma e flliquna abece,
Që u përpoq me zhdukë çdo fe mbi dhé.
Nuk detyrova kurr' as nji artist,
Që të shpikte rrealizmin nazist,
Si Stalini rrealizmin socialist.
Individit në pronë s'i vuna dorë,
Që ta vorfnoj si t'gjorin ma të gjorë.
Ai asht kryedjalli im tha, s'kam fjalë tjera
Natashes iu kujtue se mbyllet dera,
Iku duke dëgjue fjalë të ndërprera,
Prej kamxhikut t'caktuem nga skëterra.
Ndërsa po delte ndeshi në Minosin.
Ai tha tani që shpirtin ktu e ke,
Kurr' skllave e ndërgjegjes ma nuk je.
Nuk të pengon ma gja për me ba çmosin
Me ba gjithmonë shum keq e ma shum keq,
Që t'marresh sa ma parë titullin dreq.
Shpirti që ke tek ne e t'kqijat tua,
Të rrisin e të bajnë alamet dreqit
Qe tua kalosh te kqijave ma t'keqit.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MUSINBARLETI" SHKODËR

Ta them per t'miren tande se të dua.
Pastaj Minosi foli me nji tjeter,
Ai ne fillim të fjalve i dha nji letër.
Minosi hyni e doli porsi era,
Përpara tijë nji dreq fiksoi tek dera.
Natasha sa po e pau at burrakoç
E pat të letë ta njihte at brinoç;
Me nji farë dashunije sytë ia holli
Se qe brinoçi që Natashën polli.
Nji burrë këndej, Stalini n'tjetren anë
E nisën bisedimin mbarë e mbarë:
Të thirra me m'tregue për shqiptar.
Po, për Shqipninë mund të flas gjatë e gjanë,
Si t'ishte goja ime e Enverit,
Që na kaloi si mue, si Hitlerit.
Prandej të them un dijë aq për Shqipninë,
Sa t'gjith shqiptarët bashkë sa un' nuk dinë.
Si mos ta dijë çfarë bahet në at hon
Ku ngadhnjitar sistemi im sundon?!
Por kush je ti që m'thirrë të përgjigjem
Në ketë vend ku un' per jetë po digjem?!
Un' jam Gjergj Kastrijoti që kam ardhë,
Nga ata që kurr farë faji s'kanë të lajnë.
Por kur shqiptarët vinë n'at vend të bardhë,
Në vend të mi përgjigjen pyetjes, qajnë.
Kto fjalë Stalinit i shkaktuen zgërdhirje
E tha:shum prej shqiptarve kanë nji prirje
Zani i tyne pson të njajtën çirrje
Me urraaaa për çdo lloj prijsi që u ban thirrje.
Kujtimi yt shqiptarët kurr s'i lodhi
Ma shum se t'emërtojnë me tandin emën,
Ndonji shkollë lagjje a skuader futbolli.
Shumica s'dinë n'qe mashkull a por femën.
E ndërsa mue shtoi gjoksit duke i rënë
Skulptura shqiptare më ka gdhenë
Edhe piktura e sajë për mue flet

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Këtu jam monument, aty portret
E emnin tim e ka edhe nji qytet.
Ty qe për Shqipninë me ditë kambngule,
Shih sa më çmojnë nga se të mirat shemba
Kush don qe shqipetart t'i dhurojnë lule,
Duhet të mbjell aty sa ma shum' gjemba.
Mendoje vetë çka asht për mue Tirana
Edhe kur më urren i gjith' njerëzimi
Edhe atherë kur më urren Zvetlana,
Nga Tirana ma ban me sy ngadhnjimi.
Mjaft ma zbulove të Shqipnisë mënxyren,
Zëvendsi yt e paska ba skëterrë
Tha Gjergji e lotët ia pushtuen fytyrën
E ia pushtuen për të paren herë.
Minosi me at kamxhik si bisht rrëshaje,
I ra Stalinit e egër e kanosi
E ai si zorra e trashë plot tepërmaje
Kërceu atje nga ku e pat nxjerrë Minosi.
Tani shohim si do t'i dalë kjo andërr
Vajzës që i bani shpirtit dreqin dhandërr.
Kur Natashës iu kput qefi rusisht
E erdh 'të bante qefin shqip serisht,
Me vehte tha: Enver të kam anmik
Se qefin sa Bashkimi Sovjetik,
Ma shendrrove në qefin sa Shqipnia.
Por veç pakëz kaloi pa iu msue shija
Se at qefin kryesor që don ajo,
E ka fare të thjeshtë me e gjetë kudo.
Për tjetrin qef të quejtun spijunllëk,
Këtu levdatat janë me shum' bollëk
E shpërblehen me grada e me lek.
Sa po Natasha në Atdhe u kthy
Në vend të shpirtit dreqi i që mbërthy.
Për këtë vajzë e tjerët si ky mall,
Që duen me i qëndrue partisë në ball,
Ky prijsi ynë i madh nisi të shkruej;

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Megjithse vonë, asht ma mirë vonë se kurr
Se tash qe prirja e tij ka marrë kaq turr
Perveç se do t'na i kryej punët e fronit,
Do të na shkruej s'paku nji vepër n'muej,
Kështu do t'ia kalojë Gjorgj Simenonit.
Aty Natasha u krell per më thithë ajkën
E komunizmit e punoi si bleta
Për me mesue si me grahë sharabajkën
Mirë të ngarkueme me fitore t'veta.
E çfarë nuk kishte shkrue ky gjigant
Me at stilin e tij aq elegant.
Çdo fjalë e tija bash si nji diamant
E çdo citat i tij nji elefant.
E me shumicë si uji i Valbonës,
Qe Marksin me ta lanë në bisht t'balonës.
Kështu ky Marksi jonë gjirokastrit
Nga njeri dreq arriti me u ba mit,
Mit me merita sa s'i nxen tefteri,
Sa s'i kanë bashkë Stalini as Hitleri.
Çfarë nuk mësoi Natasha nga Enveri,
Si duhet me na qethë e rrue berberi,
Si rrobeqepsi rrobat të na i presë,
Si t' rijt e t'rejat alla Enver me u veshë,
Si duhet me këndue, me qa, me qeshë,
E me çfarë rritmesh duhet me vallzue,
Me ke me ndejë e çka me bisedue,
Çfarë të dëgjojmë e ç' duhet të shikojmë
E cilat shkrime duhet t'i lexojmë,
Si t'provokojmë e si të akuzojmë,
Kë të urrejmë e ke të dashunojmë,
Për çfarë të heshtim e për çfarë të flasim,
Si t'duertrokasim e të brohorasim.
Për çfarë s'na flet ky Enciklopedi
Për prozë, poezi e dramë e komedi.
Duke mësue vajza shpejt u ba
Her gojë marrshinë e her- her pushkë pa za.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARTIN BARLETI" SHKODËR

Në mbledhje u ba nana e propozimeve
E para miratuese e vendimeve
E vrik bahej flamuri i zbatimeve.
Ajo studjonte edhe n'koh të gjumit
Veç si e si të ishte e para e zgjedhun
Në çdo tubim me pak a shum' të mbledhun
E para n'tavolinë të presidjumit.
Nji ditë me t'jatin vajza ra teftik:
Pse ma ngjite kte emën kaq anmik
Si emni i Bashkimit Sovjetik?
Ai iu përgjegj: atherë e patëm mik,
Ky gabim ndreqet tha i gjori at
Hiq shkronjat"asha" e len vetëm natë.
S'do mend, s'kam si baj ndryshe o veshgjatë
Si aktore që i kushton të gjith' kujdesin
Rrolit nga i cili pret ma shum' suksesin,
Stërvite tmos arrihej prej ndoj orte
N'fjalime referate e rraporte.
Ja edhe emnin tash e solli ndryshe,
Jo emën si i atyne që u banë gjyshe.
Emën të rij e me partishmëri
Natë, fare shkurt që t'duket kinezri.
Ky emën jeton baras me marksizmin
Jo at që na kujton revizionizmin.
Emën qe tash tingllon kakofonik,
Si emni i Bashkimit Sovjetik.
Nji zakon i partisë e tremi tepër
Sot mik me nji, neser anmik pa tjeter.
Kshillat e Enverit më janë shkalla t'famës
Ai asht autori e rregjizori i dramës
Per lojën tonë n'at dramë ai asht zhuria
Njeriu që luen pas kshillave të tija
I jep at çmim që ia andrron lakmia.
Sundimtare do t'jem, mvarsat rreth meje
E un afër atij që asht krye kreje.
Për miqt dritë, anmiqt kokërr rrufeje.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" S U K O D E R

Ndërsa vajza po i rriste vehtes veshët
Iku i jati nga se i vinte t'qeshet.
Nji ditë karrjera e sajë shum' e suksesshme,
Ndeshi në nji pengesë të pa lezetshme.
Me popull në nji mbledhje politike,
Që Nates iu ngarkue me pergjëgjsi
Po fliste per zakonet prapanike
Paragjykime e për, bestytni;
Filloi për me i sqarue vi për vi
Aq me bindje të flet për Perëndinë,
Sa thue at 'kompetencë s'ia mbajnë vaporrat.
Thue pllambë per pllambë e hulumtoi Gjithsinë,
Kjo që der dje ka ditë me shtypë veç morrat.
E kur në fund të mbledhjes thanë paska
A ka kush ndonji pyetje, fillë nji plak
Përpara sajë por si nji bombë i plaska.
Përgjigjen e çdo pyetje e dua hak:
Për sa qindra miliarda vite dritë
E përshkove Gjithsinë dhe e eksplorove?!
Qeveri kund si tonën a takove?!
Që për mirëqenje shifra pjell e rritë.
A pave diktaturë proletarjatit
Nga e cila proletarët arratisen
E njerëz që pranojn të qeverisen
Si të smuret që s'ngrihen dot prej shtratit?!
Në Univers që pave vend për vend
A u perpoqe ta çosh ktë sistem
Që për plaget shpirtrore ësht melhem
Një melhem i prodhuar në Xhehnem?!
Me që Gjithsia s'paska dirigjent
A pave kund andejza ndonjë vend,
Që u nevojitet ndonjë inteligjent,
Që tua beje biografinë talent?!!!
N'ka ndonje vend si tonin në Gjithsi
S'ka si të quhet ndryshe veç Shqipri
E udhheqsi i saj quhet Enver

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" KODER

Në gjenetikë ma i madhi inxhinjer.
Njeriu veç biografinë e mirë ta ketë
Pa për talentin ia krijon ai vetë.
Betoven nse i lypset muzikant,
Çek fek Ainshtajn nse i duhet fizikant.
Jo, jo kurr mos qoftë thënë o Perendi
Që në Gjithsi të ketë dy Shqipëri
Se në GJithsi do t'kish dy fatkeqsi.
A nuk thonë asaj mendje e ndritur,
Qe e mendon partinë si një hardhi,
E cila mund të ketë prodhimtari
Vetem kur herë pas here t'jetë krasitur?!
Veç maja ma e lartë s'i duhet prekur
Se pa at maje fruti s'ka të pjekur.
Ata që nuk e duan tonën parti
Përse i mbajmë ketu a s'janë gjarpra në gji?!
A s'do t'ish mirë tu japim ktë denim
Të gjith t'i flakim tej në Perëndim,
Atje ku perëndojnë me qindra e mira
Të asajë Bote ku sundon errsira.
Si kur zëre se ke të ishte ke,
Si kur zëre se je të ishte je,
Nuk do t'ia kishim kujtë lakmi mbi dhé.
Mjerë syri e mjerë veshi e mjerë goja,
Mjerë zemra jonë ku na ka zbritë nevoja.
Gjith presidjumi ngeli disi pykë
Nga fjalët e pa prituna të Llazit
E por si enë e mbushun për mbi grykë,
Shumica në at' sallë pëlsiten gazit.
Ju lutem shum dëgjoni thirri Nata,
Por populli me vrap doli nga salla
Se dreka e darka ishin nëpër rradha,
Rradha t'gjata, të gjata e ma të gjata.
Plakut të gjor, kryengritës si tallazi,
Qe u perplaset shkambive nëpër brigje
E bahet pikla, në shtpi i vajti gazi

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODER

Ç'u ba me të mbet pyetje pa përgjigje.
Ja motoja e të zhdukunve pa zhurmë:
E pat edhe nji tjetër pa lanë gjurmë.
Tash po i kthehem hjerarkisë së shtetit.
Nusja ma e përgzueme e banketit
Asht Nata ajka e personalitetit.
Gllënka e llokma e ndjekin njana tjetrën
As nji sekond pushim s'ua japin dhambve,
Pa mbritë n'stomak e nxen e reja t'vjetrën,
Shum krena u vunë nën urdhnat e kambve.
Fizarmonika, dairja e gërrneta
As nji kangë t'partisë s'ia marrin anën
Se n'ato kangë gjejnë vehten, babën, nanën
Sigla asht: "Enver Hoxha tungjatjeta."
Kanga duhet e ngjashme me gazeta
Ndaj kangët me Enver e me parti
Kërcasin me ta ngjitë në vesh e n'brij.
Në ktë banket u ftue gjithfarë horanit,
Qe e matë shpirtin me hapsinë të zhabës,
Për hirin e së cilës nanës, babës,
Pushkën ia ven, pa le pastaj tiranit.
E gjora ti o poezia ime,
Me çfarë malli u more e po merresh,
Në çfarë llumi po të takon të kredhesh
Me gjetë frymzimin për poemen time.
Ja ai në krye të tavolinës parë
Se cilës koken ia mbështeti n'cep
Asht bash ai burrë që puna i shkoi mbarë,
Punë qe i thotë xhepit si lum ti o xhep.
Me i ra krejt shkurt gjatë jetës fëminore
Ai hajr as sherr s'qe i zoti me i ba kujë,
Për sa i perket mësimeve shkollore,
Rreziku veç se hapte vrima n'uj.
"Qaj hall kalorsit se i varen kambët"
Tek ne ka fat abstrakt e fat konkret
Fati konkret në dhjam ti lëvizë dhambët,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "VANKO BARLETI" KODER

Fati konkret të veshë me shum' pushtet.
Ky fat e mori hopa edhe Dullën
E si desht Dulla vetë ia sheshoi udhën
E futi në at punë që korrte pare
Ma shum se çdo punë tjetër në ktë vend.
Për at punë shkolla nuk i vlen kurrsend
Mjafton aritmetika fillestare.
Mbas pak fati i dha shpërblim moral
E dyqani shpërblimin material.
Me shum' mjeshtri përdori nën banakun
Me të eprorve ua fitoi marakun.
E ata shpejt maraku me të i zuri
Kështu e njohën fillë Abdulla Hakun
Disa e thrrisnin: Abdulla Kusuri,
Por ata ishin njerz pa perëndi.
Cave u thrriste pllumba, cave zogla
Doni kusure, por nuk kam të vogla.
Kto fjalë e ndreqnin punën bukuri.
Dulla kurr dredha nuk i bante erzit,
Por peshorja luhatej sipas blersit.
Revizorve ua lyente duert me dhjam
Ndaj pas kontrollit për te linin namë.
E kur e pau se hilja e parë u shterr
E la at punë e hyni banakjer.
Nga ai lokal pat shmangë çdo kamarjer
Se kamarjeri veç se nxirrte sherr.
S'e gjeje kund nji tjetër aq puntor
I gatshem me punue gjashtëmdhet orë
Dyqanin veç ta kishte vetë në dorë.
Përse ta ketë nji tjetër banakjer
Këtë as pak të mirë s'e ka ky shtet
E si të kishte frigë nga vehtja e vet,
Përse them kshtu, në sajë t'shokut Enver,
S'ia kam lakmi as mbretitt me kunorë.
Mirqenja ime por si mal me borë
E ardhmja ime asht tamam si qielli

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODËR

Krejt i kthjellet e prespektiva dielli.
Se mos kokat e tyne kanë ma mend,
Qe besa more Dullë fole me vend.
Qe pija t'mos i sillte kujt dam kresë
Nga ato damet qe shkaktojnë ngatrresë
Të jetë vend qefit pa as nji rrëmujë,
Lypset me u përdorë nga pakëz ujë.
Përse e kemi ujin me bollëk,
Që mos me e përdorë me pishmanllëk.
Pijes i hidhet uj sa e don lezeti
Po aq sa na i hedhë qumshtit edhe shteti.
Nuk kam si me dalë un "ma i kshten se Papa"
Kolegve të mij nuk po u rrijë hiç mbrapa.
Pak furnizim sa për justifikim
Tjerat i shes si t'ish dyqani im.
Meze shtëpije per secilën pije,
Tavolinave tona u kanë hije,
Jo si mezet e shtetit pa farë shije.
Shpirti i tregut asht vetëm privati,
Aty gjenë çka don ti jo çka don ai
Kur shteti mi sjell mezet këtu gati
Disa thonë: Ai që i bani ka shum faj;
Jo, ai nuk ka pikë faji nesa un,
Rroga e ban jetesën tonë hajni,
Ndryshe ekonomia mori fund
Norma e cilsia janë në anmiqsi.
Këtu këtijë mendim i briti ndal.
Tash mbylle gojën e kurr ma mos fol
Për hirë të interesit material,
T'keshë turp me e permbysë at' ideal.
Që kungujve u bahet pjedestal.
Si pat fitue aty pare me spol
E boja i doli me ato pije e meze
E transferuene në nji dyqan tjeter
Prap fanelatë puplin, stof, basëm beze.
Nga gjasht' centim për vehte në çdo metër

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Duke i pa mirë punët shoku Dullë,
Tha: Sot kasolle, neser bahem kullë
Vetëm nji gja mue po, ka me më lodhë,
Me duhet krye kjo e ashtuquejtun shkollë,
Se gjoja shkolla e ban mendjen ma t'hollë.
Matematikë, fizikë e gramatikë,
Si në at kohë kur kishte veç ibrikë;
Shkollë lamsh e li perzie me politikë,
N'letërsi, gjeografi e histori
N'pes' a gjasht fjalë tri janë partishmëri.
Marksizëm emni, landa Enverizëm,
Shkollë bash për mue që linda per çilizëm.
Sa do që më jep dorë për punë të mdhaja,
Kush dreqi ulet prap n'bankat e saja.
Mos ndi hiç Dullë se mbarë do të shkojë jeta
Der sa n'Shqipni t'rrimojnë jeta e kuleta
E të rrimojnë partia e biografia,
E ytja e e shokve tu do t'jetë Shqipnia.
Ja Dullë pra shkolla me korrespondencë,
Ku nuk lypsen vullnet e intelixhencë,
Veç duert e mësuesave të njomen,
Në krye të katër vjetve ke diplomen.
Fati për Dullen fort po i binte darjes
Në shkollë notat e tija linin namë,
Tek puna sekretari i ndërmarrjes
E në shtëpi mirëqenja e tij dhjamë.
Nji herë me thanë s'i doli hurç përpjekja
Për kë e ndimonte qe Abdullah Ndera,
Për kë t'i duhej qe Abdullah Vlera
Për t'pa randsishmit qe dorëdhanë si vdekja.
Nxansat si Dulla kanë të drejtë të mburren
E jo ata që kokat thejnë ndër shkollë,
Abdullahit i thohet mendje hollë
Pa ditë çfarë landësh ka e merr maturën.
Duke e pa se po i afrohej udha
Pa pasë nevojë të lunte kambën vendit

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MIRAKABLETI" SUKOD ER

I ngritun peshë lart e ma lart prej shendit,
Por si rikani zemër mori Dulla.
Njanin pushoje n'vend se po vjedh shtetin,
Tjetrin sille vërdallë me rritë rushfetin,
Ato që nuk i bindeshin si grueja,
Sulmoj se ndjekin moda e shfaqje t'hueja.
Urrejtja, namtë e shamjet e vegjlisë,
I dhanë nji bursë në shkollen e partisë.
Dulla ishte i lindun për Marksizëm
Ato mësime i dinte n'kambë e n'dorë,
Dinte ku tokat ishin nen çilizëm,
Si janë sivjet të korrat n'Pukë e Vlorë.
Cila parullë u vu në filan mur
E çfarë nuk din ai për qytet e fshat,
Biles po thonë se ka aq shum kulturë,
Sa e din se Marksi emnin Karl e pat.
Çdo dituni me ma të shëndoshen bazë,
Thotë "Kapitalin" Marksi ka kryevepër,
Në të kapitalizmin ban qerpazë
E s'mjaftohet me kaq, din shum ma tepër:
Edhe betohet pa kurr farë ngurrimit
E benë e ban për ideal t'partisë,
Se Marksi leu e vdiq para çlirimit,
Kur fashizmi u ba zgjedha e Shqipnisë.
Kur vuenin njerzit tonë nga pazhvillimi
Biles kur vuente i gjith njerzimi i mjeri,
Që s'e pat fatin ta udhheqë Enveri.
Sa mendet i ka Dulla e sa të holla,
Ne krye të kater vjetve e tregoi shkolla,
Që i dha diplomën me të gjitha dheta,
Ndaj kush s'i bante Dulles "tungjatëjeta",
Sepse në Shqipni quhen me mend,
Ata që t'mdhejve dinë me u ba" Amen."
Po ata shokë që i paten dhanë maturen,
I nxorën bursën e i dhanë diplomën.
N'kohë të zgjedhjeve i vunë kandidaturën

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BERLETI" KUKËS

Njani prej tyne thirri n'zyrë Tomën
E i dha t'lexonte të nesërmen nji letër
Në nji mbledhje të zgjedhjes për pushtet,
Në at lagje ku duhej zgjedhë pa tjetër,
Shoku Abdullah Haku deputet.
Po, po e zgjedhim fillë per ideal
Metë dalë jashtë nisë me lexue at leter,
Që u ba shkak të binte në kanal,
Plot e për plot me uj të thellë dy meter.
Duke u mbytë ai shau me fjalë banale
Drejtuesat e ndërmarrjes komunale,
Që s' bajnë tjetër veç hap e mbyll kanale.
Toma i shkretë i bamë me u nxjerrë me grep
Tha: "Ky shtet asht qep - shkep more Rexhep."
Si i ban punët ky shtet thotë fjala e urtë
Që do ta shohim në ktë prrallë të shkurtë:
Nji lepër i emnuem magazinjer
Në magazinë me mall plot e për plot
Me denga që as dreqi s'i ngre dot,
Ba lamsh e li lepuri sillet kot,
Veç puna n'bordoro shkonte sheqer.
Malli i pa krahishtuem me e hanger djalli
Besa nuk ka ma mirë o lepurush
Se pa i lujt gishtat me t'tingllue kavalli
E ç'randsi ka për mue nse u zbraz a u mbush?!
Veshët i lujti në shej miratimit,
Në magazinë ia behi nji ari
E s'desht të flasë kurrgja në sy të tij.
Ariu i gjorë i kputun prej udhtimit
U ul permbi nji deng e i dha nji letër.
Lepuri i njerëzishem fillë e pyeti:
U lodhe? ai ia ktheu fillë: kjo punë më mbyti,
S'jam un për shperndarës letrash, për punë tjetër.
Mi jep ti shpërndajë un kto letrat tjera
I foli lepurishi kur ai kreu
Mori çantën e fluturoi si era

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODER

Çel e mbyll syte prap çanten bosh ia ktheu.
Kur hyni lepurushi n'magazinë,
Pau mallin krahishtue për bukuri
"Të falemnderit, tha, o mik ari"
Nga puna jote magazina ndrinë.
Perse ti mik ari nuk vjen këtu
E un të shperndajë letra në vend tënd?!
Ariu ia ktheu: e drejtë do t'ish kështu,
Por kur sundon gomari nuk don mend,
Të gjitha punët ecin kuturu.
Ne e jetuem t'vertetën e ksajë prralle,
Ju ishalla kohën tonë e queni prrallë,
Se ishalla jeta juej nuk ka kanale
Si at ku Tomën e nxorën veç sa gjallë
T'ishte mbyt ky Tom n' nji hendek
N' ndo nji udhtim t 'bam për spijunllek
Zanat që e ushtronte edhe pa lek
Them do t'i kishin ngrit nji lapidar
E i kishin shkrue vargjet e nji poetit:
- Ktu ra Toma n' shërbim t' shtetit
T' partis' ton' e popullit shqiptar.
Por tash që letrën ia rrmbeu kanali
Kush përveç Zotit s' din si po i shkon halli.
Mir' por per Tomën s'egziston Allahu
Kultura ateiste e ban të mburret,
T' ishte do e besonte Abdyllah Haku,
Abdyllahi me at alamet kulturet.
Kur të më thonë ti letrën mir' s'e ruejte,
Se zgjedhjen ton' të pa randsi e quejte
E se ty fare nuk ta bluen stomaku,
Që deputet t'jet Abdyllah Haku.
Shkuemja jote n'spital justifikim
I mungesës n' mbledhje për at' zgjedhje,
O zot si mund ta shlyej këtë gabim.
Kur bjen n' lak, he, del po deshe lakut,
Edhe nga laku i kujt, iAdyllah Hakut,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Që t'ban ta hapësh varrin me duer tueja
Bubu, mbarova un' fëmijtë e grueja.
E vetmja punë që m'lodhi deri sot
Qe vetëm me firmos në bordero
E tash me e humb kët pun, o Zot, o Zot
Eh, Tom shkreta, tani e tutje jeto,
Jetove zor me rrog' e jo pa rrog'
E tash armata e njerzve duer kryq,
Që nsa ty dje s'u mbet kurr xhepi shog,
Do t' bajn sehir me ty o Tom, o qyq.
Ti me duer kryq e pa nji kryq në xhep
Sillesh por si qen zorrësh ne thertore,
Ose me bisht të kazmes merr e jep,
Ose me ata që dlirin nevojtore.
Hajnia pa e nis mir' në duer me plas,
Matrapazllëku fill me mbet në klas
Si u bane more qyq shinjestra e krerve,
Mos jan' të kqijat që u bane tjerve?!
Tash biografia jon' humnera jon,
Humner' e thell siç asht fjala gjithmon,
Humner e tmershme por si goj skëterre,
Tash e tutje sekondat më jan tmerre.
Të rrosh a të mos rrosh kjo asht çështja,
T'kesh frig nga fjala, të kesh frig nga heshtja.
T'kesh frig shtëpin e tmerr ta mendosh udhën,
Në çdo fytyr a trup të shohësh Dullën.
Drejtori im shoku ma i ngusht i Dullës,
Ç' po t'i bjen kokës time si daulles.
Jo kush ktë hallin tim nuk e provoi,
Jetën e vdekjen t'i kesh frig njisoj.
Ku jam s'rrij dot, ma tutje s'mund të shkoj
Diçka duhet me ba e s'dij t'mendoj
Në qoft se me t'vërtet do t' ket Zot
Djathtas m'gjuen Zoti majtas m'gjuen partia,
Toma në mes si t'ishte tabel zborit
O Tom, o Tom çka jan' kto koh' të kqija,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" KODER

Sa pak i zgjatka rahatia horit!!!
Horit si mue i shkoka mundi kot
Me mbyt kohën merr nji gazet në dor
Çka nuk të pjell kur ban dreqnushën ndrikull,
Të bahet për çdo gja "Ferra Brahim",
Tue lexue ndeshi nji artikull
Germat e tija sa i madhi gazep.
Ato shkronja sekondat ia ban orë
"Nji arm e anmikut quhet sabotim,"
I shkreti Tom u ba me hy në djep.
Si ta urdhnonin t'vdiste doli n'punë.
Njeriun e parë aty ndeshi drejtorin
Drejtori at' dit qe buz e hundë
Se me tu kthye n'shtëpi pa e krye zborin,
T'shoqen me burr' të huej e nzuni ngusht.
Me mue e ka tha Toma e u ba grusht.
Ai qëndrim Tomës gozhd n' krye iu ngul
E i ngjau se t'gjith i binin asaj gozhd
E mendja e tij u nis turrshëm teposht
E n'fund t'pjerrtinës s'truve vrik iu ul.
Mos i bjer kujt se shpejt ta paguen shpinda
Dulla e Toma u ndan nji dit në Vor
Tomen e priti bukuri çmendina,
Ndersa Dullën Kuvendi Popullor.
Koha tregoi se s'paskan qen hiç prralla
Fjalët Dulla u lind "natën e Kadrit"
Mbasi ditët e netët iu ban shkalla
Nëpër t'cilat u ngjit n'maje t' kuadrit.
E pra sa ma nalt Dulla e shokt e tij
Posht e ma posht e gjora Shqipni,
Si ta tërhiqte prej nga posht gjithnjë
Djalli i ferrit mos paçim pun me te.
Karrjeres vet në maje iu ngjit Dulla
N'at koh qe as koha nuk don ta kujtoj
Kur mirqenjes ma e thikët iu ba udha
E mbar Shqipnia mbet me gisht në goj.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODER

Nji gja që s'do t'besohej as në prrall
U ba po, po mjerisht aq e vërtet,
Sa e vërteta s'do t'donte me qen gjall,
Se at që Enveri ia bani se vërtetës
As vet ferri s'do t'ia bante vehtes.
Pra me fal Dull se u shmanga disa hapa,
Prap' tek banketi un po kthej për mbrapa
Atij tash do t'ia thur vargjet e mija,
Se s'kan kah shkojn, ende s'u ka dal pija.
Tash turru vrap Shqipni pas përparimit
Pas Enverit gaforres s'qytetnimit
Që ndjek zanin e krrokëve t' Stalinit,
Marrsh funebra e demokratizimit.
Dëshmitaret e këti rrealitet,
Jan Abdyllah Haku e shokt e vet,
Do prej tyne të ftuem në banket.
Shih at pran Dulles bukurosh si turtull,
Që nga gëzimi i çiftit u ba xurxull.
Për me ndërtue pellgun e yndyrës
Me turp e zëvendsoi cipzen e ftyrës.
Ky aq me rrena çdo rrencak e mund,
Sa po t'i zgjatej hunda si Pinokut,
Gjith trupi i tij do t'ishte vetëm hundë.
Gënjeshtra i siguroi çek- fek bablokut
Nji post ku vendi ka ma shum nevojë.
Shihja në krah të majt at shokun tjetër
Që të dy duert i mban gjithmon në gojë
Njanën me got e tjetrën me piru
E të duket se han me goj' e mjekërr
E qe yndyra i rrjedh nëpër gush jarg,
Ai asht nji shok që na ka ardh nga larg.
Nji prej miqve që ka n'çdo kontinent
Seicili nga kta miq nji krye spiju,
Qe na ndimojn si paret me i paksu,
Se ma ato pare ne kudo mbi dhera,
Mund t'përhapim t'Enverit ton idera.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODER

E kjo arrihet vetëm me agjent,
Për të cilet e gjora Shqipni
U shndrrue në ar ku mbin argjent, flori.
Uria jon' spijunve u ngop livrizën
Qofshin kta shqiptar, apor të huej,
Ata qe n' Bot si duhen gja askuj
Sa her thot Dulla e shokt' e shokut Dull,
Ata për në Shqipni fill marrin viz
E për hirin e asaj lakmi lëvriz
Buellin e Shqipenis e bajn miz
Ndersa mizën e Botës e bajn bull.
E ngjan si kur kjo djersa jon po thrriste:
Mos, mos, more Enver dora tu thaft
Ky partive Marksist -Leniniste
Merrni, merrni se kemi mjaft e mjaft.
Ku jan e s'jan rrekruto maskarej
Ne shtrëngo rrypin që ata ta lirojn
Zhgarravit Enveri e ne përkthej
N'gjuh të hueja që bota t'i lexojn.
'Brohoritja maklladat tash e parë
E ai botoj ne të gjith Botën mbarë
Miliona kopje pa u ble nji për bë
E merri bota falas për ve- ce
Tash vjen me rradhë përgjegjsi i mbrojtes'rendit
Që n'sajë të spijunazhit t'jashtëm e të vendit
Shqiptarët kundreshtar që n'Shqipni vinin
Për me çlirue popullin e tyre
Në gracka që u kish thurë dollari binin
Qe ky i binte gjoksit ndajë në zyre,
Në saje të Kin Filldit në Angli
Që i shiste çlirimtarët me flori.
Për të brendshmit e pat fare të letë
Ktë zhduke se asht kundra socializmit,
At ndryje se s'bindet servilizmit
Ktë ndiqe se ka linde në kohë t' Fashizmit,
Ktij banja zi sa ta lanë vetë ktë jetë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Si ai qe halë n'përpeq veç don me gjetë.
Brij tijë po rrin i madhi i shndetsisë,
Që thonë e zgjati jetën mesatare
Siç'i duhet genjeshtrës ngadhnjimtare
E bija e Partisë Punës Shqipnisë,
Që n'sajë të përparimeve t'mjeksisë,
Në vendet e zhvillueme të Planetit,
Turri i smundjeve sa po vjen e tkurret
Në sajë t'ktijë përparim ky marroq mburret,
Si t'kishte shpikë gjithçka i shërben shndetit.
Ktu thonë asht falas çdo vizitë mjeksore
E falas ke qëndrimin në spital
Por shum' vizita janë të asaj dore
Qe vetë mjeku i thotë mjeksisë më fal.
Megjithse ne nuk kemi as nji faj
Të gjitha fajet tona i ka ai
Qe në Shqipni e bani çdo njeri
T' jetë vehta e prrallës "Lepuri e ariu"
Se ç'vlera ka për shtetin tonë njeriu
Shih farmacitë ku i shetitë receta
Asgja nuk gjindet çka e kërkon djeta
E sa ngjasin dyqanet me kuleta.
Ky xha Enveri i shërben të smurit
Ashtu si bujku kaut per hirë të zgjedhës
Aq i mashtron tru djerrat ky djersvjedhës,
T'mendojnë se i kanë borxh nji farë kusurit.
Pak ma tutje vjen ai qe ka në dorë
Tregtinë e Shqipnisë brenda e jashtë
E ketë degë jetike ia njeh rrashta,
Si njeh gomari artin muzikor.
Nuk thashë për rrimë atij ia njeh mirë rrashta,
Se ata njerz qe janë për sanë e kashtë
Sa herë në dorë u ngelet dopjogjashta,
S'dinë me mendue me mend por veç me rrashtë.
Perime, fruta e bulmet e pije
E shkurt gjithçka që goja e han me shije

BIBLIOTEKA PUBLIKE "SAMI BARLETI" SHKODËR

Ne e hamë me sy, të huejt e hanë me gojë
Se po thonë se vendi paska shum' nevojë
Me rritë mirëqenjen me makineri,
Që për eksport prodhojnë me shum' cilsi.
Na duket si kur thotë tregu shqiptar
Un' dij veç kto dy fjalë: Eksport, valutë,
Lekun nuk due me e nxanë fare në gojë
Përveç se kur i them: Ik pare mrrutë,
Dyqanet tua do t'i la gëzhojë.
Shqipnisë i jap ushqimet që i shanë
T'lëvduemit ia jap mikut tim eksport
Se ai m'don fort e un e due fort.
Un jam veç me sterlinën e dollarin,
Se veç ato ma ngrejnë mue itibarin
Ndër tregje mue me quejnë ma bujarin,
Mue më quejnë ma humanitarin.
Kush do na i merr prodhimet ushqimore
Duhet me e ditë se ky eksport do quejtun:
Uria e Republikes Popullore
Socialiste e shqiptarve t'vuejtun.
Ushqimet tona që s'i don eksporti,
Neper dyqanet tona i merr ma i forti
E biles edhe ai kur del prej rradhe
Dimën në qoftë ka djersë të verës madhe.
Gjysmën e jetës në rradhë e shkojmë në pritje
E sidomos kur bahesh pensionist,
Gjysmën tjetër e humbë në brohoritje
Për t'mirat e bollëkut socialist.
Tash vjen në rradhë ministri i ndërtimit,
Qe gja pa thanë për të nuk lanë banesat.
Si more i pa ftyrë s'na le fytyrë
Të ketij shekull kështu janë ndërtesat?!
Kohën e gurit e turpnon kjo mnyrë.
Ku të rrahë ty ia priti një njeri
Zotrote paska hall për bukuri
Ti na dashke me paraqitë epokën

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODËR

Ne vuejmë per nji strehë ku t'fusim kokën.
Ju rranga zhdrange biles në kambë jeni
Ju shihni hekurudhen po thotë treni
Si të ishte e punueme me qeser.
Jam breshkë në krehasim me trenat tjerë.
Kushdo me biçikletë si ta qesë cekën
Biçikleta e tijë fillë ma len teken,
Se un eci mbi punën vullnetare,
Vullnet qe e lindë huni deri n'palc
E shpirtin na shtërngon fort, fort me balc
E kto shtërngime i quejmë ledhatare.
Kur dhuna ketë fjalë bajate e beri
E zevendsuen me fjalezën "aksion"
Edhe gomari qeshë kur e dëgjon
Si t'thuesh jo Enver Hoxh, por Hoxh Enverin.
E ky aksioni ka edhe nji motër
He ajo mos e pastë jeten e gjatë
E quejnë "fushatë", mirqenja e quen lëngatë,
Qe kur të msynë s' të len kurrgja në votër.
Si mjer ai krah ku ajo del për gjah,
Bagtitë e individit bijen rrah.
Fushatë- lëngatë për ne janë sinonime,
Që sa herë vërsulet ban veç krime,
Tash me grabitje, tash me arrestime,
Si shpatë që për mbi kokë na vringëllon
E si vercak që jetën na shkurton.
Pse u ankove ti tren ndërhyni rruga
As më sheh mue tanë gropa, vranga e gunga?!
Rjepë si nga ujqit nji stërvinë e lopës
Në kohën kur të huejtë me serën tonë,
Shtrohen disa nga rrugët e Europës
E turp s'ka fare ky kryetari jonë.
Jemi si nji kufomë mbetun në koca
Të pa deja për qerre e karroca.
Tash ven nji shtresë asfaltit t'hollë si ruba
E theje fillë se u harruen jashtë do tuba.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
SAMRIN BARLETI
S H K O D E R

Vazhdo tjetrin se mjaft me ktë u ndale,
Mos e përshkruej ma me shum hollsi
Me ktë ministër nuk ke leverdi
Me të poemes i vjen era hale.
Si lum poema ime n'kë ke ndeshë
Aty fillë pas ministrit të ndërtimit
Je ndeshë me vargaxhin qe din me i veshë
Vargjet me ideologjinë e Enver Stalinit,
Ide nga e cila fyhet poezia
Ashtu si mund të fyhet Shqipnia,
Me i thanë: Je vendlindja e Enverit.
E ky kamaleon i karakterit,
Qe dje nuk dinte as me u grahë bagtive
Sot asht ogiçi i zhgarravinaxhive.
Tash me i ra shkurt e jo kryq e terthurë
Se me u ndalë shum me të i shtohet randsia
Ky asht nji Enver Hoxhë në minjaturë,
Siç asht Enveri minjaturë e tija.
Pas ksajë pyke vjen nji farë oborrtarit
Prodhues i të ashtuquejtunave kangë
Për ndonji vesh si gomat me opangë
Që i shpon vështirë gjylpana e opingarit,
Por kur kanga asht hymën i lavdisë
Per mitin komunist të Shqipnisë
Guxo e thuej s'asht ajka e melodisë.
Pas tij na vjen nji tjetër shpirt ngërdheshun,
Që gjoja i siguron këtij shtet rrojtje.
Enveri e caktoi me u marrë me mbrojtje
E ky me hekur malet i ka veshun
Hekuri djersa e popullit të çveshun.
Po a thue ky hekur mund t'i bahet ny
Anmikut po t ë donte me na msy?!
I marrë asht ai me i ra murit me kry?!
A s'ka hapsina tjera ku me hy?!
Kështu anmikut nuk i pritet hovi,
Por kush bahet si Boris Godunovi

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODËR

Perpara vehtes do të ndërtojë diga
Me ato marrzina që i kshillon friga.
Ky që ka frigë prej njerzve e prej shejash
Shqipninë e bani si fultere kshtejash.
Me tunele, bunkera e Me Ce Re,
Që kur për vehte popullin s'e ke
Edhe n'kohë lufte shndrrohen në ve -ce
Jo ma n'kohë paqe janë plot e për plot
Me at me nderë me thanë që s'e them dot.
E sa kushtojnë sa nji Shqipni e re
Me qytete që e tashmja i ban fring
E ky tirani ynë po pelset ding
Nga se nuk ka rraketa Kruiz -Pershing,
Për me e ba Botën suz si t'i kish qefi
Që i ksaj Bote ky të ishte kllefi,
Për me u tregue sa ma komunist.
Na shpiku muzeumin ateist
E ku e krijoi, në mes të Shkodrës plakë
E at që penën e shendrroi në flakë
Kundra anmiqve të këtij Atdhe
Medet karikaturë aty e ke.
Sa turp e faqe e zezë o shqiptar
Në at muzeum, poeti ynë kombtar.
E kush veç nesh qe në fillim t'njerzimit
E ka në histori këtë farë krimit?!
Të ngjanë si kur poeti ynë kombtar
Për të thotë: "Po u qes un' ju në shteg
Ky djall që i grah sot popullit shqiptar
E i duket vetja ma se Skënderbeg
S'asht tjetër veç se nji lapër i klasit
Asht orta e Gomarit Babatasit.
I shkreti ky qe mendja e madhe i thotë
Mjafton të duesh e fillë ia mbrrin qellimit
Poetët i kanë rrajët n'kohë o rrotë
Jo rrotë e gja, rrotë qe s'i vlenë shërbimit."
Historia për fat në këtë banket

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MIRUSH BARLETI" SHKODER

Ka nji njeri të vetin interpret
Të ngjarjeve shqiptare ma në pah,
Që për Enverin asht i djathti krah
Ai thotë: "Çka don ky popull ban partia
Populli s'don as kisha as xhamija
Si mund t'ia detyrojmë kur s'ia don shija?!
Nuk e duem Zotin, mos t'na dojë as ai.
Nji herë e mirë ta dijë i gjith njerzimi
Populli asht dëshira, ne qellimi."
Shiko si turpit i smadhohet danga
Ja kreu i industrisë tonë rranga- zhdranga
Qe e ka emnin "industri e re"
Makineritë e saja për muze
Për ktë marrzi të huejt na ndajnë me gisht
Këto marrzi na bajnë me u quejtë me bisht.
Mendoje vetë e thueje sinqerisht
A ka si quhet ky shqiptar pa bisht?!
Pas tij vjen tjetri që e quen aksjomë
Cilëndo rrenë që e ka gënjeshter t'njomë
Mbiemni i babes tijë pat qenë Rrencaku
Ata që e njohën thonë ia patën vënë
Për shum' gënjeshtra, ose për nji rrenë
Së cilës kurr nuk i arrihet caku
At' cak e tejkaloi vetëm Besniku
E famën si çdo kujt ia dha publiku.
At mbiemën Besniku e shndrroi n'bujar
Se me bollëk gënjeshtrave u erdh haku.
Besniku si çdo mot edhe sivjet
Me duer plot e në tabelë të nderit,
Por si çdo rrenashkrues nji prillin pret,
Festën e gazetarve të Enverit.
Nji herë Besniku foli të vërtetën
Me kë e foli un nuk mund ta dijë
Veç po u them me ç'fjalë e përshkroi veten,
Jam gazetar që shkruej në Shqipni.
Cillido ka stomak e din mirfillit

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Se n'mos u rrotullofsh si lule dillit
Pas leverdisë mbete me gojë prej qiellit
E ma pa vlerë se ka nji krunde miellit.
U çmenda un të bahem Galile
Të vdes urije e të më bajnë hero
Kur trupi im të kalbet per nën dhe
Cili të dojë të bajë me mue çfarë do.
Hasani mund kafshatën me ma njomë,
Hasani mundet me më ba kufomë
Prandej sa herë që të më thotë Hasani:
"Besnik un them gomari fluturon
Si thue ti?" Un' ia pres: "Si urdhnon,
Biles un' them ma shpejt se aeroplani".
Ai me rritë graden rrogën e prestixhin
M'ven mbi Ismailin, Vasilin e Luigjin
E t'gjith dëshmoret që e çuen tek froni.
Jam i dokrrave të tija Ciceroni
A po jam Shehrazaade e ai mbreti,
Që për mue asht xhehnemi e xhehneti
Nëse më mbarojnë prrallat nisë qahmeti.
Fjala gënjeshter shqip rrimon me mjeshtër
Kesaj mjeshtrije i kushtova jetën.
Gënjeshtra xhepin kurr nuk ma len bosh
Me tu mbushë mendja me e thanë t'vertetën
Duhet me e nisë: "Të rrosh a të mos rrosh"
T'drejtën njeriu këtu nji herë e thotë
Të dyten herë e thotë në tjetrën Botë.
Kte epitaf po thuej ia thurë gjithkush:
"Qe budalla, ndaj shkoi si qeni n'rrush".
Un' jam me ta gjykoje vetë ti Gjokë
Si i thon atij që i bjen murit me kokë,
Si i re ti e ndonji mendje smurë
Që thotë Shqipninë ta nxjerrim nga ky tmerr
Se në mos sot do të na dinë dikur
Për kto prralla do t'thonë: "Na ish nji herë."
A po të duket ty se po i ban nderë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" E HKODER

Iriqit mos me e lanë me ndej në ferrë?!
T'dhimset iriqi se po e therin ferrat
Për këtë keqardhje qeshën edhe derrat.
I mendshmi që të ketë në jetë sukses
E t'ardhmen mos ta ketë me krye në thes,
Merr gënjeshtrën si ma i pa damshmi ves.
Thuhet se rrenat shpesh e hutojnë masën
E prandej rrenat shteti i paguen shtrejt
Rrenën bi·sull e bajnë veç budallejt
Të urtët me gënjeshtrën veç gajasen.
Gajasen si gajasem un me vehte
Sa herë shtyllat ia nxa ndonji gazete
Me rrena që si kur të ishin landë
S'do të peshonte gja në Botë aq randë.
Ma mirë me del t'jem lolo i historisë
Se të jap shpirt në kthetrat e urisë
Më hutove me rrena mund t'më thuesh
Kur un 'them fusha asht mal e mali fushë,
Kur un' të them gomari fluturon
A kam faj un' a ti që e beson?!
Për ato rrena përse të urrehem,
Kur un nga kto gënjeshtra mirë shpërblehem
Mos do t'ndryshonte gja sikur t'mos rreja
Nji ma shum' a ma pak nuk çon kandar
Disa thonë jo at punë nuk do ta bëja
Por ti jepi Besnik tu dhashtë e mbara
Shteti ta çmoftë çdo rrenë si nji rubin
E u lavdrofsh si pak në Rruzullim.

EPILOG

Tash qe i erdh Enverit transferimi
Të shkojë nga Shqipnia në sketerrë
Cili do të kujdeset për këtë ferr
Kush i mirmban kto mure izolimi?!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Mos i leni të huejet n'as nji plazh
Se çdo turist, i anmikut asht mesazh
Ai asht gojë lirë, kcen rrok e asht besimtar
Si nuk duhet të jetë as nji shqiptar,
Ndaj çdo turist duhet ta quejmë shantazh
Nji Gorbaçov, a por Regan i vogël
Që kalanë tonë perpiqet me e ba gogël
Duke na thanë asht koha e Perestrojkës
Ndërsa ne jemi n'kohë të shkop e dojkës
Të thonë si t'duen, ne jemi kundra Dhjatës
Lirinë e quejmë demokraci borgjeze
Ndryshe do t'ishim si nji derë pa reze
E do ta hanim shpejt qafën e patës.
Prijsi na tha: "Nji popull që e qëllon
Fort e ma fort ai ty të rrin kulaç
Aq mirë i asht msue shpinda me kërbaç
Sa nji herë n'mos i bjen vetë ta kerkon.
Nëse na bije nevoja me ba lshim
Ta bajmë lëshimin pa ra në gabim
N'se lypset pluralizmi le të jetë
Por pluralizëm që ta bajmë ne vetë
Kështu punët bukuri do t'ecin
Edhe në bafshim nuse dordolecin.
Le t'bajmë pak si duem ne, e pak si ata
Që të na i kendojnë ksaj nuse marshalla."

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

BISEDA E DYTË ME KANIVALIN

——— Tash nji vjetë nuk jemi pa.
Në Shqipni hiç mos u ndal
Mos lodh gojën me thanë gja,
Se shqiptarët kanë ves t'keq
Me u thanë mos, bajnë ma për dreq.
Pasha mue e pasha ty
Pa heqë shkarpat që kanë n'kry
Që n'Shngjin djalli na i pat shitë
Fol sa t'duesh natë e ditë
Ke me i gjetë ti për çdo vjetë
Bash si don ai që qoftë tretë;
Se atij fjalën ia kanë dhanë
Me ba gjith si t'u ketë thanë,
Biles pasha kokën tande
Shum ma shum se atijë i kande.
Pasha besen more Gjokë
Un po ta besoj çdo fjalë,
Por n'Shqipni kam miq e shokë
E nuk kam si rrijë pa u ndalë.
Due me hy në parlament
Me ba kthesë due me iu lutë
E n'mos i ndryshofshin mendt
"Krofshin kryet e nxjerrshin trutë."
Se për shpirt t'Gjon Bombardonit
Për me u hangër por si qent
Nji thumbit tjetri patkonit,
Âsht ma mirë pa parlament.
Due me pa gazetat tuaja,
Rradion e televizorin
Sa e kanë ngarkue fjalorin
Pa nevojë me fjalë të hueja.
Due me pa moj zemra ime
T'komunizmit emertime

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Që gjithnji i ruen shqiptari
Për me qeshë me to gomari.
Due me ndijë at humor,
Që don t'bajë me qeshë me zor,
Me ato fjalë që as mendimi,
S'i duron, jo ma shqiptimi.
Me i thanë ato fjalë n'shkretinë
Shkretëtina e shpreh çudinë,
Jo ma aktore e aktor
Me e ba vehten aq për hor.
Këtu arti asht përllosë,
Me t'thanë mendja kanë vendosë
Ei përmbahen ktijë vendimit
Der sa jeta të jetë sosë,
Me ndejë n'bisht të përparimit,
O ma mirë me e thanë gegnisht
Jo n'bisht por dy gisht nën bisht.
Me që Evropa asht si po e don,
Si të thuesh nji medalion
Njana faqe dritën ndezë,
Tjetra faqe sterrë e zezë,
Nga kjo faqe e zezë shqiptarët
Mesuen shpejt me dalë të parët,
Ma të parë se doktrinarët,
Që kto msime na i dhanë,
Msime me nderë me thanë,
Msime kuku moj nanë,
Për këdo që don me i nxanë.
Se për sa i përket ksajë landë
Doktrinarët ja ç' na thanë:
Në shkollën oksidentale
E quejmë krejt nji gja normale
Me e mesue fmijtë sa ma parë
Edukaten seksuale.
Nuk mund bahet qytetar
Fmija pa e ditë ktë lande,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Që ia ban kulturën t'gjanë,
Duke shue kurjozitetin,
Pa e pritë fare pubertetin.
E me nisë mujtë e pa mujtë
Rrole t'rritunish me luejtë.
Që kur mosha tu ketë ardhë
T'dinë me dalë kta faqe bardhë,
Si kah puna si kahë goja,
N' perdorim t'prezervativit.
Vajzës kur t'ia lypë nevoja
T'ia dinë mirë kontraceptivit,
Që per hirë të qytetnimit
T'i mbajë n'çantë t' librave t'msimit.
Se po thonë do dijetar
N'mos ia hynë mbrapshtë e mbarë
S'ke si bahesh qytetar.
Me dashtë nji a dy a tre
Je si njerzit që qenë dje
Injorant që ç'ke me te.
Me dashtë katër, pes a gjashtë,
Nuk mund t'thuesh se kam dashtë
Me dashtë shtatë, tetë, nandë a dhetë
Thonë shum prapa nuk ke mbetë,
Por me kohën prap nuk je,
Se shum dhetshe mangut ke.
Ti me kohën mund t'marrshosh,
Vetem kur tmos t'i numrosh,
Me të cilët seks ke ba
Se nuk po të duhet gja
Me lodhë mendjen per me ditë,
Me të cilet ke fëmijtë.
Mendja vlenë me msue kulturë
Jo kulturën si dikur
Me studjue vepra shkrimtarësh
E me msue filozofi
E me u marrë me punë shkenctarësh,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Sot tjeter kulturë ka hy:
Sa gra ndrroi filan aktor
E sa burra iks aktore
Sa kjo artiste pat dashnor
Ai artist sa pat dashnore.
E sa mashkuj që bajnë emën
Shkojnë me mashkull, jo me femën.
E sa femna t' bots skenike
Janë për marrshalla lesbike.
Sot të njehet shum kulturë
Me sha kishën katolike,
Që po thotë kjo Botë asht çthurë,
Prandej duhet me vu dorë.
E don çiftin si dikur
Veç nji herë me vu kunorë
E kunorën mos me thye
Që familjen mos me e fye.
E me ba jetë dashunije
Pa pasë kurr dyshim atsije,
Se kur çifti asht i dlirtë
Kujdesë trup e kujdesë shpirt
Aty asht ndërgjegja e shejtë,
Aty asht familja e shtrejtë.
Ndërsa do dijetar të s'teshmës
Këto i quejnë Prralla të s'djeshmës
E prandej tempujt fetar,
Me priftën e hoxhallar
Janë me t'shkuemen, jo me ne
Ndaj t'i lamë veç në muze,
Se kjo koha jonë e re,
Nuk ka ma nevojë për fe
Nuk ka ma nevojë për Zot,
Nuk na trembë ma kleri dot
Ai kujton se jemi ende,
Injoranta si qemë dje;
Për hirë t'burrit, grues e fmive

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Me i vu kufi knaqsive
T'epshit, e të gjith lakmive.
Shpirti i trupit asht knaqsia,
E lakmisë që mbrrinë qellimin
Ai moral asht përëndia,
Ne knaqsi quejmë veç dëfrimin.
S'ka randsi n'kurriz t'kujtë bahet
Le të qahet kush të qahet
Le të gzojë kush mund të gzojë,
Humbsi t'qajë, fituesi t'këndojë
Pa ça koken me ndijë Gjokën
E ata që mendojnë si ai
Se lakmia qenka faj.
Poshtë ndërgjegjja rroftë lakmia
Që n'nji vend nuk rrinë të dyja,
Ndaj ndërgjegjen tej e hodhëm
N'vend të sajë lakminë e zgjodhëm.
Pra tash more miq të mijë
Këta njerz vojtun kso dore
Për me prishë ktë Rrokulli
Thoni ç'mund të kenë njerzore
Përveç trajtave trupore?!
E pra kemi zbritë n'at masë,
Që si kur kafsha të fliste
N' kupë të kresë do të bërtiste:
Sa shyqyr që jemi shtasë.
Jemi kafshë, por kafshë me erz,
Se nuk bajmë ne si do njerz
E un them me kqyrë hollë krejtë,
Kafshët kanë plotsisht të drejtë.
Paj disa duen me na bindë,
Se nuk janë as pak fajtor,
Homoseksual kanë lindë
E s'e kanë vehtën në dorë
Me u ba ndryshe nga ça s'janë.
Eh more zotni të mijë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Ju, i lumi Perendi
Për çka mendjën ua ka dhanë?!
Për me ba çka njeriu duhet
Nga e keqja mirë të ruhet.
Zotni, re ti a e ke vu
Dy magneta me i afru
Pole t'njajta ball për ball,
Me u bashkue nuk ia bajnë mallë.
Njani-tjetrin e mësyjnë
E mësyjnë e fort e shtyjnë.
Kur magneti që asht send
E njeriu që ka mend?!
E pra more miku im
Nse i hyn t'mbrapshtës në fillim
Sa do e mbrapshta t'jetë gabim
Mjafton me e persritë pak sa
Ajo ty ka me tu ba
Ma e domosdoshmja gja.
E nëse e lufton vesin
Edhe n'qoftë ma i forti ves
Lufta jote e mbrrinë suksesin
Se nga lufta vesi vdes.
Por kur ti dorëzohesh krejtë
E don vesit me i dhanë t'drejtë
Vesi shpejt të hipë kalurë
E të grahë kryq e tërthurë,
Kah të dojë e si të dojë
Se i vesit je ba lojë,
Ndaj je zhytë n'te deri n'fyt,
Nisë e e mbron si t'ish virtyt
E me t'thanë kush je gabim
Ti e quen "Diskriminim".
Thue kjo s'asht demokraci,
Nuk e meriton ktë emën,
Kjo âsht thjeshtë nji diktaturë
Nëse nuk na jep liri

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Me u martue burri me burrë,
Me u martue femna me femën.
Sa i fuqishëm asht ndikimi,
Shpesh e ka provue njerzimi
Për të keqen kur asht çeshtja,
Ndikim bahet vetë kurreshtja.
Çdo e keqe kur lejohet
Të propagandohet,
Shpejt e shpejt bahet modë kohet,
Jo si modë që ndrron mbas pak,
Por si modë që hyn në gjak.
Un lirinë nuk e kuptoj
Me i dhanë t'drejtë t'mirit e t'keqit
Sepse kjo do t'ish nji soj,
Me i dhanë t'drejtë Zotit e dreqit.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

NGADHNJIMI I GENJESHTRES

Rrenen qe ndeshet ne çdo hap të jetës
Nji ditë e pyeta si ia hell t'vërtetës?
Ia hedhi fare thjeshtë m'u pergjegj rrena,
Se kokat boshe mue më strehojnë mbrenda
E këto koka me kaq t'lartë përqindje,
Sa po hy mbrenda mue me bajnë bindje.
E vërteta asht dritë si ç'asht arsyeja
E ku hy un s'bahemi bashkë të dyja.
Un due at terr që e quejnë pa dituni,
Që shum shqiptar po luejnë mendsh pas tij.
Ja pra pse un e mposhti të vërtetën
E nga sa duket do ta mposht t'gjith jetën.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

SYZET E DJALLIT

Prralla që po tregoj i ngjet s'vërtetës
Ashtu si ti lexues i ngjan vetvehtes.
Thuhet se djalli e pat mbrritë suksesin,
Duke i shpikë do zyze me t'çuditë;
Çka të shohësh me ta se prapi e qesin,
Veç ra në hall kto zyze ku me i shitë.
S'la vend pa shkue me e shitë shpikjen e tijë
E kush s'ia muer me pare, as veresi.
Dikush i tha: "Pse sillesh kot verdallë"?!
As kush në Botë nuk po ta blenë ktë mall.
Kto mundesh me i shitë vetëm n'at vend,
Ku shiten para ardhsat tu "Shkarpa për mend".
Atje mundesh me shitë miliona palë,
Ti blejnë ma me deshirë se me ua falë.
Kush n'vend të mendve shkarpat tua ka
Këto zyze i duhen per me pa.
Kjo kshillë nuk e la djallin ma hiç pykë,
Por erdh e i shiti t'gjith ata gjyslykë.
U shiten e u lëçiten thonë shqiptaret
Me ia ble djallit ato syze t' paret.
Me kta gjyslyk që dreqi ua ka dhanë
T'gjith atyne që kanë mendjen e krapit
Nuk i shohin sendet sikur janë,
Por si don djalli i shohin për së prapit.
Prandej kto syze sa ma gjatë ti mbajmë,
Keq e ma keq ne vehtes to t'ia bajmë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

SHTETI E RENDI

Një burrë me namë u ftue nga një mbret,
Në kohën kur nuk kishte automjet.
Ndaj udhën der tek mbreti mysafiri
E bani mbi një kal ku qe ma i miri.
Por atë udhtim të gjatë me kal me shalë
S'ia doli dot ta kryente pa u ndalë.
Gjeti një vend me hije për rranxë malit,
Që vapa kurr nuk e pushtonte dot,
Aty kalorsi zbriti fillë prej kalit
E si u mbështet, nuk vonoj shum e u kot.
Dremitja e percolli n'gjum të thellë;
Sa po u zgjue tek kllefi e çoi dorën
Heu! tha me vehte ma paskan vra orën,
Me rrevolverin qe ma paskan vjedhë.
I hipi kalit prap e shkoi tek mbreti
E i tregoi se çfarë e kishte gjetë.
Mbreti e qortoi: "Si tash në rrugë me fjetë?!"
Miku ia ktheu: "Mendova se s'flenë shteti,
Shteti qe kotët shtet nuk quhet ma."
Mbreti u skuqe e nuk i bani za.
T'nesërmen mbreti e mysafiri i vet,
Dolën për një shetitje në qytet.
Diku andej një burrë e kishin varë
Po kjo i tha mysafiri mbretit pse?!
Mbreti ia ktheu: Ky ishte ai që dje
Na nxuni fjetë e t'vodhi rrevolverin,
Shteti e zbuloi e vehtes ia ktheu nderin.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

PULA

_____Nji ditë nji katundar e nji fshatar,
Ranë në kuvend si disa herë ma parë.
Fshatari tha nuk ka burrë në këtë botë
Ashtu si kujton ti krejtsisht të plotë.
N'dashtë t'jetë i rijë e n'dashtë të jetë i vjetër,
Çka të thotë grueja do të bajë pa tjetër.
Shoku ia priti un nuk e besoj
Të gjith burrat nuk mund të jenë nji soj.
Për njani tjetrin, jo nji soj nuk janë,
Për gratë e veta janë nji soj të tanë.
Meqense vetëm prova thotë t'vërtetën
Tha tjetri un kam qef me e bindë vehtën.
Ndaj mbasi shum kanë çelë e shum janë rritë,
Po marr do pula e gjela kesh me i shitë.
Po hy si mysafir në shtpi të jueja.
Ku t'shoh se ligjin burrit ia ban grueja
Pa u kallxue shkakun, mos me u ra ndesh,
Po la nji pulë gjoja si për peshqesh
E ku të shoh se burri grues ia del,
Pa u ra ndesh po la peshqesh nji gjel.
Kush di sa herë iu desht në shpi me kthye
Me marrë shum pula që at provë me e krye.
Nja dy gjela i mbajti sa me thanë
Nuk jam pa ta n'qoftë puna kund me i lanë.
Kur ja në nji shtëpi na qet siraja
Me gjetë nji burrë me fjalë tepër të mdhaja.
Hej, grue i foli ai luej ato duer,
Hynu shpejt punve e mos u len kusur,
Mbushe këtë sofër me çka m'shkon për piri
Gostit si e meriton miku ma i miri.
Gratë dunë urdhnue për me i shpejtue veprimet,
Për ndryshe fillë miklohen nga llastimet
I tha mikut cigaren duke e dredhë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BABLETI" SHKODER

Mos me ba si i them un e fus në hell.
Të lumtë ia priti miku, qenke vula
E çdo vendimi, tamam zot shtëpije,
Kudo që sundojnë gratë un kam lanë pula
Ti meriton nji gjel në shej dhantije,
Veç gjelat ngjyrash ndryshme më takuen
Më thuej çfarë ngjyre e pelqen ma parë?
I zoti i shtëpisë e thirri gruen
Si thue ti grue çfarë ngjyre me e marrë?

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

PRRALLA E TORTËS

Frymzimi m'tha: Sado që të vijë rrallë
Pa gja në dorë nji herë me thanë s'të vi
Edhe sonde të erdha si githnji.
Dhurata e kesajë here âsht nji prrallë,
Nji prrallë që thotë sa të keshë veshë me ndijë,
Për at që s'ka veç veshë, por edhe krye.
Tash hapi veshet n'i paç hapë ndojherë
E venua mendjen mirë fjalve të mija.
Siç na mëson të gjithve historia,
Kjo histori në përgjithsi e mjerë
E sidomos kjo historia juej,
Që me fjalë bindse po na thotë kështu:
Padrejtësi ke edhe nëpër t'ĥuej,
Por strofkën padrejtsia e ka këtu.
Siç do të na tregojë prralla e ksajë tortë
Na ish nji herë nji burrë shum, shum i fortë,
Që për pleqni e thrrisnin ca të gjorë.
Nji ditë shkoi me nji tortë t' vogël në dorë,
Ku e drejta dhe e pa drejta ishin mbledhë
E po prisnin me ankth fjalët e tija.
Secila tha: Mue tortën ma ka sjellë
Ai tha: e solla për njanen nga ju t'dyja.
T'drejtës i tha: Un nuk u hy në hak
Ti e meriton të tanë e kjo as pak
Se e vërteta na thotë ti n'rregull je
E ashtu asht, por gja me marrë nuk ke
Se kush nuk asht i zoti me e nxjerr vetë
Çka i përket s'e meriton ta ketë.
Ta meritosh do t'thotë me i mshue aq sa,
Për t'drejtën tande mundesh vetë me ba.
Se kur ti rrin duer kryq e vend numro,
Ti vetë i thue së drejtes: Mos më mbro.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

MOSUJDIA

Në nji katund të bukur në Shqipni,
Ndërtuen nji kishë të vogël simpatike.
Banorët e atij vend ranë në godi
Me u ardhë nji prift që t'bante mrekulli
Me ndryshimet e mundshme atmosferike.
Ky kusht la kishën pa nji prift në te
Nga s'pranonte as kush me shkue atje.
Nji ditë nji prift i dha ksajë ngecje fund.
Më çoni mue tha, shkoj un n'at katund.
Padër ti e din çka duen, je prift i rijë.
M' ndihmojn ata me e ba at mrekulli.
Por sa arriti prifti në at fshat
Me at kusht fshatarët nisën me e nxanë mat
T'dashtun t'krishtenë at kusht që m'keni vu
Me ndihmen tuej un kam me e plotsu
Me ndihmen tonë?! Padër ç'po thue kështu?!
Zoti e çon shiun si e meritoni ju
Ju veç më thoni, doni shi a diell
Se un pas qefit tuej do ta baj fill
Malësorët u gzuen sa ma nuk ka.
Pas disa ditve nisi shi me ra
Jo shi e gja, por shi me ba hata
U turrën vrap tek prifti do malsorë
E i thanë: Padër, ti që e ke në dorë
Ndale ktë shi, se nuk e duem kështu.
S'kam si e ndaloj ua ktheu: do tjerë nga ju
Erdhën e m'thanë: O prift, aman, shum shi
Duem aq shum shi, sa toka krejtë me u ngi.
Prandej ky shi nuk ka se si të ndalet
Nëse të gjith nuk baheni nji fjalet.
Kjo prrallë u bije përshtat disa shqiptarve
Veç me folë hak ma shum parlamentarve
Që nuk ujdisen as nji herë për bé,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BERATI" KUKËS

Pala palës me i thanë sot mirë e ke
Diell me dashtë njana tjetra për inatë
Thote: ne duem shi e biles me shtërngatë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

KOPRACI

Si në rastet kur fjala fjalën qet
Tek nji koprrac biseda jonë u ndesh.
A din me m'thanë e pyeta mikun Llesh
Pse thonë: "Koprraci han mutin e vet?!"
Ta kallxoj un burimin e ksajë thanje:
Koprraci aq anmik âsht me dordhanje,
Sa do t'donte të parën jashtaqitje,
Goja e bytha ta kenë gjithmonë përsritje.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

MJEKSIA E TË SËMURËT

O Zot i mshirshëm nji i smurë i tha:
Ma parë se të më qosh tek ndonji mjek
Më merr, se fjala mjek, rrimon me lek
E un o Zot i madh nuk kam para.
Per me u shërue duhen lek me thasë.
Pa pare s'lanë spitalit me iu çasë,
Në qoftë se nuk i jep t'parin rushfet
Rojes së derës kot tek dera pret.
Në qoftë se e paguen ktë taks të hajme,
Ndesh taksën tjetër pakëz ma të majme.
Pastruesja që pastron me duer përmbrapa
Të thotë: Po të shoqnoj un disa hapa
Ti e din vetë, un rrogen e kam t'letë
Nji fjalë e mirë e imja ta mbron jetën
Ndaj pakëz fare n'mujshë me e luejtë kuletën.
Ndeshë infermjerin, ose infermjeren
N'dispozicion thotë do t'më keshë të tërën,
Por gja pa gja s'i duen as djemët nanat,
Prandej shpërblehen sa ma mirë gjylpanat.
Pas ktyne që t'lanë qesen lakuriq,
Ndeshesh në portafolin bullafiq
Pronari i portafolit sa qivuri
Thotë: Punë parash, m'intereson i smuri,
Un e kam mendjen vetem tek shërimi,
Puna ime e ka mendjen tek shpërblimi.
Mue me vjen keq se ka me t'ra me ble
Çdo ilaç që n'farmaci vetem e ke.
Se janë dakort ata në qeveri,
Mos me e ba spitalin farmaci.
Ju e dini, ne s'mund të bajmë as gja,
Mbasi të mëdhejt nuk na lanë leverda.
Ndaj ne i paçim e ata na paçin
Kështu ne gjithmonë bashkë ta ndajmë kulaçin.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODER

INTERVISTË ME DEMOKRACINË

Tani më thuej demokraci shqiptare
Ç'ndryshim të solli e sotmja me atherë,
Kur t'patën vu mbiemnin proletare,
Kur për ca qe Parajsë e ca skëterrë,
E për me t'ba demokraci t'vërtetë,
Sakrifikuen gjithçka e deri jetë?!
Keq po më vjen, veç pa ta thanë s'më rrihet
Ndryshimi im tashma nga kush nuk dihet
Dje m'paten baballartë e djemve t's'teshmes,
Sot më kanë djemt e baballarve t's'djeshmes,
Tamam ashtu si thohet nga Shqipnia
"Dje Ali Hoxha e sot Hoxh Alija".
Dikush po thotë: "Luftë klasash nuk ka ma"
Luftë klasash the?! Jo luftë klasash e gja,
Por me t'u pështirë vehtja se je gjallë,
Sa t'athershmen me e puthë e me vu n'ball.
Ata që mue mu përkushtuen atherë,
Kaluen nga ai ferr në ktë skëterrë
Ata që germa "i" i ka padron t'pikës,
Ia presin me gërshanë gjuhen kritikës.
Shkrimtarët e sistemit komunist,
Perfaqsuesa t'Rrealizmi Socialist,
Qe shkruen gjithmonë si deshti diktatura,
Thonë: "S'ban me i kritikue se janë figura".
E titujve qe u dha fundrrina e llomit,
Të komunizmit ktyne t'bijve t' Momit,
U shtuen ma t'naltin titull "Nderi i Kombit"
Marshalla i qoftë ksajë krenari shqiptarësh,
Që kshtu e përzien të bardhen me të zezen
Të njejtin titull këta soj shkrimtarësh,
Me shejtneshen shqiptare Nanë Terezen.
Demokraci a do t'ia arrish cakut
Shqiptarve me u ndryshue mentalitetin?

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARK BARLETI" SHKODËR

Në qoftë se don me t'thanë bash rrealitetin,
Nsa i ndryshon ngjyrë lamja me uj zezakut.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

PASUNIA

Kur isha fmijë e pata ndije prej nanës
"Se nji i pasun n'Parajsë s'mund të hy dot
Nësa nji deve nëpër vrimë t'gjylpanës"
Ktë fjalë tha nana e ka thanë Krishti Zot.
Për me ma ba sqarimin sa ma t'plotë
E pyeta pra përse në këtë botë
Të pasunit të vorfënve s'u gjinden?!
Nana u pergjegj: Se Zotit nuk i binden.
Ata përpiqen me gjith shpirt me e ngrit
Paren mbi Zotin e i thonë: Zot ti je
E djalli mendjen aq ,aq ua ka rritë,
Sa t'mendojnë vetëm jeten për mbi dhé.
Dikush thotë, pasuniku nevojitet
Se me at pasuni punson puntorë
O, nuk e ban për ne more të gjorë,
E ban që pasunia e tijë të rritet.
Po ta bante për ne do t'ish pa tjetër
Ma mirë se ne nji pllamë a po nji metër,
Jo nji qind fish, nji mijë, a nji milion
Kto diiferenca Zoti i dënon.
Nji njeri i ditun me të drejtë ka thanë:
"Virtyti âsht njishi, tjerat xero janë
Për me i shtue vlerën njishit që i prijnë
Në mos qoftë njishi xerot hiçi i shkrinë".
Ndaj kujtë ndihmon sa e lejon mundsia,
Atijë mund t'i bekohet pasunia
Jo me ndihmue ku ndihma nuk ka vlerë,
Por ku edhe Zoti vetë ta din për nderë.
Ata që me kto vargje nuk përkohen,
Se pasuninë e venë mbi t'madhin Zot
Do t'thonë për mue: i gjori shkruen kaq kot,
Nga se s'ka tjeter mnyrë me kalue kohen.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MIMA BARLETI" SHKODËR

"UN E KAM FRIGË HISTORINË"

Lasgush Poradeci

Due me t'pyet tash un ty shegë
E çdo kend t'kombsisë shqiptare,
Po të ishte Enveri gegë,
Ç'e folme do t' ish zyrtare?
Nëse t'saktë e ke ndërgjegjen,
Ksajë pyetje ia jep përgjegjen,
Ndryshe je e nzanun mat,
Si gjuhtari me mëkat.
Pa më thuej more zambak
Që e ke gjykimin art
A ka si me u quejtë standart
Çka vendoset me dajak?!
Nse përgjegje s'don me dhanë,
S'don të drejtën me e thanë.
Pse u hoq folja paskajore
Që e kanë gjuhët prendimore,
Ku e ka t'metën gjuhsore?!
Nëse heshtë nuk je e urtë,
Me urtijë i ke la duert.
Tash po t'pyes un diçka tjetër
Do shkrimtar të rijë e t'vjetër
Le e rritë në gegëni,
Korifej në letërsi
Gegnisht shkruen vepra madhore,
A do t'kish gja ma mizore,
Se me i lanë t'gjitha pas dore
Der sa t'mbetën në harrim,
A i thonë ktijë qytetnim?!
Kush lufton gjith at thesar
Që na ban t'gjithve krenar,
A ka si me u quejtë shqiptar?!
Nse përgjegjen e ngurron

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Edhe ti ktë luftë e don.
E kongresi i "drejtëshkrimit"
Që e bani at farë krimit
Tri të katërtave t'shqiptarve
Me u heqë gjuhën e t'parve
Veç se i pelqeu Enverit
E kujtdo mendoi si ai
A nuk asht ma i madhi faj?!
A nuk asht ky kulmi i tmerrit?!
Nse nuk miraton këtë
Ti ke mbetë ende
Sikur ishe dje.
Tash due më m'kallxu,
Standartistat tu,
Po mos t'ishin mat,
Rrinin nji sahat,
Pa kërkue debat?!
Nse thue s'asht kështu,
Ja ku jemi ktu
T'gatshëm për mejdan
Por ajo s'ua mban
Se aty duhen kokrra
E ata kanë veç dokrra.
Në tandin standart
Që ti e mban aq lart
Un moj zemra ime
T'gjejë nji thes gabime.
Jepi vehtes ti
E m'gjejë s'paku nji
Në gegnishten time.
Që t'mos mbesë marak
A kam pasë un hak
Që t'kam thanë kështu
Ja do shembuj ktu:
Nëse je ndopak i ndishëm
Asht tamam me t'ba me qeshë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Kur ti foljes me u veshë
I thue n'vehten e parë vishem
E pra o zotnia jonë
Veshmbathje a vishmbathje i thonë?!
Ti thue i gjuhës jam lulishtë
Mirë pra tash un due me t'thanë
Ti i thue rërë, un i them ranë
A ranishtë, a por rërishtë?!
Ti më thue mos me e përdorë
Ma gegnishten si gjithnji
Un them borë, ti thue dëborë,
Kush ka t'drejtë un a por ti?!
Ti më thue me standart
T'gjitha fjalët mirë përdorën
Dëborëbardha me shum art
Po këndon "Luledëboren".
Un them zani e zanore
Si pas teje moj amore
Thuhet zëri e zërore.
Un them dreni e drenusha
Standart si pas teje
Thuhet dreri e drerusha
Thuhet n'ktë farë feje?!
Âsht çudi me u çuditë lopa
Se ma lene vetë
Pse dyzet jo katërdhetë
Si e thotë gjith Europa?!
E ka prap çudi
Ja ç'kakofoni
Që të ban me u tallë me te:
Një qind e një zet e një
Standart lene e mos e zgjat
T'ka mbetë dopio gjashta n'dorë
Un them Vlonë e ti thue Vlorë
A vlonjat, a por vlorjat?!
Standart po i ndaloj qortimet,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Nuk po t'bije ma n'qafë
Kush mundë t'i numrojë gabimet,
Kur ti vetë je gafë?
Gafë që vehten e mban lart
E i ban vehtes me sy
Si ata që edhe ty,
Mund të quejnë standart.
Standart, pjellë e diktatorit
Tash ma ik tëhu,
Se po t'ish standarti kshtu,
Duhej t'hiqej prej fjalorit.
Tash u kthehem përsëri
Standartistve t'mijë
Hajde, hajde o zotni
Sa poshtë u ka ra nënbishtja
A kaq vlerë paska gegnishtja,
Sa me i marrë dhetë nder nji mijë?!
E pra shegë n'mos qofsh e zoja
Më m'përgjegjë çka t'duhet goja
A por s'flet se t'ka dalë boja
Ba me çue shkrime gegnisht
Ndër gazeta qesin bisht
Nëse don për t'i botuar,
Duhet shkruar "n'gjuhë t'njësuar"
Marshalla se çfarë njiesimit,
Marshalla standartizimit
Hiq e hiq e hiq e hiq,
Hiq fjalor, frazeologji
Gramatikë e letërsi
Mbeti shqipja lakuriq;
Si e dëshmon Mehmet Elezi,
Na mbet shqipja gjuhë këndezi.
Qanë standarti me t'ngjeth misht
Sa herë shkruen ndokush gegnisht
Qanë e qanë e shkrihet n'vaj,
Kahë ia ndjen madhshtinë e sajë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Se kjo shqipe asht standarte,
Standarti asht gjuha m'çarte.
Veç po, tha nji plak nga Kruja
Shyqyr kemi fjalë të hueja,
Që s'na lanë në baltë
Kemi do gojë mjaltë
Disa gazetar
E parlamentar
Që me u dukë të ditur
"Njerëz shum të ngritur"
Flasin tash e parë,
Shqip për t'huej jo për shqiptar.
Nëse don për të botuar
Duhet t'shkruash në "gjuhë t'njësuar"
E përse more i uruar?!
Kshtu ia mbron t'drejtat njeriut
Sikur macja ia mbron miut.
He si mund t'i dalësh lakut,
Nuk i dilet lakut hakut
Un tash Shega due me t'thanë
Më të drejtë ti më ke mbytë
Edhe un veç due me t'pyet
E pergjegje me më dhanë
E të lutem mos ban bisht
Sa shkrmtar tosk shkruejnë gegnisht,
Sa shkrimtar gegë shkruejnë tosknisht?!
Gjuhë standarte quhet kot
Asht tosknisht plot e për plot.
Geget thonë: Jemi mësuar
S'na vjen dot për ta ndryshuar.
Pse shkrimtar pashë jetën
Këtë bisht e qet,
A nuk e ndjenë vehten
Ndryshe shkruen e ndryshe flet?!
Veç kur je i ftuar,
Për të ligjëruar

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

N'medje a n'teatër
Toskë karat njizet e katër.
Sa mbaron at standartisht
Vazhdon t'folunit gegnisht.
Tash më thuej ti,
A je ai a ky
A je nji a dy?!
E ja pra mor tungjatjeta
Shklasin gegt t'drejtat e veta
Kur i shklet Radio Maria
Ku duhej t'kish selinë drejtsia
E t'buçiste fjala e klerit
Fjala e gjuhes madhështore,
Fjala e letërsisë madhore,
Që i jep Shqipnisë vend nderit
N'letërsinë botnore,
Që për shqipen bânë aq punë
Me u thanë tash mihët në Bunë,
Thue se ishin xhuxhmaxhuxha
Se tha pader David Xhuxha:
"Standart flasim tash e tutje
A nuk ishte ajo nji ngutje
Konferenca ipeshkvnore
E mbështeti at masë mizore
Që pat marrë tiran Enveri
Kundra punës bâ nga kleri
Me i dhanë shqipes nji vend nderi.
Kur e mori ktë vendim
Konferenca ipeshkvnore,
Nga e vetmja Lulishtë Hyjnore
Fishta thirri plot zemrim:
More Padër Justin Rrota
A t'kam thanë ban punë të kota
Me lodhë kryet për gjuhen shqipe
Shih ku t'çoi ai kal që i hipe,
Shih sa bukur na ranë kresë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Edhe ata që i prijnë fesë!
Thuej a nuk të vjen me plasë
Për ktë plagë që na kanë hapë?!
Shihe sa të drejtë kam pasë
N'vjerrsh "Kur pata kenë ba Papë".
Për ktë rast me kallxue hakun
Populli kështu na flet:
"Kujtë vret vehten me dorë t'vet,
As kurrkush s'ia paguen gjakun."
E ku gjenë n'Shqipni verjore
Radio a televizion
Që gegnisht na transmeton?!
Jo zotni asht lanë pas dore
Gjuha e letërsisë klasike
Se po thonë asht Arkaike
E Martini e Arshija
"Demode kahë letërsia"
Se ma Fishtë, Mjedë e Prendush,
Nuk don me i lexue ma kush.
Do ta donim ne at art
Po të shkruhej me standart.
Kështu thonë t' Shkodërs Te - Ve
Që na i suell kjo kohë e re
Gjoja me na i prijë kulturës,
Por janë t'smura prej çensurës
Trashigue prej diktaturës.
Gjaja që e bajnë ma mirë
Dhe e bajnë me shum dëshirë,
Se aty u buzqeshë suksesi
Flasin pa as nji difekt
Gjuhën e atijë djalekt
Që na imponoi kongresi
I Enverit e Androkliut
Me ia thâ artin veriut.
Ne gegnishten bamë kurban
Gjith si deshti ai tiran

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Tue i thanë: O Enver me fletë
Na mso ti se e vrasim vetë.
Në çdo vend të kësajë Botë
E quejnë gjuhën ma të plotë
At që shkruejnë ma t'mdhejt shkrimtar
Ktu që e mbrapshta quhet mbarë,
Lokalizmin e mbajmë vlerë
Edhe e kemi shum për nderë
Antivleren me e quejtë vlerë.
Prandej na dallojnë me gisht
E na quejnë njerëz me bisht.
Pa ia zhgulë ktijë bishti rrajen
Europa s'na ban të sajen.
Ne në vend ktë bisht me e pre
Duem me e zgjatë sa besë s'e ke
E ka thanë nji prej Bilishtit:
Dijeni o shokë prej meje
Çka t'kapin Bota prej kreje,
Ne do ta kapim prej bishtit.
Ndaj do t'mbetemi gjithmonë
Bishti i Kontinentit tonë.
Burrë i urtë Lasgush Liriku
Smujt me e shtijë Enveri n'thes
Asajë gracke ai i iku,
Grackës së atij kongres,
Kur e pyetën miq e shokë
Për at firmë të pa vendosur
Tha: Kush ka mendjen në kokë
Historinë e mendon hollë
Se ajo bëhet edhe njollë.
Historia s'ka të sosur
Der sa tjerët kshtu t'mos thonë
Dotë mbetemi gjithmonë,
Bishti i Kontinentit tonë.
S'asht e drejta e gjuhtarve
Me u vu ligje shqiptarve

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Si me e folë e si me e shkrue
At çka vetë e kanë krijue.
Çfarë gjuhtari mund t'i thonë,
A mund t'jetë gjuhtar i jonë
Ai që thotë mos e përdor
Gjuhën që ka shkrue Martini
E t'tjerve gjithkahë rrjedh Drini
Ai asht agresor i asajë kulturë,
N'sajë t's'cilës shqipnia
Mund t'bajë at figurë,
Që e kërkon lavdia.
Kush ka intelekt
Nuk kërkon djalekt
Por nji gjuhë thesar
Që na ban krenar.
Dikush, dikush qahet
Se kjo gjuhë nuk bahet,
N'mos mendosh si dje
Bahet çke me te.
Por nse gjuhtarët tonë
Kështu nuk na thonë,
Ne do të jemi përgjithmonë
Bishti i Kontinentit tonë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

PRIJSI BUDALL

Selca, Vukli e Nikçi i Kelmendit
Me rradhë zgjidhnin t'Kelmendit bajraktar.
Meqense puna nuk po u shkonte mbarë
Nji ditë i thanë budalles s'atij vendit:
A po na prinë se punët ma per dreq
As ti s'na i çon, i marri iu pergjegj:
Në qoftë se ju e keni me t'vërtetë,
Më plotsoni nji kusht se u prijë vetë.
Çfarë kushti po na kërkon me na udhheqë?
N'doni pas kshillës time ju me ecë,
Cilido burrë e grue të vdesë prej nesh,
Më leni me ia thanë nji fjalë në vesh.
Kushti u pranue e pa të tjera fjalë,
Ai u krekos për mbi nji kal me shalë.
Kryq e tërthurë kah shkonte e kah vinte,
Perandori në gju atij s'i binte,
Prej asajë grade që i i ra për hise,
Në saje të fatit që at ditë e ndeshi.
Kujt do të vdiste ndër ato t'tre fise,
I përshpëriste disa fjalë tek veshi.
Kush s'u bâ kurreshtar me ditë çka i thotë,
Atyne që e lenin këtë Botë.
Nji ditë prej ditësh zgjedhsat po na thonë:
Në don me e mbajtë ma gjatë ktë post që ke,
Fjalët që u thue në vesh t'vdekunve tonë,
Pa nji pa dy na i thuej edhe ne.
Po, un u them të vdekunve t'ktij vendit,
Kur t'u pyesin Atje si e shkojmë ktë jetë,
Ju veç kallxoni kush i prinë Kelmendit,
Se të tjerat i marrin me mend vetë.
Urtinë e kësajë prrallë lexues e ke
Jo veç për fshat, por edhe për Atdhe.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

LUTJA E SHQIPTARVE TË PARAJSËS

At Gjergj Fishta i pavdekshem
Paska Ishue kushtrim të thekshëm
Në Parajsë për çdo shqiptar
Që të mblidhen sa ma parë
E nga kopshti i Gjithsisë
Fort t'i luten Perëndisë
Ta ndimojë prap Shqipninë
Me forcue demokracinë.
E gjithkahë ushtoi jehona
Shqiptart e viseve tona
Që Parajsa i ka zgjedhë
Rreth poetit qenkan mbledhë.
Siç po e shihni Fishta foli
Sapo nga errsina doli
Drue Shqipnia shkon ku qe
Dhe e sotmja u bahet dje.
E kjo asht ma e kthjelltë se loti
Për aty ku s'lutet Zoti
Dihet në at vend hyn mbrend
Ai qe a kund mos qoftë permendë
E pra ne me shkrimet tona
Që nga Vjosa tek Valbona
U përpoqem me ia ndritë
Mendjen shqiptarve t'ngritë
Se si me e fitue lirinë
Si me e ruejtë demokracinë
Shum prej jush u bane flije
Si herojve u ka hije
Per vend t'vet me shkri vetvehten
Thue kshillat tona u treten
Dhe e mposhti e keqja t'mirën
Si qoftë treti e ka deshiren?!
Skëterrort shëndrrue në komunista,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MAHIN BARLETI" SHKODËR

Me veprimet ma të pista
Me tinzi prap Shqipeninë
E gremisen në greminë
Dhimshëm tha, Gjergj Kastrijoti
Pse kështu he ata i vraftë Zoti
Atherë Dedë Gjo Luli i Hotit
Tha: Ku e kanë xhanëm ndërgjegjen
Këta njerz që kurr s'u regjen?
Se t'gjith janë bijtë e nji Zotit
A janë gjak i Skënder Beut?!
A janë bijtë e atij dheut?!
A por janë kush di se çka
Që s'e dinë as vetë ata
Vllaznit Frashri pezmatue
S'i lanë lotët me ligjrue
Poradeci ky burrë penet
Që Shqipninë e pat vend mundi
Tha: Partinë që ktu s'permendet
Un e lashë në grrahma t'fundit
Kjo gjë t'len fare pa mend
Si të rronte ma n'at vend
Ku s'la t'keqe pa e bërë
More Shqiptarë të mjerë
Hiqni prangat o të gjorë
Që ju vetë e keni n'dorë
Merre fatin në duar tuaja
Mos e prisni nga duar t'huaja
Miqsinë mbani me çdo kënd
Lypni mbështetje, por jo mend
Ia pat Noli,ti je mbarë
Se ne mirë e njohim tokën
Nese gjarpnit s'ia pret kokën
E merr vehten si më parë.
Foli Mjeda me ngadalë:
Ktu s'ka ma nevojë për fjalë
Por të gjith të bajmë nji lutje

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Që Shqipnia tash e tutje
Ta ketë zemrën plot për plot
Me ç'ka don i Madhi Zot
Të gjith s'bashku për nji heri
Ketë lutje e banë nji zëri
Lutja jonë gjithmonë jehoftë
N'zemër t' çdo shqiptarit shkoftë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

PËRMBAJTJA

Nji satirë për dy kohë 5
Hymje 9
Drejtsija 10
Njeriu e koha 11
Çka po thonë e çka s' po thonë 13
Intervistë me hatrin 18
Shërbimi zyrtar 19
Dhanja e titujve në Shqipni 21
Dy maska për dy kohë 22
Këshillat e kumbarës 24
Bisedë me karnivalet 28
Autobuzi për shqiptar 37
Flet diploma me diplomë 39
Kshilla e dijetarit 40
Tretja e dembelit 41
Projektim genjeshtrash 42
Pseudo poeti 44
Intervistë me Enver Hoxhen 46
Kushtrimi i demokracis 53
Intervistë me At Gjergj Fishten 56
Kangë per çifteli 61
Komisioni i gjuhës shqipe 2006 72
Korrespondencë me nji mik 74
Paradhanje 81
Ari e leverdia 82
Fjalët e së vërtetës 83
Shkodrës 84
Tregimi i nji Prillit 85
Shkodra 88
Përgjigje letrës së nji mikut 91
Ateisti 96
Biografia e Enverit dhe e Enverizmit 98
Biseda e dytë me kanivalin 150
Ngadhnjimi i genjeshtres 157
Syzet e djallit 158
Shteti e rendi 159
Pula 160
Prralla e tortës 162
Mosujdia 163
Kopraci 165
Mjeksia e të sëmurËt 166
Intervistë me demokracinë 167
Pasunia 169
"Un e kam frigë historinë" 170
Prijsi budall 179
Lutja e shqiptarve të Parajsës 180

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

CIP katalogimi në botim BK Tiranë

Vata, Gjokë
Gjuha e thimcit; poezi satirike, Gjokë Vata; red. Arben Prendi.
-Shkodër: Camaj-Pipa, 2007
184 f.; 17 cm

ISBN 978 - 99943 - 34 - 98 - 8

Formati: 61x86/16
Tirazhi: 200 kopje
Botuar: maj, 2007

Gjokë Vata V 14


Shtëpia Botuese "Camaj-Pipa", Kiras, Kodra Nr.43,
Shkodër - Albania

Tel: +355 22 43822
Mob: +355 69 2139980
e-mail: h_lekaj@yahoo.com
e-mail: hlekaj@unishk.albnet.net

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Shtypur: Shtypshkronja "Volaj",
Rruga: Filip Shiroka, 27, Shkodër - Albania
Tel. +355 (0) 22 444 80
Mob. +355 (0) 68 2313245

BIBLIOTEKA PUBLIKE
„MARIN BARLETI"
S H K O D E R



BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

ISBN 978-99943-34-98-8